

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 E martë, 7 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.01

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
14 fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë,
15 përkatësisht Dëshmitari me numër 03825, Trupi Gjykses do të
16 nxjerrë një urdhër me gojë sa i takon seancave publike.

17 Pasi është bërë rishikimi i transkriptit, klasifikimeve
18 dhe pasi kemi shqyrtuar parashtrimet e palëve, Trupi Gjykses
19 urdhëron palët dhe pjesëmarrësit të rishikojnë edhe një herë
20 seancat private si në vijim.

21 Sa i takon rishikimit të transkripteve zyrtare, palët
22 duhet të diskutojnë *inter partes* dhe të dërgojnë një
23 transkript me më pak redaktime brenda dhjetë ditësh nga
24 njoftimi i transkripteve zyrtare për një dëshmitare, ose në
25 rastet kur transkripti përfshin dëshminë në seancë private të

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 dy ose më shumë dëshmitarëve, brenda dhjetë ditëve nga
2 njoftimi i datës për të gjithë transkriptet zyrtare për të
3 gjithë dëshmitarët që mbulohen nga ai transkript.

4 Së dyti, palët që nuk e kanë thirrur dëshmitarin,
5 pjesëmarrësit dhe Zyra Administrative duhet t'u përgjigjen
6 *inter partes*, të diskutojnë nëse i pranojnë apo kundërshtojnë
7 ndonjë prej redaktimeve që janë propozuar, dhe heqjen e tyre
8 brenda dhjetë ditëve.

9 Dhe së treti, pala që ka thirrur dëshmitarin duhet t'i
10 komunikojë Trupi Gjykses rezultatin që ka pasur nga diskutimi
11 *inter partes* me palën tjetër, brenda dhjetë ditësh nga momenti
12 pasi marrin transkriptin. Brenda të njëjtit afat, pala që nuk
13 ka thirrur dëshmitarët dhe pjesëmarrësit mund të dorëzojnë
14 parashtrime sa i takon redaktimeve të propozuara, dhe Trupi
15 Gjykses do të marrë vendim lidhur me këtë aspekt.

16 Sa i takon rishikimit të dëshmive që kanë përfunduar deri
17 më 18 tetor 2023, Trupi Gjykses urdhëron që brenda 8 dhjetorit
18 2023, ZPS-ja të komunikojë *inter partes* dhe të paraqesë
19 propozimet sa i takon dëshmive në seancë private për
20 dëshmitarët që janë dëgjuar që kanë dhënë dëshmi, pra, deri në
21 korrik 2023.

22 Brenda 19 janarit 2024, pala tjetër dhe pjesëmarrësit
23 përgjigjen *inter partes*.

24 Dhe brenda 16 shkurtit 2024, ZPS-ja do të njoftojë Trupin
25 Gjykses lidhur me rezultatet që kanë pasur diskutimet *inter*

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 *partes*, dhe palët e tjera dhe pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë
2 parashtrimet përkatëse.

3 Sa i takon dëshmitarëve që janë dëgjuar nga gushti dhe
4 deri 18 tetor 2023, Trupi Gjykses urdhëron që brenda 1 marsit
5 2024, ZPS-ja të komunikojë *inter partes* dhe të paraqesë
6 propozimet për dëshmi që janë dhënë në seanca private, për
7 dëshmitarët pra që kemi dëgjuar nga periudha gusht - 18 tetor
8 2023.

9 Brenda 5 prillit 2024, pala tjetër dhe pjesëmarrësit
10 duhet të përgjigjen *inter partes*.

11 Dhe brenda 30 prillit 2024, ZPS-ja duhet të njoftojë
12 Trupin Gjykses sa i takon rezultatit që ka pasur diskutimi
13 *inter partes* dhe palët dhe pjesëmarrësit mund të dorëzojnë
14 parashtrimet përkatëse nëse është e nevojshme.

15 Pasi të bëjnë shqyrtimet, palët, parashtrimet e palëve të
16 marrin parasysh të gjitha urdhrat që janë nxjerrë sa i takon
17 redaktimeve. Trupi Gjykses thekson se si rregull i
18 përgjithshëm çdo kërkesë për redaktim të informacionit duhet
19 të jetë mjaftueshmërisht, duhet të jetë e argumentuar siç
20 duhet dhe të mbrojnë dëshmitarët me masa mbrojtëse dhe
21 informacionin konfidencial. Pala gjithmonë do të marrë
22 parasysh nevojën që ne, duhet të kenë gjithmonë parasysh
23 faktin që duhet të kemi sa më shumë seanca publike, por kjo
24 duhet të jetë në ekuilibër me të drejtat e personave që kanë
25 masa mbrojtëse.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 Së fundi, Trupi Gjykses dëshiron të zbatojë një masë
2 tjetër që duhet të inkurajojë më tej seancat publike.
3 Parimisht Trupi Gjykses urdhëron palët dhe pjesëmarrësit të
4 dorëzojnë njëherazi një version të redaktuar publik të
5 parashtrimeve të protokolluara konfidenciale. Kur ka arsye
6 bindëse për të mos e bërë këtë, palët dhe pjesëmarrësit duhet
7 të japin argumentet përkatëse pse versioni i redaktuar publik
8 nuk mund të dorëzohet në të njëjtën kohë me parashtrimin e
9 protokolluar.

10 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

11 Tani mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit. Vërej
12 që z. Krasniqi sot po na ndjek përmes videolidhjes. Është
13 dorëzuar kërkesa përkatëse dje, ndërsa të akuzuarit e tjerë
14 janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

15 Do të vijojmë sot me dëshminë e dëshmitarit të
16 Prokurorisë 03825. Do të jemi në seancë publike me përjashtim
17 të rasteve kur është e nevojshme të kalojmë në seanca private.

18 Asistente e Gjykatës, ju lutem sillni dëshmitarin në
19 sallë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, në fakt u përgjigjët ju në
22 parashtrimin tuaj, i nderuar Gjykatës.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
25 dëshmitar.

1 DËSHMITARI: *Good morning.*

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj t'u
3 përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e
4 kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet,
5 ose thjesht thoni që nuk e kuptoni dhe ata do ta sqarojnë.

6 Gjithashtu, përpiqu të na thoni ku e bazoni njohurinë,
7 faktet, dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

8 Gjithashtu kini parasysh që jeni ende nën betim sikurse e
9 lexuat vetë në fillim të dëshmisë suaj për të thënë të
10 vërtetën.

11 Flisni para mikrofonit, dhe ju lutem prisni pesë sekonda
12 para se të përgjigjeni dhe mos e ndërprisni pyetjen. Prisni
13 derisa të përfundojë pyetja përpara se të përgjigjeni. Flisni
14 ngadalë, në mënyrë që dhe përkthyesit të kenë mundësi t'ju
15 ndjekin.

16 Nëse keni nevojë për pushime, na thoni dhe ne do bëjmë
17 organizimet e nevojshme.

18 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

20 DËSHMITARI: W03825 [Vijon]

21 Pyetje nga znj. Mayer: [Vazhdim]

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

23 PY. Mirëmëngjes, dëshmitar.

24 PË. [Në anglisht] *Good morning.*

25 PY. Dua të flasim sërish për fillimin e vizitës suaj në

1 Qirez. Dje ju pyeta nëse keni folur me popullatën një për një
2 apo mbajtët ndonjë fjalim. A i dhatë, a mbajtët ndonjë fjalim
3 për ndonjë grup të popullatës ndërkohë që ishit atje?

4 PË. Po, na për me bisedu me ta kemi shku. Me pa problemet e
5 tyne, hallet e tyne, nën terrorin serb.

6 PY. Gjatë kësaj kohe, a bëtë ndonjë fjalim që dikush e
7 regjistroi me ndonjë kasetofon, apo ndonjë e incizoi?

8 PË. Ka pasë mundësi që e kanë inçizu, unë s'i kam kontrollu
9 ata.

10 PY. Kur erdhi UÇK-ja dhe ju pyeti fillimisht për qëllimin e
11 vizitës suaj, dhe për çfarë keni folur me personat, ua tregove
12 incizimin për t'u treguar që shiko, ja, për këtë fola me
13 popullatën?

14 PË. Unë s'kam pasë incizim sepse ne si grup delegacioni nuk
15 kemi ba asnjë incizim. Domethënë, ka mujtë dikush prej
16 gazetarëve me inçizu që është e lejushme, gazetarët e bajnë
17 punën e vet, dhe ne kemi pasë qëllim vizitën humanitare.

18 PY. Pra, qëllimi juaj ishte t'u kërkonit personave në Qirez
19 të dorëzonin armët, të ulnin armët?

20 PË. Absolutisht, jo. Unë me pasë mujtë UÇK-së i kisha ba armë
21 bërthamore, sepse serbët kanë vra fëmijë, kanë vra, kanë vra
22 invalidë.

23 PY. A ishte ky shqetësimi i UÇK-së kur ju ndaloi se mos
24 kishit shkuar atje për t'u thënë popullatës të dorëzonte
25 armët?

1 PË. Edhe dje e kam thanë se dyshimi është bazë për me ardhë
2 te e vërteta. UÇK-ja ka pasë plotësisht të drejtë me dyshu se
3 ndonjëni prej nesh ka mujtë me, dikush në atë grup, 30-40
4 vetë, me pasë ndonji mendim të tillë, por, domethënë, unë flas
5 dhe marr përgjegjësi vetëm për vete.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës të
7 vendosë në ekran dokumentin me numër 034236 deri 034287.
8 Anglishtja është faqja 034242, ndërsa gjuha shqipe është në
9 fund, fillon nga fundi i faqes 034251. Ju lutem pak më poshtë
10 tek anglishtja. Ju faleminderit.

11 PY. Në dëshminë e vitit 2014, Prokurori ju ka pyetur:

12 "A keni pasur ndonjë ndërveprim me UÇK-në në atë kohë?"

13 Ju jeni përgjigjur:

14 "Po, menjëherë, ata menjëherë u ulën dhe dikujt i thanë
15 që të aktivizonte kasetofonin" --

16 Më falni, po e filloj edhe një herë:

17 "Po, ata menjëherë u ulën dhe dikujt i thanë që ta
18 aktivizonte kasetofonin për të dëgjuar se çfarë kishim thënë
19 ne. Sipas propagandës, të cilën ata e përsëritën më vonë, ata
20 thanë se kinse ne i kishim thënë popullatës që t'i hidhnin
21 armët, apo armatimin. Por ne shkua atje për të biseduar me
22 civilët lidhur me nevojat e tyre humanitare. Ky ishte synimi
23 jonë. Ata e dëgjuan incizimin, u nervozuan kur dëgjuan çfarë
24 kishim thënë, sepse kasetofoni, incizimi ishte në nivel dhe
25 sepse ne nuk e kemi ditur që ata do të vinin dhe do të

1 dëgjonin incizimin."

2 Tani, pasi u lexova këtë paragraf, a ju kujtohet që ka
3 qenë, ka pasë një kasetofon, dhe UÇK-ja ka urdhëruar që të
4 aktivizohet kasetofoni për të dëgjuar fjalimin tuaj?

5 PË. Së pari, në vetë ftesën që ma keni ba këtu, më keni bo të
6 padrejtë ndaj meje. E dyta, në pyetjet që po m'i -- okej.

7 PY. Dëshmitar, na duhet vetëm përgjigja e pyetjes.

8 PË. Atëherë, unë protestoj, sepse unë ma së pari jam
9 përgjegjës me mbrojtë familjen time dhe fëmijën e mi dhe të
10 vërtetën.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
12 lutem, përgjigjuni pyetjen që ju bën. Vetëm kaq. Jepini
13 përgjigje pyetjes.

14 DËSHMITARI: Kryetar i nderum, dhe i repektum, i Gjykatës.
15 E nderume, znj. Prokurore, unë e kam të drejtë me protestu
16 sepse unë duhet, jam risponsibëll, jam përgjegjës, për fatin e
17 fëmijëve të mi, edhe të gjeneratave të nipave, të mbesave të
18 mi, edhe për këta duhet me pasë konsideratë. Kam kërku gjatë
19 bisedave me ju që seanca të jetë të mbyllura, për me mujtë mos
20 me [REDAKTUAR]

21 Nëse qëllimi i kësaj Gjykate është vetëm me nxjerrë çka
22 ju keni dëshirë, edhe le të ndodhë gjithçka me Kosovën, na i
23 hapni plagë të reja, ajo është tjetër gjë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
25 përgjigjuni pyetjes.

1 Znj. Prokurore, ju lutem përsërisni pyetjen.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

3 PY. Pyetja ime ishte kjo, Dëshmitar, pasi u lexova këtë
4 paragraf unë, a ju rikujtohet tani që ka pasur një kasetofon
5 që u aktivizua për UÇK-në kur kërkoi që të aktivizohej në
6 mënyrë që të dëgjohej çfarë i kishit thënë popullatës atje?

7 PË. S'më kujtohet.

8 PY. Përmbajtja nuk u pëlqeu, nuk u pëlqeu çfarë dëgjuan?

9 Çfarë ishte incizuar?

10 PË. Unë nuk i kam pyetë a ju ka pëlqy, as nuk e di a iu ka
11 pëlqy.

12 PY. Të diskutojmë sërish lidhur me atë që folëm edhe dje.

13 Flasim për lirimimin e delegacionit nga ndalimi.

14 Ju na thatë se u zhvendosët nga shkolla në Baicë për
15 shkak të faktit se po afroheshin forcat ushtarake serbe dhe se
16 po largoheshin shumë vetura, jo vetëm vetura juaj. Të gjithë
17 pra po largoheshin nga zona, për shkak të forcave serbe, dhe
18 se ju vozitën, ju çuan sërish në Qirez, kështu?

19 PË. Po, kështu është.

20 PY. Në Qirez, a dëgjove ndonjë diskutim mes Hashim Thaçit dhe
21 të tjerëve lidhur me mënyrën si po reagonte publiku për
22 arrestimin tuaj apo arrestimin dhe ndalimin e delegacionit
23 tuaj?

24 PË. Nuk e kuptoj për cilin publik e keni fjalën, unë e thashë
25 se --

1 PY. Në fakt e kisha fjalën, a ke dëgjuar që Hashim Thaçi të
2 bisedonte me persona të tjerë lidhur me mënyrën si po reagonte
3 popullata e Kosovës, publiku i Kosovës, sa i takon ndalimit të
4 delegacionit tuaj?

5 PË. Hashim Thaçi ka bisedu kryesisht me mu edhe me ata që
6 kanë qenë ma të randësishëm në delegacion. Dhe gjithnjë kam
7 vërejt se ai ka qenë i përkushtum, i interesum, dhe i angazhum
8 që delegacioni me kry atë bashkëbisedim, atë bisedë, të
9 ndaljes tonë, të justifikushme. Ndoshta dhe të nevojshme për
10 UÇK-në, por edhe për ne, domethënë, për me mujtë na me kalu sa
11 ma lehtë edhe me u kthy në Prishtinë.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shkojmë në dokumentin me numër
13 034265, drejt mesit të faqes në anglisht dhe 034282 në shqip,
14 po ashtu nga mesi poshtë fundit të faqes. Nga mesi në drejtim
15 të fundit të faqes.

16 PY. Flitet këtu përsëri për Qirezin. Ju Prokurorisë i thatë:

17 "Hashimi dhe të tjerët të cilët i kam përmendë, kishte
18 dhe të tjerë, por këta dukeshin se ishin më të rëndësishmit.
19 Sabiti e thirri Adnan Merovcin, këshilltarin e Rugovës, dhe
20 Enver Malokun, i cili drejtonte Qendrën Informativë të
21 Kosovës. Ata biseduan me Adnanin përmes telefonit. Nuk e di
22 çfarë përgjigje u kishte dhënë Adnani. Ata e pyetën Enverin se
23 si ishte situata në Prishtinë. Dhe se çfarë kishin thënë
24 lidhur me arrestimin tonë. Ai u tregoi atyre se situata ishte
25 shumë e tensionuar, se populli donte të organizonte ndonjë

1 protestë. Organizatori kishte shkuar te Rugova me u njoftu.
2 Rugova si njeri i mençur dhe i urtë, që i kishte thënë jo, dhe
3 që të mos protestonin."

4 Pra, ka qenë kështu biseda që keni dëgjuar ju mes Hashim
5 Thaçit dhe të tjerëve sa i takon reagimit në Kosovë lidhur me
6 arrestimin dhe ndalimin tuaj?

7 PË. Hashim Thaçi nuk ka biseduar me askënd në Prishtinë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një kundërshtim sepse ka
9 mungesë themelësie, të paktën në disa pjesë për mënyrën nga ta
10 dijë, nga mund ta dijë dëshmitari për çfarë ka biseduar z.
11 Thaçi në telefon.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është shumë e qartë nga konteksti,
13 të nderuar Gjykatës. Ai jep mendimin e tij, çfarë ka dëgjuar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
15 kundërshtimi.

16 Vazhdoni.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

18 PY. Pas kësaj bisede që dëgjuat dhe ku u diskutua lidhur me
19 një protestë, ju thanë më pas që ishit të lirë, grupi juaj?

20 PË. Jo, ne ishim të lirë, ne si kemi mbërri në Qirez, kemi
21 qenë të lirë. Ne në fakt kemi qenë gjithnjë të lirë. S'kemi
22 qenë na të arrestumë, as kemi qenë të lidhun, as kemi qenë,
23 domethënë, nuk -- ne ishim të lirë. Vetëm problemi ishte të
24 gjejmë mënyrën ma të lehtë për me u kthy në Prishtinë, pa
25 probleme, pa u ndeshë me forcat serbe.

1 PY. Do ju lexoj pyetjen e radhës pas këtij përshkrimit, sa i
2 takon reagimit dhe protestës që mund të mbahej. Ju pyetën, në
3 të njëjtën faqe jemi, në fund të faqes. Si në anglisht dhe në
4 shqip. Është dëshmia e vitit 2014, pra. Prokurori ju pyet:

5 "Çka ndodhi në atë natë në atë shtëpi të periferisë së
6 Qirezit?"

7 Jo në Baicë. Ju jeni përgjigjur:

8 "... aty ata na thanë se ishim të lirë, dhe se nuk kishim
9 gjetur asgjë për të thënë se ne kishim bërë ndonjë gabim, por
10 thanë që nuk dinin se ku me na çu dhe çka me bë me ne."

11 Pra, ju jeni liruar pas kësaj bisede. A është kështu?

12 PË. Nuk e di orën kur jemi liru, as minutat, por e di që nga
13 nisja prej Baice, domethënë, *de facto* kemi qenë të lirimë.
14 Vetëm është mendu strategjia sesi me na depërtu për Prishtinë
15 pa pasë takim me forcat serbe të cilat kanë pasë mundësi me na
16 vra edhe me etiketu edhe me fajësu UÇK-në.

17 PY. Dje na thatë që ju çuan me veturë nga Qirezi në
18 Krajmirovç, nuk do të ju pyes sërish për këtë. Kur mbërritët
19 në Krajmirovç, ju personalisht apo i gjithë delegacioni
20 mbërritët? Ju thatë që ishit në veturë me Veli Bytyqin dhe
21 Hashim Thaçin, por edhe delegatët e tjerë mbërritën në të
22 njëjtën kohë në Krajmirovçë?

23 PË. Në të njëjtën kohë kemi mbërritë në Krasmirovçë dhe jena
24 vendosë në shtëpinë e një fisniku, mikpritësi, një bujari,
25 familjen Mehmeti, edhe aty pastaj kemi dreku dhe gjithë ato të

1 tjerat që mund t'jua shpjegoj ma vonë.

2 PY. Ju na dhatë një përshkrim dje kur thatë se njerëzit mund
3 të luanin shah, biles thatë që ju dhanë ushqim. Por si ishte
4 atmosfera kur shkuat në këtë shtëpi, krahasuar me atmosferën
5 para lirimit tuaj, me gjendjen.

6 PË. Krejtësisht normale. Ishte atmosferë, muj me thanë,
7 vllaznore. Kemi, disa kanë lujtë shah, kush ka ditë, ka lujtë
8 shah, dikush ka pi çaj, ka pi kafe. Kemi ngrënë drekë. Dikush
9 ka ba tualet, domethënë, edhe kemi pritë mundësinë e parë për
10 me mujtë me vazhdu për Prishtinë. Së pari për Çiçavicë, pastaj
11 të nesërmen në mëngjes për Prishtinë.

12 PY. Dhe kjo tregoi një ndryshim nga mënyra si kishin qenë
13 gjërat gjatë kohës në ndalim. Pra ishin më të relaksuar
14 personat, sepse në fakt kishte një dallim se tani ishit të
15 lirë.

16 PË. Kishim relaksim të dy palët sepse u heq doza e dyshimit
17 ndër individë nga grupi jonë që ka mujtë me infiltru,
18 domethënë, mbrenda grupit për me mujtë me mbledhë çka di unë,
19 të dhana për UÇK-në. Dhe ajo dozë u tejkalu, ose ai -- se nuk
20 është kurrgjë aty, edhe nga ana jonë ishim të lirimë
21 shpirnisht edhe moralisht, se edhe nuk kishte asgja,
22 domethënë, asnji gjetje që kemi ba ndonji gabim. Dhe ishim
23 shumë të lumtun.

24 Domethënë e vetmja gja që na shqetësonte ishin gjuajtjet
25 e forcave serbe gjithandej Drenicës. Drenica ishte në flakë,

- 1 ishte e rrethume. Dhe UÇK-ja ishte e përkushtume dhe e
2 shqetësime si me na sjellë ne pa telashe, pa probleme në
3 Prishtinë. Kjo ishte e tëra.
- 4 PY. Thatë se ju dhanë ushqim në këtë shtëpi. Po Hashim Thaçi
5 dhe Sabit Geci qëndruan atje me ju dhe hëngrën me ju?
- 6 PË. Me një sofër. Te ne janë do farë sofrash tradicionale
7 sikur tavolinat, tryezat, por pak ma të ulëta. Edhe
8 bashkërisht kemi ngrënë, kemi qeshë, kemi folë, kemi bisedu,
9 domethënë, krejtësisht normal.
- 10 PY. Sa i takon ushqimit, ju ishit të uritur, gjatë kohës që
11 ishit në ndalim, ju kishin dhënë ushqim?
- 12 PË. Gjithmonë kemi hëngër ushqim atë që ka ngrënë Ushtria
13 Çlirimtare e Kosovës. Bile Ushtria e lavdishme Çlirimtare e
14 Kosovës, se gabova.
- 15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shohim dokumentin që është në
16 ekran, por faqja 034226 në anglisht dhe 034283 drejt fundit të
17 faqes në shqip. Ju lutem pak më poshtë tek anglishtja.
- 18 PY. Në dëshminë e majit 2014, ju pyet prokurori:
19 "Derisa sa keni qenë të paraburgosur, a ju kanë dhënë
20 ndonjë ushqim dhe ujë?"
- 21 Jeni përgjigjur:
- 22 "Kjo ka qenë katastrofë. Kjo ishte shumë keq. Por askush
23 nuk mendonte që do të gjente ndonjë ushqim fare. Ne e ndjenim
24 veten shumë keq për shkak të turpit nga rrahjet të cilëve
25 ishim nënshtruar. Në këtë shtëpinë e Mehmetit ne ishim ulur

1 rreth tavolinës bashkë me Hashimin dhe Sabitin dhe me të
2 tjerët, dhe gjatë ngrënies së ushqimit Ismail Mehmeti, kreu i
3 shtëpisë, më bëri një pyetje nga jam.”

4 Pra, a ka qenë kështu situata kur keni qenë të
5 paraburgosur sa i takon ushqimit, ka qenë e keqe dhe u
6 përmirësua kur shkuat te kjo shtëpia në Krajmirovçë?

7 PË. Po shoh se në këtë Gjykatë provokimet ndaj meje nuk kanë
8 të ndalur. Domethënë vazhdoni. Unë jam këtu, do të jem këtu,
9 edhe ju falënderoj për këto provokime.

10 Ne nuk jemi shku atje në pushime në Maldive, as pushime
11 verore. Kosova digjej, Drenica ishte në flakë. S’kishte bukë
12 as për fëmijë. E kam pa fëmiun që jua kam përshkru dje duke
13 ngrënë bukën me baltë.

14 PY. E kuptojmë këtë, dëshmitar, e dëgjuam dje. Por unë po ju
15 pyes për fjalët që keni thënë ju, ju vetë e përshkruani --

16 PË. Unë jam --

17 PY. Ju lutem, ju lutem, prisni të përfundoj pyetjen.

18 PË. Okej. Më falni.

19 PY. Pra, kur ju ka bërë një pyetje prokurori, në përgjigje të
20 pyetjes, a ju kanë dhënë ushqim apo jo, ju vetë keni thënë:

21 “Ka qenë katastrofë. Ishte shumë keq. Mirëpo askush nuk
22 mendonte që do gjente ndonjë ushqim fare.”

23 Nuk po e lexoj sërish të gjithë paragrafin, por ama kjo
24 ishte pyetja ime.

25 PË. Ne në Prishtinë kemi ngrënë biftekë. Kemi pasë ushqim të

1 bollshëm. Në zonat e luftës, posaçërisht në Drenicë, nuk ka
2 pasë ushqim as për fëmijët. Ne kemi ngrënë atë çka kanë ngrënë
3 edhe pjesëtarët e UÇK-së. Edhe ne normal që s'na ka pëlqy ai
4 ushqim sepse ne ishim mësu me ushqim tjetër, për sa i përket
5 ushqimit nuk ka pasë asnjë vërejtje.

6 Nuk po e cekni se dhe kur kemi kërku birra, si në hotel,
7 na kanë sjellë birra në Baicë.

8 PY. Mendoj se na e thatë këtë dje, Dëshmitar.

9 Kur keni qenë në këtë tryezë dhe po hanit ushqimin, a
10 ndodhi në një moment që dy ushtarë të UÇK-së u futën në dhomë
11 me armë në dorë?

12 PË. Nuk më kujtohet kjo, është 25 vjet. Jeni ka pyetni për
13 detale 25 vjet. 25 vjet e mia janë sa 2500 vjet të juve në
14 Evropë.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të shohim dokumentin që kemi në
16 ekran, në fund të faqes 034266 në versionin në anglisht dhe në
17 fillim të faqes 034283 në versionin në shqip.

18 PY. Në qoftë se do të shikojmë paragrafin e fundit nga mesi
19 aty, ju thoni që:

20 "Ndërkohë që po hanim, dy ushtarë të rinj të UÇK-së u
21 futën në dhomë me armë në dorë dhe pyetën, kush është nga ju
22 Agim Krasniqi, dhe i kërkoi atij që të shkonte me ta. Unë ju
23 thashë atyre që unë jam udhëheqësi i grupit edhe jam
24 përgjegjës për të gjithë grupin. I thashë që Agim Krasniqi nuk
25 do të dilte nga ajo dhomë."

1 A ju kujtohet tani, Dëshmitar, që dy ushtarët e UÇK-së --
2 PË. Jo, nuk më kujtohet se janë 25 vite në pyetje. Por nëse
3 është ashtu, nëse eventualisht kanë hy, ata kanë mujtë me hy
4 vetëm me ba nanji bisedë, ose kanë hi pa lejen, pa urdhnin e
5 askujt. Se ne ishim shumë komodë, duke ngrënë drekë, edhe disa
6 ishin edhe duke lujtë shah. E duke pritë momentin për me u
7 nisë për Çiçavicë.

8 PY. Dëshmitar, a po thoni, a është dëshmia juaj që nuk ju
9 kujtohet apo po thoni që kur hynë të dy personat mund të ketë
10 ardhur --

11 PË. [Folës që flasin njëkohësisht]

12 PY. -- më lejoni që të përfundoj pyetjet njëherë.

13 PË. Okej.

14 PY. Pra, a po thoni që këta dy burra erdhën nga diku tjetër
15 dhe erdhën me kompetencë të vetën, vendosën vetë të vini
16 pavarësisht nga fakti që Hashim Thaçi dhe Sabit Geci ishin të
17 ulur në një tryezë me ju. Cila është, njëra apo tjetra? Nuk ju
18 kujtohet apo ky versioni tjetër që dhatë?

19 PË. Unë mendoj që nuk është mirë me involvu këtu në këtë rast
20 as Hashim Thaçin, as [REDAKTUAR], sepse këta kanë qenë krejt
21 të preokupumë me drekën tonë, me përshëndetjet me ne, dhe me u
22 nisë me sa ma lehtë, pa pasë telashe me forcat kriminele serbe
23 që e kishin rrethu Drenicën.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
25 jepini përgjigje pyetjes që u bë.

1 DËSHMITARI: Përsëritma se nuk e kam të kjartë pyetjen.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

3 PY. Në rregull, do t'a lexoj edhe një herë nga transkripti.

4 Pyetja ime ishte kjo:

5 "Si është e vërteta që nuk ju kujtohet apo që këto dy
6 burrat erdhën nga diku tjetër, dhe erdhën me kompetencën e vet
7 pavarësisht faktit që Hashim Thaçi dhe Sabit Geci ishin të
8 ulur në të njëjtën tryezë bashkë me juve?"

9 PË. Nuk më kujtohet.

10 PY. Në rregull. Nga dje deri në sot na ke thënë rreth tre
11 herë të ndryshme ku Agim Krasniqi u identifikua konkretisht,
12 veçanërisht. Së pari, ka ndodhur kur Tahir Desku erdhi dhe
13 foli me ju. Së dyti, u identifikua nga rruga që bëtë nga
14 Qirezi në Krajmirovcë, dhe pastaj është hera tjetër kur këta
15 të dy burrat erdhën dhe kërkuan Agim Krasniqin. A e dini
16 arsyen se pse kishte kaq shumë vëmendje për Agim Krasniqin nga
17 UÇK-ja, pse kishte kaq shumë interes nga UÇK-ja për Agim
18 Krasniqin?

19 PË. Unë nuk muj me ditë për kënd kanë pasë interes, sepse nuk
20 i kam pyetë. As nuk kanë pasë nevojë me u përgjigjë derisa nuk
21 i kam pyetë.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
23 paraqesë në ekran provën materiale P303, që është versioni në
24 shqip dhe provën materiale P303-ET që është përkthimi në
25 anglisht i të njëjtit dokumenti. Të shohim versionin në

1 anglisht në faqen tjetër. Versioni në shqip është në të
2 djathtë.

3 PY. A e shihni që kjo është një kumtesë që është botuar nga
4 Drejtoria e Policisë Ushtarake e UÇK-së? Mban titullin
5 "Kumtesa numër 4". A e shikoni këtë në fillim fare të gazetës,
6 tek faqja në shqip që ju është treguar, Dëshmitar?

7 PË. Për herë të parë po e shoh unë, as kam ide çka është kjo.

8 PY. A shihni aty që thuhet, Agim Krasniqi -- në mes të faqes,
9 ku thuhet që Agim Krasniqi është anëtar i kryesisë së LDK-së i
10 cili është i njohur, i cili shërbimit informativ të UÇK-së i
11 është i njohur. A e shikoni këtë pjesën, dëshmitar?

12 PË. Po, e shikoj.

13 PY. Dhe thuhet më tej që ai është "i njohur si inspirues i
14 luftës speciale kundër UÇK-së". A e dini ju çfarë ishte lufta
15 speciale kundër UÇK-së?

16 PË. Luftë speciale kundër UÇK-së, po e ndëgjoj vetëm prej
17 jush sot. Ka pasë individë në Kosovë, në parti të ndryshme
18 politike që kanë propagandu kundër UÇK-së, edhe kanë, janë
19 mundu me etiketu individë, jo programe partiake, jo parti, jo
20 liderët e partive. Por ka pasë individë, edhe mbrenda partive
21 politike. Por luftë speciale që ka bo dikush kundër UÇK-së,
22 unë nuk jam në dijeni.

23 PY. Në rregull. Ju thatë se po prisnit që të shkonit në
24 Prishtinë, që të gjenit rrugën që të shkonit në Prishtinë. Kur
25 keni qenë shtëpi në Krajmirovcë, a ndodhi që ju thanë që të

1 shkonit në malin e Çiçavicës?

2 PË. Po, domethënë, pjesëtarët e UÇK-së e kanë mendu

3 strategjinë se ne s'kisha ide, unë për herë të parë në jetë

4 time kam qenë në atë zonë. Edhe s'kisha ide as kah është

5 Çiçavica, as në cilin fshat jam. Dhe këta kanë mendu idenë ma

6 të mirë, rrugën ma të mirë që na me mbërri shnoshë e mirë e pa

7 asnji pasojë në Çiçavicë dhe pastaj në Prishtinë. Dhe jam

8 mirënjohës dhe i falënderoj edhe sot.

9 PY. Hashim Thaçi, a foli me ju përpara sesa ju u çuat për të

10 shkuar në Çiçavicë, në malet e Çiçavicës?

11 PË. Më ka folë, është përshëndetë, jemi përshëndetë, me duar,

12 si, si miq, si vëllazën.

13 PY. A ju tha ai ndonjë gjë juve se çfarë duhet të bënit kur

14 të shkonit në Prishtinë kur të ktheheshit në Prishtinë?

15 PË. Kam harru. Më besoni, krejt të tjerat -- shiqo, krejt të

16 tjerat për mu, për ju munden me kanë gjithçka, ku di unë,

17 krejt të tjerat për mue janë irelevante. Domethënë, qe aq fort

18 që s'më ka interesu as me i mbajtë mend. Randësi që ne ishim

19 të lirë, të pastër, UÇK-ja kishte çdo gjë të kjartë dhe na

20 ishim të lirë. Kjo është për mu -- gjermanët thojnë

21 *Hauptsache*. Çështja kryesore.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të shohim dhe një herë dokumentin

23 034236 deri në 034237. Në versionin anglisht, do i kërkoja

24 Sekretares të paraqesë faqen 034267. Në versionin në shqip,

25 mesin e faqes 034284.

1 PY. Kjo është dëshmia që keni dhënë në maj të 2014. Prokurori
2 ju pyet:

3 "Kush ju tha ju që të shkonit lart në mal?"

4 Përgjigjja që ju jepni është:

5 "Hashim Thaçi. Ai më kishte kapë dorën, dhe ma kishte
6 shtrënguar dorën dhe më kishte thënë se kur të mbërrini në
7 Prishtinë unë do të duhej që të hiqja dorë nga funksioni i
8 nënkryetarit të parlamentit të Kosovës. Unë po ashtu do të
9 duhet të hiqja dorë edhe nga funksioni i presidentit të
10 partisë Liberale të Kosovës. Unë i thashë se nuk do të hiqja
11 dorë nga asnjëri prej këtyre funksioneve, dhe nuk kam hequr
12 dorë. Hashimi më tha, edhe nëse je i lirë tani, ne do të mund
13 të vrasim edhe në Prishtinë. Sepse ne i kemi njerëzit tanë në
14 Prishtinë. Pastaj ne filluam të ngjiteshim lart malit."

15 Pra, përpara se të largoheshit, ndërkohë që Hashim Thaçi
16 ju shtrëngoi dorën, siç e përshkruani ju, ai ju kërkoi që të
17 hiqnit dorë nga postet që kishit dhe ju kërcënoi, a është e
18 vërtetë kjo?

19 PË. Nuk është e vërtetë. Dhe kjo nuk më kujtohet. Dhe me
20 Hashim Thaçin jemi përshëndetë burrnisht, jo sikur tash që
21 përshëndeten në Covid. Po jemi përshëndetë si burrat me dorë,
22 sikur që duhet. Edhe të tjerat nuk më kujtohen. Edhe nga këto
23 deklarata, me letrën që ju kam dërgue vitin e kalumë, jam
24 distancu komplet, sepse kanë qenë deklarata të dhana në
25 gjendjen time të randë, në procesin e rivarrimeve, ndoshta

1 edhe kam pasë hidhnim, hidhnime kam pasë shumë të mëdhaja, për
2 ju të pabesueshme. Ishalla kurrë nuk i përjetoni. Dhe ndoshta
3 edhe revanshuse, ekzagjeruese, të tepërta, dhe nga këto gjitha
4 jam distancu.

5 E tash më riktheni prapë këtu, domethënë, po i hapni
6 plagët e Kosovës, dhe plagët e mia edhe po e pengoni procesin
7 e pajtimit, edhe të faljes.

8 PY. Pas kësaj bisede dhe ndërkohë që po bëheshit gati që të
9 ngjiteshit malit të Çiçavicës, a i kërkuat z. Mehmeti që t'ju
10 shoqëronte sepse ishit të shqetësuar për sigurinë tuaj?

11 PË. Jo, për siguri. Nuk e dinim rrugën, se ishte mal. Asnjëri
12 prej nesh s'kishim kalu andej pari. Dhe kishim mujtë me deviju
13 rrugën dhe me shku me ra dikund në punktet e forcave serbe.
14 Domethënë, siguria jonë ishte e rrezikuar nga serbët. Edhe
15 krejt jetën tonë na kemi qenë të rrezikum vetëm nga serbët.
16 Edhe sot jam i rrezikum prej serbëve dhe nesër kur të kthehem
17 në Prishtinë unë dhe familja ime jemi të rrezikum vetëm prej
18 serbëve.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do ju kërkoja që të shikonim të
20 njëjtin dokument që është në ekran, por të paraqitet faqja
21 034267 në anglisht -- jo, është në të njëjtën faqe në fakt në
22 shqip kështu që nuk duhet të ndryshoni faqen në shqip. Pak më
23 sipër në faqe. Shumë mirë.

24 PY. Në fund të këtij paragrafi të plotë, drejt fundit të
25 faqes, si pjesë e përgjigjes tuaj, kur po bisedonit lidhur me

1 bisedën me z. Mehmeti, ju thoni si më poshtë:

2 "Kishte filluar që të binte nata. I thashë Mehmetit që jo
3 nga ligji, por sipas kanunit ai duhej të na jepte dy djemtë e
4 tij që të vinin me ne sepse aty kuptuam se ata dy djemtë e
5 rinj të UÇK-së ishin djemtë e tij. Unë i them atij se sa të
6 ngjiteshim lart malit, njëri prej tyre do të duhej të ecte në
7 krye të kolonës, kurse ai tjetri në fund të saj sepse unë
8 mendoja se ata do të tentonin të na vrisnin në pyll."

9 A po thoni që ju kishit frikë nga serbët, jo nga UÇK-ja?
10 PË. Nga serbët, normalisht. Krejt Drenica, krejt Kosova, ka
11 qenë e rrezikume, e vramë, e torturume, e dhunume prej
12 serbëve. Serbët kanë ardhë nga Serbia në Kosovë, ne s'kemi
13 shku as një milimetër në Serbi. Edhe ata mund të vrisnin kudo,
14 edhe midis Prishtine kanë vra njerëz. Edhe në burg kanë vra
15 njerëz në Dubravë, 170 të burgosun, kurrkush s'ka dhanë
16 përgjegjësi për atë punë.

17 PY. Keni thënë më herët që telefonat ju ishin marrë, a jua
18 kthyen në një kohë të caktuar telefonat?

19 PË. Normalisht, që telefonat na i kanë kthye, por a thashë që
20 atje poshtë nuk ka pasë qasje, valë, ku di unë si i thuni.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ju kërkoj
22 që të kalonim në seancë private për grupin tjetër të pyetjeve.
23 Janë pyetje të cilat lidhen me informacione që parashikohet në
24 rregullën 107 dhe do kërkonim të kalonim në seancë private.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 24

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 znj. Sekretare na kaloni në seancë private.

2 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
4 jemi në seancë private.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
6 vazhdoni, Prokurore.

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 25

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 26

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 27

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 28

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 29

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 30

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 31

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të
4 kalojmë sërish në seancë publike.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 Gjykatës, na kaloni në seancë publike.

7 ~~{Seancë e hapur}~~

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, folëm gjatë e gjerë lidhur me atë që ka
12 ndodhur, dhe unë ju pyeta dhe për dëshminë që keni dhënë në
13 vitin 2014. Tani do të doja të flisnim shkurtimisht për një
14 deklaratë tjetër që keni bërë ju. Në vitin 2001 keni folur me
15 UNMIK-un për këtë incident, kur ata ju kanë kontaktuar për
16 t'ju pyetur në qoftë se ju kishin mbajtur ndonjëherë të
17 ndaluar në mënyrë të paligjshme dhe nëse ju kishte rrahur UÇK-
18 ja. A ju kujtohet që kanë ardhur të bisedojnë me ju?

19 PË. Edhe një herë du me protestu, madje ashpër, nëse më
20 lejohet, për pamundësinë nga ana juj që unë të zhvilloj gjithë
21 këtë proces gjyqësor të padrejtë në seanca private. Të cilën e
22 kam kërku me ngulm.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo, a ju kujtohet të keni

1 folur me UNMIK-un në vitin 2001 kur ata erdhën t'ju
2 kontaktonin për t'ju pyetur nëse ju kishte mbajtur të ndaluar
3 në mënyrë të paligjshme UÇK-ja, dhe në se ju kishte rrahur?
4 PË. Me UÇK-në kemi bashkëbisedu edhe në Qirez edhe në Baicë.
5 Mua e thashë, askush nuk më ka rrahur, dhe askush nuk mundet
6 me më rrahë.

7 PY. Po pyetja ime ishte kjo, a kanë ardhur hetuesit e UNMIK-
8 ut në 2001 për t'ju pyetur çfarë ka ndodhur në Qirez në
9 shtator 1998. A ju kujtohet kjo?

10 PË. Thashë që ka pasë, në UNMIK ka pasë gjithçka. Edhe prej
11 Rusie më duket ka pasë. Edhe për mu nuk është aspak kredibil
12 UNMIK-u.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
14 pyetja ishte e thjeshtë. A ju ka kontaktuar apo jo UNMIK-u,
15 kaq.

16 DËSHMITARI: Na kanë kontakti. Unë e kam thanë edhe dje,
17 edhe gjatë bisedave me ju, zonja e nderume Prokurore, tri
18 ditët e kalume, që kena pasë biseda. Por unë gjatë -- për këto
19 deklarata --

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
21 pyetjes i dhatë përgjigje. Thatë dhe "po" dhe "jo". Na e
22 ndani, cila është? Pra, a ju kanë kontaktuar apo jo?

23 DËSHMITARI: Po. Unë e thashë "po". E dje kam thanë "po".
24 Na kanë kontakti.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kaq, kaq

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 33

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 duhet të thonit. Faleminderit.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

3 PY. Gjatë kësaj bisede, a ju pyetën çfarë ndodhi në shtator
4 të 1998 në Qirez, pra sa i takon ndalimit tuaj nga UÇK-ja,
5 kështu?

6 PË. Po, për atë kemi bisedu.

7 PY. Dhe ju u dhatë hollësi ose më ndryshe, u thatë, e
8 konfirmuat sipas fjalëve tuaja keni thënë "më kanë mbajtur të
9 ndaluar në mënyrë të paligjshme", kur ju pyetën ose më
10 ndryshe, kur ata ju pyetën a ju kanë mbajtur në mënyrë të
11 paligjshme, ju e keni konfirmuar, apo jo?

12 PË. Atëherë kam mendu se është e paligjshme. Ma vonë e kam pa
13 se ka qenë e nevojshme, për me u sqaru edhe qëllimi i vizitës
14 tonë, por edhe ne kemi pasë nevojë me pasë informacione për
15 aktivitetet e UÇK-së që me mujtë, takimet e mia jashtë, me
16 pasë informacione sa ma të sakta për situatën e popullatës
17 civile në terren, por edhe aktivitetet e UÇK-së sepse ishte
18 një moskoordinim mes politikës dhe UÇK-së.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] I kërkoj Sekretares së Gjykatës të
20 nxjerrë në ekran dokumentin SITF00055783 deri në 0055996.
21 Anglishtja është në faqen SITF00055872, ndërsa shqipja është
22 faqja e radhës, që mbaron me 873.

23 PY. Dëshmitar, a ja keni dhënë këtë dokument UNMIK-ut në
24 shtator 2001 kur erdhën për t'ju pyetur lidhur me ndalimin e
25 delegacionit tuaj?

1 PË. Po.

2 PY. Biseduam pak për këtë dje dhe ju e konfirmuat që ishte
3 shkrimi juaj ky, dhe se këto ishin emrat dhe përkrah partitë
4 politike të delegatëve. Jo gazetarët, flasim vetëm për
5 deputetët, kështu?

6 PË. Po, këto emra kanë qenë edhe në media.

7 PY. Dua t'ju pyes, në të majtë, ku ka dhe numrat, disa numra
8 janë të rrethuar, të paktën 13 nga emrat ku është emri juaj,
9 Veli Bytyqi, Agim Krasniqi, Simon Augustini, Kurtesh Devaja,
10 Milaim Kadriu, Sokol Blakaj, Musa Binakaj, Hasim Dermaku,
11 Halim Mujku, Qaush Bajrush, Jusuf Telaku dhe Mehdi Bardhi.
12 Këto janë emrat që janë të rrethuar.

13 Ju i keni rrethuar?

14 PË. Ndoshta i kam rrethu unë, por janë emrat e atyne që jemi
15 ndalë, domethënë, me bisedu. Këta të parrethumit janë kthyer për
16 Prishtinë.

17 PY. Në të djathtë, gjashtë nga këto emra, Kurtesh Devaja,
18 Sokol Blakaj, Jusuf Telaku dhe Mehdi Bardhi, janë disa pluse,
19 në disa nga emrat ku përfshihet emri juaj janë disa pluse në
20 të djathtë, ju i keni vendosur këto shenjat plus?

21 PË. Këta nuk e di. Ku me ditë unë para 25 vjetëve a kam qitë
22 një plus a s'e kam qitë një plus. A e kam ba një pikë, a s'e
23 kam ba një pikë.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dua që dokumenti të mbetet në
25 ekran, por për avokatët dhe Trupi Gjykatës për referencë po i

1 referohem dokumentit me numër 034126 deri në 034127. Edhe
2 shqipja ka të njëjtin numër faqesh. Është faqja që mbaron me
3 127.

4 PY. Ju i keni vendosur pluset në krah të gjashtë emrave që
5 janë rrahur, apo jo?

6 PË. Nuk e di që i kam vendosur plusa, edhe distancohena nga
7 fjalia juaj "rrahur". Edhe kjo shumë po më ofendon, madje po më
8 rrezikon, edhe shëndetin, por ma rrezikon edhe familjen time.
9 Por ju nuk e keni këtë problem, besoj.

10 PY. Siç e keni përshkruar ju vetë, a janë këta të gjashtë
11 personat që u përfshinë në kacafytjen në shkollën në Baicë?

12 PË. A kjo është, po.

13 PY. Hetuesit e UNMIK-ut a ju kërkuan të jepnit një deklaratë?

14 PË. Ndoshta kanë kërku. Është kohë shumë e gjatë me ju kujtu
15 të gjitha detalet. Edhe kjo mendoj se është një presion mbi
16 mu.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj që të vendoset në ekran
18 materiali me numër ERN 034135 deri në 034141, na nevojitet
19 faqja 034138 në shqip. Ndërsa anglishtja është dokument i
20 ndarë, me numrin 034138 deri në 034141-ET, dhe këtu duhet
21 faqja e parë në fillim.

22 PY. A është kjo deklarata që e keni shtypur ju vetë dhe keni
23 bërë shënimin me shkrim dore dhe ia keni dhënë UNMIK-ut më 4
24 shtator 2001? Pra, e keni dhënë ju këtë deklaratë të shtypur
25 me makinë shkrimi ose me kompjuter, edhe me këtë shkrimin e

1 dorës?

2 PË. Këtu e shoh kah është e shkruar me shkrim dore, se është
3 e imja. Domethënë tash çka ka ndodhë në tekst aty unë nuk muj
4 me as me prediku as me paragjyku. Po unë nuk kam pasë as nuk
5 kam as sot besim në UNMIK-un. Ka qenë shumë tendencioz, dhe
6 nuk ka ba punë gjithë aq të lavdrushme në Kosovë.

7 PY. Pra, në dëshminë tuaj tani ju po thoni që shkrimi i dorës
8 në krye të këtij dokumenti nuk është i juaji?

9 PË. Është i imi.

10 PY. Dhe data 4 -- ju lutem të përfundojmë fjalinë. Pra, data
11 dhe nënshkrimi nuk janë tuajat?

12 PË. Nuk e thashë ashtu unë, po më keq -- ndoshta më keni
13 keqkuptu, ose përkthimi është i gabushëm. Unë e thashë se ky
14 është shkrimi im.

15 PY. Jo, jo. Unë po ju pyes unë tani. Ai shkrimi i dorës, në
16 krye të faqes, me bojë blu, në shqip --

17 PË. Është shkrimi im.

18 PY. -- a është shkrimi juaj?

19 PË. Po, është shkrimi im. E kam thanë edhe nuk e mohoj, kur
20 është e imja nuk e mohoj për asnjë çmim.

21 PY. Pra, kjo është një deklaratë e shtypur që e keni
22 përgatitur ju dhe keni bërë këtë, e keni bërë këtë shënimin me
23 shkrim dore në krye të faqes. Dhe ia keni dorëzuar hetuesve të
24 UNMIK-ut më 4 shtator 2001, që është një datë që e keni
25 vendosur ju.

1 Duhet patjetër, është e nevojshme që të prisni që të
2 mbarojë fjalia para se të përgjigjeni. Kështu është?

3 PË. Po.

4 PY. E di që ju thatë, e kundërshtoni, distancoheni, nga fjala
5 "arrestim", por ju vetë keni shkruajtur këtu me shkrim dore:

6 "... për shkak të shqetësimit tim me rastin e arrestimit
7 më 20 shtator 1998 në Drenicë nga UÇK-ja."

8 A s'është kështu?

9 PË. Në atë moment kur e kam shkru në 2001, menjherë mbas
10 lufte që jemi marrë me probleme të tjera, [në anglisht] *to be*
11 *or not to be*, ekzistenciale, familjare, të krimeve, të
12 cenimit, domethënë, nuk kam mendu, domethënë, mirë, edhe kam
13 ba gabime, ekzagjerime, i përsërita këtu nja dhjetë herë.

14 Ma vonë, kam pasë kohë me e kthy memorien ngadalë edhe me
15 i studiu gjanat, me marrë informacione, domethënë, edhe për
16 atë unë në letrën e vitit 2022, që jua kam dërgu, jam distancu
17 komplet nga këto deklaratat, domethënë, të mijat gjatë kësaj
18 periudhe. E tash është e juja.

19 Kanë qenë të ekzagjerume, kanë qenë pa -- nuk kam qenë i
20 kjartë, i bindur.

21 PY. Por në deklaratën që e keni përgatitur ju, pasi erdhën
22 hetuesit të bisedonin me ju, ju keni përshkruar çfarë ka
23 ndodhur me Hashim Thaçin, Rexhep Selimin, Gani Kocin dhe Sabit
24 Gecin, të cilët e udhëhiqnin këtë grup, i cili, pra këta ishin
25 personat që po udhëhiqnin grupin e UÇK-së që ju mbajti ju të

1 ndaluar në Qirez, kështu?

2 PË. Në Qirez e kam sqaru dje unë.

3 PY. Ju kërkoj ndjesë, do ta riformuloj pyetjen se kishit të
4 drejtë. E kisha fjalën "Qirez dhe Baicë" e kam fjalën për të
5 gjithë ndalimin, gjithë periudhën e ndalimit.

6 PË. Të gjitha i kam sqaru dje.

7 PY. Në letrën tuaj, flisni konkretisht për trajtimin në
8 shkollën ku ju mbajtën, për trajtimin që patët në shkollën ku
9 ju mbajtën në Baicë, kështu?

10 PË. Të gjitha i kam thanë dje, edhe të gjitha ato që i kam
11 thanë dje qëndroj pranë tyre, dhe janë të vërteta.

12 PY. Keni thënë shumë herë gjatë dëshmisë dje se keni dhënë
13 një deklaratë për shtyp shkurtimisht pasi u kthyet në
14 Prishtinë. Dhe aty keni përshkruar saktësisht se çfarë ka
15 ndodhur. A ju kujtohet kjo që thatë në dëshminë tuaj?

16 PË. Kjo është konferencë, muj me thanë për mu, historike.

17 PY. Po a ju kujtohet, a ju kujtohet dje, që na e thatë këtë?
18 Dje na thatë, që kam dhënë këtë konferencë për shtyp dhe aty
19 përshkruaj saktësisht atë që ka ndodhur.

20 PË. Po, dhe aty e kam përshkru saktësisht atë që ka ndodhur.
21 Edhe kam dëshirë, mundësisht, me e ndëgjue edhe sot atë
22 konferencë.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shkojmë në faqen 034141-ET, në të
24 njëjtin dokument, i njëjti numër faqe në shqip, në mes të
25 faqes.

1 PY. Në këtë deklaratë të shtypur që keni përgatitur ju dhe ia
2 keni dhënë UNMIK-ut më 4 shtator 2001, po ashtu përshekruani
3 konferencën për shtyp, apo jo? Është kështu, e përshekruani?

4 PË. Po, nuk po shoh unë që e kam përshekru. Se unë këtu kam
5 folë edhe për 27 prillin 1999, për ato krime që ju kurrë s'i
6 keni zbardhë, as jeni interesu për to. Kam folë për shumë
7 gjana, për ngjarjet në Drenicë, edhe të tjera. Edhe mu më
8 intereson pas 25 vitesh me pa atë konferencë shtypi, me e
9 ndëgju.

10 PY. Ju keni thënë që keni organizuar konferencë me gazetarë
11 në Prishtinë, dhe për shkak të sigurisë dhe mbrojtjes së jetës
12 së delegacionit të arrestuar keni dhënë deklaratë të matur dhe
13 të balancuar me gazetarët dhe nuk keni folur fare për dhunën
14 që është ushtruar ndaj jush, sepse do t'u kishte vendosur
15 jetën në rrezik permanent.

16 E keni thënë në këtë letër që konferenca për shtyp nuk
17 ishte tamam e vërteta. Ju nuk folët për dhunën për arsye
18 sigurie.

19 PË. Mendoj se distancohem nga ky vlerësim i imi, sepse ne
20 jemi kthyer në Prishtinë, ne ishim më të sigurt në mal, edhe në
21 Baicë edhe në Qirez, por në Prishtinë ishim në shtëpinë tonë.
22 Krejt çka ishim në rrezik në Prishtinë, çdo ditë ishim në
23 rrezik nga serbët. Dhe atë ditë, dy ditë, dy orë mbasi jam
24 kthyer, nëse kurrë në jetë s'kam pasë arsye me thanë të
25 vërtetën, çka ka ndodhë, mbas dy orëve që jam kthyer nga mali e

1 kisha thanë atë ditë të vërtetën. Dhe vetëm atë ditë e kam

2 thanë të vërtetën. Edhe sot para jush.

3 PY. Pak më poshtë në letër, drejt fundit të faqes, ju thoni:

4 "Ky është një vlerësim i ngjarjes së hidhur që përjetoi

5 delegacioni ynë zyrtar i Prishtinës në shtator 1998 në

6 Drenicë, e cila ngjarje njollosi figurat tona dhe të familjeve

7 tona. Dhe kemi dëshirë që të dalë e vërteta në shesh, pa e

8 rënduar askënd për atë që nuk e ka bërë, por të ngarkohet

9 secili për veprimet e veta jonjerëzore kundër aktivistëve

10 politikë të Kosovës të cilët ishin dhe janë në rrezik

11 permanent."

12 Dhe e keni nënshkruar.

13 Pra, ju ishit të shqetësuar për rreziqet me të cilat u

14 përball delegacioni juaj, apo jo?

15 PË. Na ishim në luftë. Domethënë, edhe në luftë secili është

16 i rrezikum. Sa i përket UÇK-së unë personalisht asnjëherë në

17 jetë nuk kam qenë i rrezikumë, por përkundrazi, kam qenë i

18 mbrojtun prej tyre. Kur ka pasë nevojë edhe me këta, këta muj

19 me jua dëshmue, me shumë fakte.

20 Unë edhe familja ime kemi qenë gjithmonë të rrezikumë dhe

21 të vramë dhe të arrestumë prej forcave serbe. Nuk po du me i

22 qujtë tash fashiste, terroriste, se ato i dini, se janë, ata

23 kanë ba gjenocid, nuk është pranë as ajo, as nuk i keni dënu

24 atë gjenocid. Por, aty kam pasë mundësi mbas dy orëve me

25 shpreh mllefin tim, nëse ka pasë mllef, domethënë, ndaj asaj

1 bisede në Drenicë.

2 PY. Dëshmitar, ju keni thënë po ashtu gjatë dëshmisë suaj që
3 e keni ekzagjeruar dhe e bëtë për hakmarrje politike. Por në
4 deklaratën që unë ju lexova, të vitit 2001, ju thoni që duam
5 që të zbulohet e vërteta dhe se nuk fajësoni askënd që është i
6 pafajshëm. Thjesht doni që personat që janë, që ishin
7 përgjegjës, të ngarkohen për veprimet e veta.

8 Këtu nuk flitet as për hakmarrje, as për mospëlqim të
9 ndonjë grupi të caktuar. Ju vetë me fjalët tuaja keni thënë,
10 është që të zbulohet e vërteta, a nuk është kështu?

11 PË. Shiqo --

12 PY. Të dalë e vërteta në shesh?

13 PË. Edhe vetë UÇK-ja është e interesime me dalë e vërteta,
14 edhe me u hjekë kjo re e zezë dhe kjo mjegull e sajuar nga
15 senatori zviceran Dick Marty fillimisht, edhe nga shumë qarqe
16 të tjera, serbe, ruse, anti-Kosovë.

17 PY. Dëshmitar, nuk ishte kjo pyetje ime. Pyetja ime është për
18 fjalët që keni thënë ju vetë. A keni thënë kështu në 2001? A
19 keni thënë vetëm që të dalë e vërteta në shesh dhe të
20 ngarkohet secili për veprimet e veta?

21 PË. Edhe sot kam dëshirë me dalë e vërteta, edhe nesër, edhe
22 gjithmonë. Por thashë edhe një herë unë absolutisht
23 distancohena nga këto ekzagjerime, fjalë për revansh, për
24 fushata, emocionale, të pakontrollume, paballancume.

25 Domethënë, është e padrejtë me e -- akuzua dikënd për diçka që

1 s'ka bo.

2 Në 2001 nuk kam pasë kohë me mendu për këto punë. Kam
3 pasë punë të tjera, familjare.

4 PY. Dëshmitar, në atë kohë më 4 shtator i keni dorëzuar, i
5 keni dhënë edhe disa dokumenta UNMIK-ut që lidheshin, kishin
6 lidhje me incidentin. Vetë ju ua keni dhënë këto dokumenta, ju
7 i kishit këto dokumenta. Dhe unë do jua tregoj të gjitha,
8 sipas radhës.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Fillojmë me dokumentin që mban
10 numrin 03415 [sipas përkthimit] deri në 034155, me të njëjtin
11 numër edhe shqipja, edhe anglishtja.

12 PY. Dëshmitar, e shihni artikullin në ekran?

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shkojmë në fund të shqipes.

14 PY. Është shkrimi juaj ky, me datën 4 shtator 2001, edhe
15 nënshkrimi juaj.

16 PË. Këto farë copa të letrës, për mendimin tem nuk kanë
17 kurrfarë relevance. Domethënë këto kanë qenë me një fletushkë
18 partiake që është botu, ka mujtë secili me e pasë në dorë.
19 S'është kurrgjë sekret, s'është kurrgjë ngarkuese, s'është
20 kurrgjë e rëndësishme, për mendimin tim. Është njëfarë
21 informatore që është botue në kuadër të Lidhjes Demokratike të
22 Kosovës, edhe unë s'e kam botu, as e kam shkru, as e kam,
23 domethënë, edhe unë e mendova çfarë dokumenti doni me qitë.
24 Edhe, por e di se s'keni, s'ka kurrfarë dokumenti lidhur me
25 këtë. Copat e gazetave janë, si gazetat e Ballkanit ma.

1 PY. Dëshmitar, pyetja ime ishte kështu, dhe ju lutem ta
2 dëgjoni me vëmendje, dhe vetëm asaj pjese përgjigju. Në mënyrë
3 që të respektojmë kohën që më është caktuar.

4 Unë po ju pyes kështu: A e shihni nënshkrimin tuaj, dhe
5 shkrimin tuaj të dorës në fund të faqes dhe a është ky një
6 dokument që ia keni dhënë ju UNMIK-ut më 4 shtator në 2001,
7 kur po ju tregonit për ngjarjen e shtatorit 1998?

8 PË. Është shkrimi im e nënshkrimi im, edhe ky nuk është
9 kurrfarë dokumenti. Copat e gazetave s'muj me qenë dokument.
10 Ato i shkrun kush të don, simbas dëshirës së vet.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
12 pyetja është kjo: A e ia keni dhënë ju këtë dokument UNMIK-ut?

13 DËSHMITARI: Po, po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 mund të vazhdoni, Prokurore.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

17 PY. E keni bërë këtë gjë në atë kohë sepse ju mendoni që po
18 jepnit informacion që kishte lidhje me ndalimin tuaj. E kuptoj
19 që opinionin jua ka ndryshuar, është i ndryshëm tani.

20 PË. UNMIK-u i ka pasë këto --

21 PY. Por, kjo ka qenë arsyeja pse e keni dhënë dokumentin, apo
22 jo?

23 PË. -- para se me ia dhanë unë, sepse këto kanë qenë publike.

24 PY. Nuk është kjo pyetja ime, Dëshmitar. Pyetja ime është
25 kjo: Kur ua ke dhënë këtë informacion UNMIK-ut, sepse sapo

1 konfirmove që ua ke dhënë, kur ia ke dhënë këtë informacion,
2 këtë e keni bërë sepse mendonit që këtu përmbahej informacion
3 që kishte lidhje me ndalimin tuaj në shtator 1998, për këtë
4 arsye ia dhatë, apo jo?

5 PË. Po, edhe ju po thoni se qasja ime ka ndryshuar. Qasja ime
6 në fakt është kompletu, dhe është saktësu kur kam pasë kohë ma
7 vonë me u mendu me mbledhë informacione edhe nga terreni, edhe
8 nga individë të caktumë, për me ditë vetë vërtet çka ka
9 ndodhë.

10 Në këtë kohë mbas lufte, deri, domethënë, s'kam pas kohë
11 një minutë me mendu për këto punë. Kam pasë punë të tjera,
12 familjare.

13 PY. E kuptojmë.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do kërkoj Sekretaren që të
15 paraqesë në ekran dokumentin P00139 [sipas përkthimit] edhe
16 mban të njëjtën numër dokumenti si në versionin në shqip ashtu
17 dhe në anglisht. Ju lutem në versionin në shqip të kalojmë në
18 fund të faqes. Faleminderit.

19 PY. Ky është një dokument tjetër, është një artikull gazete i
20 Koha Ditore, më datë 27 [sipas përkthimit] shtator 1998, që ju
21 ia keni dhënë UNMIK-ut më 4 shtator 2001. Ky është shkrimi dhe
22 nënshkrimi juaj në fund të faqes. Ju ia keni dhënë këtë
23 informacion UNMIK-ut sepse mendonit që aty përmbahej apo
24 kishte informacion që lidhje me atë çfarë ju kishte ndodhur
25 ju, a është e vërtetë kjo?

1 PË. Kjo është, nënshkrimi im është, kjo është një gazetë
2 publike që ka dalë çdo ditë, edhe ka mujtë me e pasë UNMIK-u
3 para meje, mbas meje, ka mujtë me e pasë secili qytetar i
4 Kosovës dhe jashtë saj. Kjo s'është kurrfarë dokument, as
5 sekret as kurrgjë. Është një letër publike, një copë letre
6 publike.

7 PY. E kuptoj këtë, megjithatë nga ky dokument mund të shohim
8 që këtë informacion UNMIK-u nuk e mori nga publiku, por e mori
9 prej teje, sepse ky është dokument që ka shkrimin e dorës
10 tuaj, dhe ka dhe nënshkrimin tuaj. Kështu që pyetja ime është
11 kjo: A ia dhatë këtë informacion UNMIK-ut sepse besonit që --

12 PË. Po, po.

13 PY. -- ishte me rëndësi për atë çfarë kishte ndodhur në
14 shtator të 1998?

15 PË. Po, po. Edhe kurrfarë gabimi ky s'është. As kurrfarë --
16 kjo ka qenë copë gazete, kemi mujtë me e marrë në rrugë, në
17 kioskë, ku të dush. Publike.

18 PY. Në rregull, por jua dhatë atyre, kur ua dhatë UNMIK-ut
19 pra në shtator 2001, i takon që ka qenë tre vjet pasi ishte
20 botuar dhe ti i takon që e ke ruajtur këtë artikull dhe ai ka
21 lidhje me ndalimin tuaj në 1998, a është e vërtetë kjo?

22 PË. Unë i kam rujtë artikujt e ndryshëm të gazetave, dhe
23 besoj që atë e ban çdo politikan. Edhe ky artikull, kjo
24 gazetë, e ka pasë 100 për qind UNMIK-u para se me e marrë prej
25 meje. Edhe e kam ditë edhe s'ka kurrfarë, për mu, s'ka

1 kurrfarë relevance. Për mua, e kam fjalën, për ju muj me kanë
2 gjithçka.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
4 paraqiste në ekran dokumentin SITF00055783 deri në 00055996.
5 Në këtë dokument dua që të paraqisni faqen 00055883, dhe në
6 shqip, faqen 0055884 [sipas përkthimit]. Është rreth faqes 100
7 të versionit në PDF, nëse mund ta ndihmojë Sekretaren.
8 Faleminderit.

9 PY. Meqenëse po flisnim për artikuj gazetash, ky është një
10 tjetër artikull gazete që mban datën 2 shtator 1998. Më herët,
11 në të njëjtin muaj. Në fund kemi shkrimin e dorës tuaj dhe
12 datën që është e njëjta datë, data 4 shtator 2001, dhe
13 nënshkrimi juaj. A e është e vërtetë kjo dëshmitar?

14 PË. Është nënshkrim im, dhe këtu flitet për të zhvendosurit
15 që ka, shqiptarët që janë ndodhë para një katastrofe të
16 vërtetë humanitare, për të cilën katastrofë shumë pak kush
17 është i interesime.

18 PY. Edhe këtë artikull ia keni dhënë UNMIK-ut sepse besonit
19 që kishte lidhje me atë çfarë ju kishte ndodhur juve në
20 shtator 1998, kështu?

21 PË. Edhe kjo është copë letre, gazete, që ka mujtë me e pasë
22 UNMIK-u, ka mujtë me e pasë secili, edhe mujt me e pasë sot
23 secili. Është publike.

24 PY. Përsëri, Dëshmitar, kjo nuk është pyetja ime. Pyetja ime
25 është kjo: Ju ia dhatë UNMIK-ut këtë dokument, këtë datë, në

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 47

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 këtë ditë, sepse mendonit që ky artikull kishte lidhje me

2 ngjarjet e shtatorit të 1998, a është e vërtetë jo?

3 PË. Po unë ju thashë po në fillim, se kjo është nënshkrimi im

4 edhe aty ku është nënshkrim im, me asnjë çmim nuk them që nuk

5 është nënshkrimi im. Asnjëherë, mbajeni mend këtë.

6 Regjistrojeni ju lutem.

7 PY. Nuk po sugjeroj, nuk po them që po e mohoni, por pyetja

8 është pse ia dhatë këtë informacion UNMIK-ut dhe përgjigja që

9 sugjeroj është që ju besonit që ky artikull kishte lidhje me

10 ngjarjet e shtatorit 1998, a është e vërtetë kjo?

11 PË. Kjo edhe mund të ketë lidhje, lufta ime 25 vjeçare,

12 përveçse kam ba luftën ballë për ballë me regjimin e

13 Millosheviqit, çdo ditë, dhe çdo natë, dhe e kam pagu ma së

14 shtrenjti në Kosovë, lufta ime këtu e 25 vjet ka qenë edhe

15 zbardhja e të vërtetës, domethënë, të bisedave që kemi pasë në

16 Qirez dhe në Baicë. Kjo ka qenë një luftë e cila më mundon

17 edhe sot e kësaj dite, edhe që familja jeme po e pagun ma së

18 shtrenjti ma. Bile e kam, e kena pagu edhe me shkarkim nga

19 pozita e ambasadorit.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të

21 paraqesë dokumentin e radhës, që është dokumenti 034162-

22 034162. Mendoj që përkthimi në anglisht ka të njëjtin numër,

23 por përfundon me -ET në fund.

24 PY. Në fund të kësaj flete këtu, siç mund ta shikoni është

25 një artikull i Bota Sot, gazetës Bota Sot, nga 9 korriku i

1 vitit 2000, që ju keni nënshkruar më 4 shtator 2001 dhe ia

2 keni dorëzuar --

3 PË. Z. Kryetar i Gjykatës --

4 PY. -- UNMIK-ut, a është e vërtetë kjo?

5 PË. -- dëshiroj të kalojmë në seancë private. Nëse është e

6 mundur.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë

8 arsyesh?

9 DËSHMITARI: Kam arsyet e mia, unë, [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]. Edhe

11 unë jam shumë i shqetësuar dhe një herë po jua them për fatin

12 e tyre. Jo për fatin tim, fati im s'është i rëndësishëm.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkesa juaj

14 rrëzohet.

15 Mund të vazhdoni, Prokurore.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, a ia keni dhënë këtë dokument UNMIK-ut sepse

18 besonit që kishte lidhje me ngjarjet e shtatorit të 1998?

19 PË. Çfarë rëndësie ka kjo kur këto janë shkrime të gazetave?

20 Edhe UNMIK-u, edhe secili në botë ka pasë mundësi me i pasë

21 shkrimet e gazetave, domethënë, unë normal që ia kam dhanë

22 unë, se ku është nënshkrimi unë nuk muj me -- por kjo çka po

23 më pyetet dhe kjo që po më refuzohet për me pasë seanca

24 private, kjo është rrezikim i drejtpërdrejtë i jetës së

25 familjes sime. Dhe këtë nuk besoj që keni të drejtë me e bo,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 49

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 por ju keni mundësinë me e bo, dhe vazhdoni e bani.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke pasur
3 parasysh përgjigjen e fundit, do kërkoja që të kalojmë në
4 seancë private, vetëm për këtë pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare le të kalojmë në seancë private.

7 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur] Riklasifikuar në
8 bazë të F2133RED

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 jemi në seancë private.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, juve thatë që ky është kërcënim, pse është
13 kështu? Sepse ju keni të renditur këtu si ndër personat që
14 është nën hetim nga shërbimi sekret i UÇK-së? Për këtë arsye?
15 PË. Jo. Kjo është kërcënim nga ana e Gjykatës, sepse unë kam
16 kërku prej fillimit me pasë seancë private. Sepse unë jam
17 përgjegjës për fatin e fëmijëve të mij, se na jetojmë në
18 Ballkan. Nuk jetojmë në Finlandë as në vendet skandinave as në
19 Evropë as në Amerikë ku respektohet maksimalisht ligji, dhe të
20 drejtat e njeriut.

21 Nji ditë, misioni juaj do të përfundon. Kur do të
22 përfundon, e dini dhe e dinë ata që e kanë urdhnu ndërtimin e
23 këtij misioni. [REDAKTUAR]. S'është me
24 randësi për mu. Unë çdo mëngjes lutena me qenë i vdekun, dhe
25 çdo mbramje lutena para se me flejtë që nesër mos të zgjohem i
gjallë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 50

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR] asnji trup gjykues.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kjo ishte e vetmja pyetje që doja
7 që të bëja në seancë private. Nuk kam pyetje të tjera për
8 seancë private, të nderuar Gjykatës.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] A i ke thënë plotësisht arsyet
10 tuaja pse kërkon seancë private?

11 DËSHMITARI: Kam thanë këto janë arsye familjare,
12 shëndetësore, të sigurisë. I nderumë, z. Kryetar i Gjykatës,
13 edhe e respektume, znj. Prokurore. Këto janë arsyet, nuk janë
14 arsye për mu. Unë jam krejtësisht i hapur, transparent.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

16 DËSHMITARI: [Në anglisht] Yes.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thjesht po ju
18 pyes, a i ke thënë plotësisht kërkesën tënde për seancë
19 private, po apo jo?

20 DËSHMITARI: Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykues
22 ka informacion të pamjaftueshëm për të miratuar seancë private
23 për të vazhduar me këtë linjë pyetjesh, kështu që do të
24 kalojmë përsëri në seancë publike.

25 ~~{Seancë e hapur}~~

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 jemi në seancë publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
4 vazhdoni, znj. Prokurore.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do kthehemi në një dokument
6 tjetër, jo te ky dokumenti që kemi përpara. Dokumenti është
7 SITF00055783 deri në 00055996, më konkretisht do të fillojmë
8 nga faqja 00055895 në anglisht, dhe në faqen 00055897 në
9 shqip.

10 PY. Ky është një tjetër artikull gazete. Në fund fare është
11 shkrimi i dorës tuaj, besoj, por nënshkrimi nuk është
12 pasqyruar, është i prerë. A është shkrimi i dorës dëshmitar
13 këtu në fund?

14 PË. Po, shkrimi i dorës time.

15 PY. Ky është një artikull për të cilin ju na treguat dje që
16 delegacioni juaj nuk u lejua që të kalonte dhe që u ndaluar në
17 Pejë në mënyrë të tillë që nuk mund të përfundonit vizitën
18 tuaj humanitare?

19 PË. Është e vërtetë.

20 PY. Këtë artikull e keni dorëzuar gjithashtu për UNMIK-un
21 sepse besuat që kishte lidhje me ngjarjet e shtatorit të 1998,
22 a është e vërtetë kjo?

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që në të
24 njëjtin dokument -- jo, ju kërkoj ndjesë, do të shkojmë në një
25 dokument tjetër. Dokumenti është provë materiale P00320. Është

1 një dokument në disa gjuhë. Një fletë është në anglisht, fleta
2 tjetër është në shqip.

3 PY. Ky është një dokument i cili nuk ka as nënshkrimin tuaj
4 dhe as shkrimin e dorës. Megjithatë, është një dokument i cili
5 ka të njëjtën shënim në fund fare, ku i njëjti hetues thotë që
6 këtë dokument e ka marrë prej jush. A ju kujtohet që këtë
7 dokument t'ia keni dhënë UNMIK-ut më 4 shtator 2001?

8 PË. Nuk më kujtohet kjo. Nuk kam nënshkrim timin. Aty ku
9 s'kam nënshkrim timin mund me pasë spekulime.

10 PY. A ju kujtohet t'ju keni dhënë atyre një apel të
11 drejtuesit të parlamentit, të kryetarit të parlamentit,
12 ndërkohë që delegacioni ishte i ndaluar dhe ku kërkohet nga
13 kryetari i parlamentit që ju të liroheshit? A ju kujtohet t'ia
14 keni dhënë këtë dokument?

15 PË. Nuk më kujtohet.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj që të kthehemi përsëri te
17 dokumenti SITF00055783 deri në 00055996. Konkretisht dua të
18 paraqitet faqja SITF00055877 në versionin në anglisht dhe
19 SITF00055879 në versionin në shqip. Ta zvogëlojmë dokumentin
20 në shqip në mënyrë të tillë që ta shohim të gjithë faqen.
21 Faleminderit.

22 PY. Dëshmitar, edhe ky dokument nuk ka shkrimin tuaj të dorës
23 dhe as nënshkrimin tuaj, por ka një numër të provës materiale
24 që është XYZ-8, që është e njëjta, dhe ka të njëjtin shënim
25 nga hetuesi i UNMIK-ut në fund fare, ku thuhet që ky është

1 dokument që është marrë prej jush më datë 4 shtator të 2001.
2 Kjo ka të bëjë me një vizitë të mëhershme, të mëparshme, pra
3 lista e përfaqësuesve të delegatëve të një prej vizitave të
4 mëhershme humanitare që keni organizuar.

5 A ju kujtohet t'ia keni dhënë këtë dokument hetuesve të
6 UNMIK-ut?

7 PË. Nuk më kujtohet dhe kjo është vetëm një listë e anëtarëve
8 të delegacionit që kemi ba një vizitë. Njanën prej katër
9 vizitave.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull. Në të njëjtin dokument
11 që kemi në ekran do i kërkoja Sekretares që të transmetonte
12 faqen 00055874 në anglisht, dhe 00055875 [sipas përkthimit] në
13 shqip.

14 PY. Ky është përsëri një tjetër dokument si pjesë e të
15 njëjtës linjë, dhe të njëjtës grupi informacionesh që mban
16 shënimin XYZ-9, por këtu nuk kemi as nënshkrimin tuaj, dhe as
17 shënimin e dorës tuaj. Kjo është lista e delegatëve nga data
18 29 gushti që i përket një tjetër vizite tuajën. A ju kujtohet
19 që këtë material, këtë dokument, t'ia keni dhënë hetuesve të
20 UNMIK-ut?

21 PË. Nuk e besoj. Këtu ka edhe emna që s'kanë qenë fare në
22 vizitë.

23 PY. Në rregull. Duke iu kthyer dhe një herë kërkesës së bërë
24 nga kryesia e parlamentit. E di që thatë që nuk patë as
25 shkrimin e dorës as nënshkrimin tuaj në fund të këtij

- 1 dokumenti, por pyetja që kam për ju është kjo: A jeni në
2 dijeni që kryesia e parlamentit ka bërë këtë kërkesë ndërkohë
3 që ju ishit të ndaluar, nëpërmjet të cilës kërkohet që ju të
4 liroheshit?
- 5 PË. Me thanë të drejtën, ish-kryetari i parlamentit, akademik
6 Idriz Ajeti, tash është i ndjerë, dhe kisha pasë me e pyetë
7 apo me pasë qenë gjallë, a ka bo një letër të tillë. Unë nuk
8 jam në dijeni. Domethënë, ka mujtë me ba, por simbas mendimit
9 nuk e ka -- nuk jam në dijeni dhe nuk mund ta konfirmoj.
10 Përndryshe kam respekt për atë person.
- 11 PY. Në rregull. Dëshiroj të kthehem pas -- atëherë, kur
12 ishit i ndaluar, dje në fakt ju pyeta në qoftë se ju ofruan
13 apo jo ndonjë shërbim apo kujdes mjekësor. Kjo pasqyrohet në
14 transkriptin real, rreshtat 13 deri 20 të ditës së djeshme. Ju
15 pyeta në qoftë se juve ose ndonjë anëtar tjetër të
16 delegacionit iu ofrua trajtim mjekësor. Ju thatë që:
17 "S'kishim nevojë për këtë"
18 Pyetja ime ishte në qoftë se ju ofrua ndonjë ndihmë e
19 tillë, apo jo.
- 20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kështu që në kuadër të pyetjes që
21 do të bëj i kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin
22 034236 deri në 034287, konkretisht faqen 034261 në anglisht,
23 dhe 034278 në shqip. Në anglisht kërkoj që të ulem te faqja më
24 poshtë, nga fundi i faqes.
- 25 PY. Dëshmitar, në mes të faqes ku thoni:

1 "Mua më morën në pyetje."

2 Prokurori thotë:

3 "Kush ishte aty?"

4 Ju thoni:

5 "Hashim Thaçi dhe Sabit Geci, dhe ata nuk kanë pasur
6 ndonjë rregull. Ata hynin dhe dilnin nga dhoma. Ata nuk na
7 kanë ofruar asnjë ndihmë mjekësore, si për shembull të na
8 pyesnin se a kishim ndonjë dhimbje dhe të na siguronin ndonjë
9 mjek."

10 A ju kujtohet, Dëshmitar, që në fakt nuk ju është ofruar
11 asnjëherë ndihmë mjekësore, a është e vërtetë kjo?

12 PË. Nuk kemi kërku as kemi pasë nevojë për ndihmë mjekësore.

13 PY. Dhe nuk ju ofrua fare, asnjë ndihmë mjekësore.

14 PË. Nuk di pse duhet dikujt me ia ofru ndihmë mjekësore nëse
15 ai nuk e kërkon.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm thjesht
17 përgjigjuni pyetjes. Pyetja ishte, a ju ofrua ndonjë ndihmë
18 mjekësore apo jo?

19 DËSHMITARI: Jo, se s'kishte nevojë.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

21 PY. Dje, na thatë se kur po shkonit në Çiçavicë juve u
22 rrëzuat katër herë.

23 PË. Jemi rrëzua disa herë.

24 PY. She kjo ishte hera e parë domethënë, dje ishte hera e
25 parë që na e përmendët rrëzimin. A po thoni që nuk e dini se

1 sa herë u rrëzuar sot?

2 PË. Thashë, ndoshta jam rrëzuar tri-katër herë. E kam përshkrue
3 terrenin malor të vështirë, edhe është kanë krejtësisht
4 normal, domethënë, e mundshme me u rrëzuar.

5 PY. Dua t'ju bëj disa pyetje të tjera lidhur me këtë rast.
6 Kur ju u rrëzuar, dua që t'i marrim njëra pas tjetrës të
7 gjitha herët që u rrëzuar.

8 Herën e parë, në çfarë pike ishit kur po ngjiteshit
9 malit, herën e parë kur u rrëzuar?

10 PË. Kjo është një pyetje që askush në botë nuk mundet me u
11 përgjigj, me ditë vendin ku jam rrëzuar, mbas 25 vjetëve.

12 PY. Nuk po ju kërkoj koordinatat. Por thjesht po ju pyes se
13 ku ishit, sepse ju na thatë për herë të parë që ju kujtohet që
14 jeni rrëzuar, kështu që dua të di ca hollësi të tjera lidhur
15 me atë se çfarë ju kujtohet sa i takon këtyre rrëzimeve.

16 PË. Një herë saktë më kujtohet --

17 PY. A mund të na tregoni lidhur me këtë ju lutem?

18 PË. -- që jam rrëzuar, saktë, domethënë, të tjerat më ka
19 rrëshqitë këmba dhe s'ka lidhje ajo. Është kanë e mundshme.
20 Domethënë, në oborrin e shkollës derisa shkoja në tualet, se
21 tualeta në oborrin e shkollës, me gjendje ka qenë jashtë, larg
22 shkollës. Nuk ka qenë mbrenda objektit. Ka qenë natë kur kam
23 dalë në tualet, edhe jam rrëzuar, jam ngritë. Domethënë kjo
24 s'është kurrfarë, domethënë, kam njëfarë mënyre unë s'kam pasë
25 dëshirë me u rrëzuar, por kam pasë dert me u rrëzuar. Jam rrëzuar.

1 Çka me ba tash?

2 PY. Pra, tani po na thoni që keni, jeni rrëzuar dhe një herë
3 tjetër, jo në Çiçavicë, por në oborrin e shkollës.

4 PË. Ka pasë vend, thashë --

5 PY. Këtë po thoni?

6 PË. -- jam rrëzu tri-katër herë. Sepse unë e kam pasë edhe
7 një peshë, e kam një peshë ma të randë edhe na s'jena kanë të
8 ushtrumë me ecna për male. Domethënë, nëpër zona të vështira,
9 nëpër gropa, në luftë. Kena pasë vëmendjet te gjujtjet e
10 ushtrisë serbe. Domethënë gjithçka ka qenë, ka qenë terr,
11 domethënë, ka qenë shi. Ka qenë shi. Ka qenë lagësht. Dhe nuk
12 paraqet këtu nanji krim me u rrëzu.

13 PY. Jo, thjesht dua që të di ca hollësi lidhur me këto
14 rrëzimet tuaja.

15 PË. Detalet nuk i di.

16 PY. Çfarë ju kujtohet lidhur me rrëzimet, më lejoni që të
17 përfundoj pyetjen. A u penguat? U përplasët me dikë?
18 Rrëshqitët?

19 PË. Me askënd, me askënd. Më ka rrëshqitë këmba --

20 PY. Çfarë ndodhi, si u rrëzuat?

21 PË. -- edhe të tjerat as nuk më kanë intersu, as i mbaj mend,
22 as nuk di. Domethënë, krejtësisht thjesht. Sikur rrëzohet çdo
23 njeri. S'besoj sikur njeri në jetë nuk i ka ndodhë ndonjiherë
24 me u rrëzu.

25 PY. Po si u ngrite pastaj kur u rrëzove? Si re?

1 PË. Unë jam kanë sportist, domethënë, dhe jam ngritë pa asnji
2 problem. Edhe kam vazhdue misionin tonë.

3 PY. Më bëhet qejfi që u ngritët shpejt, por pyetja ime është
4 si ratë. Domethënë me çfarë pjese të trupit, ratë me shpinë,
5 ratë me fytyrë, si?

6 PË. Këto janë pyetje të cilat unë nuk muj me -- nuk di, kam
7 harrru, unë si kam ra, jam çu, domethënë, mbas 25 vjetëve me më
8 pyetë ku jam rrëzu, si jam rrëzu, domethënë, për mu është
9 vështirë me u përgjigj. Është spekulim. S'kam dëshirë me
10 spekulu.

11 PY. Atëherë, kjo është një rrëzim. A mund të na përshkruani
12 një tjetër rast kur u rrëzuat, a mund të na përshkruani ndonjë
13 herë tjetër --

14 PË. Unë e thashë edhe një herë --

15 PY. -- kur u rrëzuat me detaje të tjera?

16 PË. -- ju vërtet po më mundoni, por kjo është detyra juje,
17 kryeni detyrën e juje. Respekt për ju. Kryejeni ju detyrën e
18 juje. Edhe me më pyetë mu për detalet ku jam rrëzu, si jam
19 rrëzu, mbas 25 vjetëve, kjo është për mu është [në anglisht]
20 non-sense. Është -- s'muj me i kujtu ato. Unë nuk muj me kujtu
21 ndoshta dje me më pa ndodhë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ardhur
23 koha të bëjmë pushimin e paradites. Do bëjmë pushim për gjysmë
24 ore tani, dëshmitar. Sekretarja do të të nxjerrë nga salla e
25 gjyqit.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
3 pushim deri në orën 11.30.

4 --- Pauza fillon në orën 11.01

5 --- Seanca rifillon në orën 11.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

7 Asistente, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,
10 Prokurorja ka ende disa pyetje për ju, kështu që do t'i
11 kalojmë fjalën.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Gjatë dëshmisë suaj, keni përmendur konferencën për
14 gazetarët që dje thatë ose më 22 ose më 23 shtator, kështu?

15 PË. Po, ashtu është.

16 PY. Konferencën për shtyp e keni dhënë pasi ju çoi Kryqi i
17 Kuq në Prishtinë, tani këtë konferencë e mbajtët menjëherë apo
18 shkuat një herë në shtëpi?

19 PË. Para se të përgjigjja, prapë do të protestoj hapur për
20 pamundësinë që të zhvillohet seanca private dhe sa të jam këtu
21 në Gjykatë do ta bëj këtë protestë.

22 Sa i përket konferencës. Konferencën e kam mbajt mbas dy
23 orëve që jemi shku në Prishtinë. Së pari kam shku te shtëpia
24 dhe pastaj nga shtëpia jam kthi në konferencë shtypi. Më kanë
25 thënë që ka gazetarë të interesum dhe jam kthi në selinë,

1 atëherë a kanë e LDK-së ku ka qenë aty edhe zyra e ish-
2 presidentit Rugova dhe ka qenë aty zyra që janë mbajt edhe
3 konferenca për shtyp.

4 PY. Thatë se shkuat në shtëpi. Në shtëpi çfarë bëtë?

5 PË. Në shtëpi i kam vizutu familjen time, i kam pa. Kam ba
6 tualetin, domethënë, normal si çdo njeri normal. Jam përgatitë
7 edhe kam shku në konferencë të shtypit.

8 PY. Kur thatë jam pastru, domethënë, bëtë banjë, u rruajtët -
9 -

10 PË. Jo, vetëm jam rrujt. Se unë në këtë farë karrierën time,
11 nja 100 herë jam rrujt kur kam dalë në demonstrata dhe me u
12 ballafaqu me Serbinë se kam dashtë me qenë kufomë e pastër dhe
13 shpeshherë jena vesh trashë kur kemi dalë në këto zhvillimet
14 politike se kemi ditë që kena me përfundu në burg e të
15 arrestum. Edhe aty kam shku me u rrujt se unë e kam shprehi,
16 s'ka ditë që nuk rruhna, asnjëherë në jetën time.

17 Këto janë detale muj me thënë paksa të parëndësishme.

18 PY. Kur u takuam javën e kaluar - dhe për procesverbal bëhet
19 fjalë për materialin me numër 116678-116787, më konkretisht
20 faqja 116776, paragrafi 34 dhe 35 - këtu ju thoni pasi Kryqi
21 Kuq ndërkombëtar ju çoi në Prishtinë, shkuat në shtëpi, takuat
22 pak familjen, u rruajtët, bëtë banjë, veshët rroba, tesha të
23 pastra dhe shkuat në konferencën për shtyp. Kështu na keni
24 thënë javën e kaluar.

25 PË. Shiqo.

1 PY. Ne jua lexuam sërish dhe ju e konfirmuat këtë përmbajtje.

2 PË. Çka kam veshë e çka s'kam veshë e di që gjatë krejt
3 qëndrimit tonë në Drenicë kam qenë me këmishë të bardhë dhe
4 kravatë edhe në konferencë shtypi kam shku me këmishë të
5 bardhë e kravatë edhe sot jam me këmishë të bardhë me kravatë.
6 Edhe nuk ka kjo kurrfarë, domethënë, po okej është çështje e
7 drejtë e juaja.

8 Po edhe një herë e thashë, mbajeni mend, s'po di, s'po
9 kam ku me shkru këtu, gjithnjë jam në revoltën, në protestë që
10 jeni ka më diskriminoni. Po mi shkelni të drejtat e njeriut
11 edhe ka më bani presion posaçërisht ka më shqetësoni

12 [REDAKTUAR]

13 PY. Dëshmitar, pyetja ime ishte kjo, ajo që na thatë javën e
14 kaluar, të cilën dhe e konfirmuat kur ua rilexuam, a është
15 kështu që kur keni shkuar në shtëpi pasi u kthyet në
16 [REDAKTUAR] dhe para se të shkonit në konferencën për shtyp ju
17 u rruajtët, bëtë banjë dhe veshët rroba, tesha të pastra. A
18 është kjo e saktë?

19 PË. Për tesha s'di çka kam veshë. Me të thënë të drejtën me
20 po më pyet edhe dje çka kam pasë veshë, duhet me mëndu shumë
21 me ja qëllu. Po këto pyetje janë për mu interesante. Unë ju
22 thashë se jam rruajtë, kjo është me rëndësi dhe kjo ndodhë çdo
23 ditë edhe kam shku në konferencë shtypi.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] I kërkoj Sekretares së Gjykatës të
25 vendosë në ekran provën materiale 321 që është një video e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 62

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 pranuar tashmë si provë. Dhe do të doja të shihnim segmentin
2 17:18, segmentin kohor. Ju lutem, të shikojmë minutën 17:18
3 deri në minutën 17:33 dhe te minuta 33 ta ndaloni.

4 [Luhet videoincizimi]

5 [Zëri] "Kush është organizatori? Kush e udhëheqë grupin?
6 Kush janë këta këtu? Na thashë ishim nga Prishtina 30
7 pjesëmarrës në delegacion, këtu prefshi edhe gazetarët".

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, a mund t'i identifikoni katër personat në
10 video duke filluar nga e majta e ekranit tuaj në të djathtë.

11 PË. Sokol Blakaj.

12 PY. Një çast. Nga e majta, filloni nga e majta e ekranit në
13 të djathtë. Sokol Blakaj është personi me thinja?

14 PË. Jo, jo. Ai personi me thinja nga e majta është Simon
15 Agustini.

16 PY. Po përbri z. Agustini kush është?

17 PË. Jam unë, Gjergj Dedaj.

18 PY. Po përbri jush?

19 PË. Veli Bytyqi.

20 PY. Në të majtën tuaj?

21 PË. Dhe Sokol Blakaj.

22 PY. Në rregull. Këta persona, sikurse keni thënë dhe më
23 herët, kanë qenë pjesë e grupit të personave që janë mbajtur
24 të ndaluar me ju në Baicë, kështu?

25 PË. Kemi pasë bashkëbisedim me pjesëtarët e UÇK-së në Baicë

1 dhe në Qirez.

2 PY. Nga katër personat që janë këtu, ju keni thënë që këta
3 ishin pjesë, pra, ju keni thënë se gjashtë prej jush keni qenë
4 të përfshirë në një kacafytje. Tani nga këta gjashtë persona,
5 vetëm dy në fakt janë këtu në ekran, jeni ju --

6 PË. Po.

7 PY. -- dhe Veli Bytyqi --

8 PË. Jo.

9 PY. Më falni, Simon Agustini dhe Veli Bytyqi nuk kanë qenë të
10 përfshirë në këtë kacafytje, të tjerët kanë qenë të përfshirë.

11 PË. Nuk kanë qenë të përfshirë dhe në këtë përplasje
12 parlamentare kemi qenë unë dhe Sokol Blakaj nga kjo foto.

13 PY. E drejtë. Pra, ju dhe Sokol Bakaj keni qenë të përfshirë
14 në këtë kacafytje dhe më përpara keni thënë në dëshminë e
15 majit 2014.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E cila për referencë është 034236-
17 034287, faqja 034261 në anglisht dhe 034278 në shqip.

18 PY. Pra, kur ju kanë pyetur për lëndimet, ju keni thënë që
19 Sokol Blakaj ka pasë lëndime në fytyrë. A është kështu?

20 PË. Nuk më kujtohet.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] I kërkoj Sekretares të shkojmë në
22 segmentin 20:05.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurore,
24 për procesverbal duhet ta dini që kjo video më herët ka qenë e
25 klasifikuar si video konfidenciale, tashmë po e riklasifikojmë

1 si publike.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që nuk e vura në
3 dukje qysh në fillim.

4 [Luhet videoincizimi]

5 [Zëri] "I karakterit humanitar, ato forca --

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ndalojeni tek 20:09.

7 PY. Është një incizim shumë i shkurtër. A e patë këtë në
8 ekran, zotëri, këtë që sapo doli në ekran?

9 PË. Po.

10 PY. A shihni që z. Blakaj ka ngritur dorën e majtë, përballë
11 fytyrës së tij. E shihni në video?

12 PË. Pse? A e ka pasë të ndalume me ngrit dorën e majtë te
13 fytyra e tij?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 përgjigjuni pyetjes.

16 DËSHMITARI: Na të gjithë po shohim se e ka pasë. Edhe unë
17 disa herë e ngrita dorën këtu.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

19 Prokurore, transmetojeni dhe një herë videoklipin.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull. Ju lutem që të
21 fillojmë edhe njëherë në minutën 17:05 dhe ndalojmë në minutën
22 e 17:09.

23 [Luhet videoincizimi]

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

25 PY. Shohim që kokën e ka poshtë, po arrini ta dalloni fytyrën

1 e z. Blakaj në ekran?

2 PË. Po, shof Sokol Blakaj, të ndjerin tashmë.

3 PY. A e shihni mbi vetullën e majtë --

4 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj. Pyetja është
5 sugjestionuese. Në qoftë se ka pyetje për të bërë, le ta bëjë
6 pyetjen, po jo të kërkojë tani argumente ka apo s'ka lëndime
7 të dukshme në fytyrë.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po unë s'e kisha bërë akoma
9 pyetjen.

10 PY. Dëshmitar, a e shihni pjesën me ngjyrë pak më të errët
11 mbi vetullën e majtë të z. Sokol Blakaj?

12 PË. Unë s'kam vërejt kurrëgjë te Sokol Blakaj.

13 PY. Nuk po ju pyes për herë të tjera. Tani në ekran, aty në
14 ekran a e shihni?

15 PË. Nuk e kam të kjartë shka po shoh. Veç po e shoh që është
16 Sokol Blakaj.

17 PY. Po ju më herët në maj të 2014 keni thënë që ai ka pasë
18 lëndime në fytyrë. Dhe unë po ju pyes, a është ky vendi ku
19 është lënduar, pjesa ku është lënduar?

20 PË. Unë ndoshta këtu 1000 herë kam me jua përsërit se jam
21 distancu nga krejt ato sha kam thënë gjatë 2001, 2014 e këto,
22 sepse i kam thënë pa pasë informacione dhe në gjendje të rëndë
23 shëndetësore, emocionale, psikologjike për shkak të situatës
24 familjare. Që po më vjen keq që po ndodhë shpesh me i përmend
25 sepse ata duhet me i lënë me pushu në tokën e Kosovës së qetë,

1 jo mbas 25 viteve me ia trazu prapë eshtrat e djegur të tyne.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
3 përsëriteni pyetjen.

4 Dëshmitar, presim që ju t'i përgjigjeni pyetjeve.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo. A e shihni pjesën mbi
7 vetullën e majtë të Sokol Blakaj, mbi vetullën e majtë dhe a
8 është pjesa ku është lënduar?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Më vjen keq po kjo nuk ishte
10 pyetja e mëparshme?

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, Kolegu ka të
12 drejtë. Po u lexoj dhe një herë pyetjen.

13 PY. Në maj të 2014, ju keni thënë që ai, pra, Sokol Blakaj
14 është lënduar në fytyrë. Dhe unë po ju pyes, a është vendi ku
15 është lënduar ky, pjesa ku është lënduar?

16 PË. Unë nuk jam mjek, as kam qenë mjek aty me i kontrollu
17 kush ku është lëndu. Dhe nuk e di por mund të jetë, unë s'po
18 shoh pak një shenjë aty. Po, po të ishte gjallë Sokol Blakaj,
19 do të ishte më mirë që ai vetë ta tregonte ku, si dhe kur
20 është lëndu. Nuk mund të flas unë tash për lëndimet e të
21 tjerëve se unë nuk kam qenë as mjek as kontrollues i tyne.

22 PY. Dua të flasim tani për lëndimet tuaja. Në vitin 2014, ju
23 keni dhënë dëshmi se jeni lënduar kur ju kanë pyetur për
24 lëndimin fizik.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dhe kjo është e reflektuar në

1 dokumentin 034236-034287. Në anglisht është faqja 034260.

2 PY. Kur ju kanë pyetur për lëndimet tuaja fizike, ju jeni
3 përgjigjur se:

4 "Ishin shumë të rënda ... për disa ditë i gjithë krahu mu
5 nxi deri te gishtat dhe kur ndryshon koha, krahu i djathtë
6 prej shpatullës e deri tek maja e gishtit, te thonjtë më
7 dhemb, deri te gishtat më dhemb. Kjo është një lëndim i
8 përhershëm që më ka mbetur".

9 Në atë kohë, në fakt, ju treguat dhe një fotografi, ia
10 treguat një fotografi hetuesve ku dukej lëndimi juaj, a është
11 kështu?

12 PË. Nuk kam tregu kurrfarë fotografie. Nuk më kujtohet që kam
13 tregu fotografi. Dhe lëndimi im e kam spjegu që ishte nga
14 rrëzimi im dhe unë kam drejt me u rrëzu dhe kam drejt me u
15 ngrit.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tek prova
17 materiale 00321 të shkojmë te segmenti 19:29 edhe të ndaloj më
18 pas tek minuta 20:05.

19 [Luhet videoincizimi]

20 [Zëri] "Kur mendoj se ndalesa, sipas mendimit tim, ishte
21 e pakuptimtë nuk ka -- sepse nuk kish kurrfarë arsye që ne të
22 ndalohemi për derisa ne ishim të gjithë persona publikë.
23 Domethënë, ishim njerëz që për aktivitetin tonë, për punën
24 tonë, gjithmonë, domethënë, e din opinionin dhe është ditë dhe
25 kemi punuar në mënyrë legale. Prandaj ne s'kishim shku atje të

1 bëjmë kurrfarë propagande as politike, as partiake, as kundër
2 UÇK-së, as pro UÇK-së. Ne, thashë edhe në fillim, misioni i
3 ynë ishte i karakterit ...”

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim

5 PY. A e shihni dorën tuaj të djathtë në ekran, Dëshmitar?

6 PË. Krejtësisht normal. E shoh edhe mirë që i pasna të dy
7 duart që mund t'i shoh. Edhe po shoh veten kur kam qenë
8 atëherë më i ri.

9 PY. Pra, ju po thoni që krahu juaj i djathtë nuk është i
10 nxirë deri tek thonjtë? Është normal?

11 PË. Jo. Është normal. Edhe nëse është i nximë ju kam tregu se
12 këto pyetje janë, për shembull, unë me kanë Ajshtajn, a s'di
13 kush me thënë njerëz, ose robot me kasetë, me CD. Nuk muj unë
14 me i ditë. Të thashë se unë jam rrëzu. Jam rrëzu dy, tre herë
15 a katër, nuk është e rëndësishme sepse ka qenë terreni i
16 tillë. Ka ra shi. Ka qenë shize. Ka qenë terren me gropa. Ka
17 qenë natë. Kena ec nëpër mal. Domethënë edhe tash nëse jam
18 rrëzu, domethënë, ti, domethënë, edhe nëse jam rrëzu unë ose
19 nëse ka ra shi ju dëshironi me fajësu UÇK-në.

20 PY. Dëshmitar, unë po ju pyes a është normal apo është i
21 nxirë krahu deri tek thonjtë?

22 PË. Për mu është normal. Kurrëgjë s'po shoh unë të nxirë.

23 Ndoshta dhe nuk shoh mirë domethënë. Sepse edhe është më mirë
24 mos me pa shumë shka jemi ka përjetojnë.

25 PY. Ky rrëzimi juaj në malin Çiçavicë, ju thatë që ka qenë

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 69

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 errësirë apo jo, ka qenë natë, para konferencës --

2 PË. Unë ju thashë ju --

3 PY. -- për shtyp?

4 PË. U thashë se jam rrëzu që mbaj mend te shkolla Migjeni. Që
5 ka qenë natë. Ka qenë shi atë natë. Mundni me hi me shiku
6 kohën, nëse e keni atë mundësi, që ka ra shi. Edhe tuj shku në
7 tualet. Se tualeta ka qenë dikun disa metra larg shkollës, ka
8 qenë jashtë objektit. Dhe ka qenë terren i rrëshqitshëm,
9 terreni me gropa dhe ajo. Domethënë, edhe këtë e thashë
10 njëherë. Këtë kam me thanë 100 herë.

11 Dhe me këto çka po tregoni tash, domethënë, vetëm sa po
12 na shkatërroni jetën tonë, domethënë, kurrgjë s'jeni ka
13 fitoni, domethënë, asnjë send. Unë bile me ju thënë të drejtën
14 ma përpara kisha pasë dëshirë nëse me siguri keni na një
15 dhomë të burgut me shku në burg të përjetshëm, tash jua
16 nënshkruaj, me shumë dinjitet, me shumë gatishmëri edhe
17 pushkatim, po mos më qit në kësi pozitash të rënda shpirtnore
18 emocionale dhe familjare. Unë e kam pasë --

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar --

20 DËSHMITARI: Okej. [Flet anglisht]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndaloni. Ju lutem
22 ndaloni. Nuk po i përgjigjeni pyetjes.

23 Vazhdoni.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

25 PY. Dua që të jemi të qartë për procesverbal. Ju nuk po

1 flisni për rrëzimin në malin Çiçavicë, se shkolla ka qenë në

2 Baicë, jo në mal?

3 PË. Jam rrëzu --

4 PY. Pra, po na thoni për një rrëzim tjetër? Një çast të

5 mbarojmë pyetjen. Pra, tani po na thoni që ka pasë një rrëzim

6 tjetër, pra, jeni rrëzuar --

7 PË. Jam rrëzu --

8 PY. -- në shkollë në Baicë, kështu?

9 PË. Jam rrëzu disa herë. Edhe tash unë s'kam mujt me pasë një

10 video me incizu veten me kamerë ku po rrëzona, si po çojna, në

11 cilin krahë po bi, domethënë, kjo është absurd kjo është

12 domethënë. A nëse e keni valla qëllim, qëllime tjera, porosi

13 tjera kryeni e mos na maltratoni neve këtu. Se po ma

14 maltratoni familjen.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

16 nuk po i përgjigjeni pyetjes, po bëni një fjalim.

17 DËSHMITARI: Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

19 përgjigjuni pyetjes, ju lutem në mënyrë që të përfundojmë me

20 dëshminë tuaj.

21 DËSHMITARI: I nderum Kryetar i Gjykatës, unë s'po bëj

22 fjalim. Unë ju përgjigja se jam rrëzu disa herë.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ka edhe dy pyetje që do doja që të

24 kalonim në seancë private.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 71

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 seancë private.

2 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 72

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Këto ish-in dy pyetjet që kisha
25 nevojë t'i bëja në seancë private, mund të kalojmë në seancë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 73

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 publike.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] S'jam i sigurt për çfarë shkuam ne
3 në seancë private për këtë që ta kem dhe unë të qartë për
4 kundërpyetjet e mia, të kuptoj mirë arsyet. Pse u desh që ato
5 pyetje të bëheshin në seancë private? S'ka pasur trajtim
6 mjekësor. Kjo?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ishte
8 për trajtimin mjekësor.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, doni të thoni që unë mund ta
10 bëj pyetjen në seancë publike?

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ishte për dinjitetin e dëshmitarit
12 [REDAKTUAR]

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Po unë e kontestoj këtë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju mund ta
15 bëni pyetjen tuaj lidhur me këtë temë në seancë publike.

16 Vazhdoni.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Këto dy pyetje kisha planifikuar
18 për të bërë në seancë private. Dëshirojmë që të kalojmë në
19 seancë publike tani.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
21 Sekretare, na kaloni në seancë publike.

22 ~~{Seancë e hapur}~~

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
24 jemi në seancë publike.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

1 vazhdoni, Prokurore.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, kam një temë të fundit për të cilën dua t'ju
4 bëj pyetje. Ju thatë se keni shkuar në këto vizita humanitare
5 për shkak të kushteve të tmerrshme që ekzistojnë në Kosovë në
6 atë kohë, a është e vërtetë kjo?

7 PË. Jo veç kushtet e tmerrshme, por në Kosovë ushtrohej një
8 gjenocid të cilin bashkësia ndërkombëtare kurrë se ka pranuar.
9 Edhe kurrë s'e ka dënuar. Edh në vend të saj po na dënon ne që
10 kemi bërë realitet me gjak lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

11 PY. Ju keni pasur vizita të shumta të cilat ishin pranë
12 njera-tjetrës. Pra, paraprakisht ju u përpoqët që të kishit
13 katër vizita, por në fakt ia dolët që të organizonit tre
14 vizita, njëra prej këtyre vizitave ishte Qirezit dhe këto
15 vizita i keni kryer në më pak sesa një muaj, a është e drejtë
16 kjo?

17 PË. Të gjithë anëtarët e këtij delegacioni kanë qenë burra të
18 nderuar me shumë dinjitet të cilët kanë qenë të gatshëm me
19 vdekje për Kosovën. Dhe qëllimi i këtyre vizitave e kam spjeguar
20 edhe në Qirezit, në vizitën e fundit është me u bindur me pa
21 drejtpërdrejt situatën humanitare të popullatës civile e cila
22 ishte nën terrorin permanent të dhunimeve, të vrasjeve të
23 forcave serbe.

24 PY. Në rregull. Por pasi UÇK-ja ju ndaloi dhe e ndaloi
25 delegacionin për dy ditë, ju nuk keni kryer më vizita kaq

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 75

Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 shumë të rëndësishme humanitare, apo jo?

2 PË. Shiqoni. E kam thënë edhe po e përsërisë. UÇK-ja ka pasë
3 nevojë e ka pasë të drejtë dhe ka pasë arsy me bisedu me ne
4 sepse kemi qenë delegacion i zgjerum. Dhe kanë mujt me dyshu
5 në dikënd, me bazë ose pa bazë, se për me mujt me e sqaru këta
6 dhe kena ba një bashkëbisedim.

7 PY. E kuptoj. Por në qoftë se qëllimi i tyre ishte që t'ju
8 ndalonin ju që të vazhdoni të bënit vizita të tilla të
9 ngjashme, kjo funksionoi si gjë, apo jo?

10 PË. Absolutisht jo.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj këtë pyetje. Është
12 sugjestionuese si pyetje dhe nuk mendoj se nuk është në
13 mospajtim me deklaratat e mëhershme të dëshmitarit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
15 kundërshtimi.

16 Mund të vazhdoni, mund të përgjigjeni.

17 DËSHMITARI: Asnjë anëtar i UÇK-së, asnjëherë nuk na ka
18 thanë se tash e tutje nuk keni të drejtë me bë ma vizita. Kur
19 e ka pa se jemi krejt në rregull, na e u kemi vërejt se a
20 krejt në rregull, i kemi sqaru, askush nuk na ka thënë që prej
21 sotit ju s'keni të drejtë me bë vizita ose që na e kanë ndalu
22 vizitën.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

24 PY. E kuptoj. Nuk kam pyetje të tjera, të nderuar Gjykatës.
25 Nuk kam pyetje të tjera, po kam një kërkesë për pranim në

1 prova materiale dokumentet që kam përdorur për marrjen në
2 pyetje të këtyre dëshmitarëve.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materialet?

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumente që kam përdorur.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duke

6 përfshirë këtu dhe deklaratat?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Do kërkoj që të pranohet në

8 prova materiale, mbi bazën e rregullës 138, janë provat

9 materiale që i kam treguar dëshmitarit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të

11 fillojmë me deklaratat.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull. Po kjo parashikohet në

13 një tjetër rregull. Do kaloj tek rregulla 138(2)(c), kështu që

14 do kërkoja pranimin në prova materiale të deklaratave të

15 dëshmitarit të vitit 2014, që për procesverbal janë nga 034236

16 deri në 034287.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është

18 deklarata e EULEX-it kjo?

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Gjithashtu kërkoj që të

20 pranohet si provë materiale deklarata e shtypur e 2001 që ka

21 përgatitur ky dëshmitar, që është dokumenti nga 034135 deri në

22 034141 RED2. Ky është versioni në shqip. Ndërkohë që dokumenti

23 përkatës në anglisht është 034138-034141-ET.

24 Kërkoj pranimin e këtyre dy grupeve me dokumente në

25 përputhje me rregullën 143(2)(c).

1 Dhe kam një kërkesë tjetër për pranimin në provë
2 materiale në një tjetër rregull të Rregullores.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm këto dy
4 deklarata, apo jo?

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të dyja këto deklarata, deklaratën
6 e UNMIK-ut që ka përgatitur dëshmitari.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë?

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është deklarata e UNMIK-ut që ka
9 përgatitur vetë dëshmitari dhe deklarata e 2014.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
11 kundërshtim?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë pranimin në
13 prova materiale të këtyre. Po kemi kundërshtimin e vazhdueshëm
14 sa i takon mënyrës sesi janë përdorur këto materiale.

15 Dhe pozicioni i Mbrojtjes së z. Thaçi është që ajo çka ka
16 thënë dëshmitari nuk janë në mospajtim me atë çfarë ka thënë
17 më herët. Por sa i takon pranimit në prova materiale nuk
18 kundërshtojmë, nuk kemi kundërshtim për atë çfarë kërkoi
19 Prokurorja.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Strong.

21 Z. STRONG. [Përkthim] Nuk e di në qoftë se ka dokumente
22 të tjera që do të propozohen që të pranohen si prova në
23 kuadrin e deklaratave sipas rregullës 143.

24 Ndoshta do ishte më mirë që ta bënim shkrim parashtrimin
25 tonë që të hartonim një listë dhe t'i përgjigjeshim me shkrim

1 në qoftë se pajtohem apo jo, sepse e kërkon një diskutim më
2 thelbësor kjo çështje sesa po themi jemi dakord apo jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di në
4 qoftë se z. Misetic pajtohet në kundërpyetjet e tij që disa
5 nga dokumentet nuk janë paraqitur akoma.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po ashtu duam që të paraqesim edhe
7 dokumentet e tjera.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë atëherë.
9 E vlerësojmë ofertën tuaj, megjithatë dua që të them që
10 deklaratat e EULEX-it që janë dhënë, janë parashtruar për t'u
11 pranuar mbi bazën e rregullës 143(2)(c), plus dokumentet e
12 tjera shtesë të përmendura nga Prokurorja, do t'i caktohen
13 numrat e provave materiale.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 deklarata e parë që mban numër identifikimi ERN 034236 deri në
16 034287 RED do të marrë numrin e provës materiale P680.

17 Të nderuar Gjykatës, dua që të sqaroj që kjo shënohet si
18 konfidenciale. Duhet të mbajmë të njëjtin klasifikim apo do të
19 ndryshojmë klasifikimin?

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim për
21 riklasifikim, por do të dua që të shikojmë detajet personale
22 mbështetur në atë çfarë kemi diskutuar në Gjykatë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni
24 rishikimin brenda pesë ditëve?

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata tjetër me
2 numër ERN 034135 deri në 034141 RED2 në anglisht dhe versioni
3 tjetër i cili mban numrin e identifikimit 034138 deri në
4 034141-ET që është versioni në anglisht, do të marri numrin e
5 provës materiale P681.

6 Të nderuar Gjykatës, kam të njëjtën pyetje që ka të bëjë
7 me klasifikimin. Duhet të mbahet i njëjti klasifikim apo duhet
8 të ndryshohet ai?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëhet
10 riklasifikimi i tyre apo jo?

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo. Mendoj që
12 janë të nevojshme sipas rregullës 134.

13 Po ashtu ka prova materiale që i tregova dëshmitarit që
14 janë identifikuar dhe që janë dorëzuar UNMIK-ut nga dëshmitari
15 dhe që mbajnë shkrimin e dorës së dëshmitarit. Kështu që dua
16 që të kërkoj në këtë kuadër pranimin e provave materiale XYZ-
17 1, që është dokumenti me ERN SITF00055783 deri në 00055996 që
18 është dokumenti i plotë dhe pastaj dokumenti XYZ-1, prova
19 materiale për të cilën po flas është në anglisht SITF00055872
20 dhe në shqip është SITF00055873. Që është prova materiale XYZ-
21 1.

22 Ndërkohë që prova tjetër materiale mban një numër tjetër
23 ERN, të një dokumenti më të gjerë sesa kaq. Që është numri
24 034155 deri në 034155-ET në anglisht dhe me të njëjtin numër
25 ERN pa ET në fund në versionin në shqip, më konkretisht 034155

1 deri në 034155 në shqip.

2 Nuk do ta përmend XYZ-3 sepse kjo është si pjesë e provës
3 materiale që është P00319.

4 Ndërkohë dokumenti tjetër që kërkoj të pranohet si provë
5 materiale është ai që identifikohet aktualisht si SITF00055783
6 deri në 00055996. Versioni në anglisht është SITF00055883 dhe
7 në shqip është faqja pasuese që është SITF00055884.

8 Dokument tjetër është XYZ-5. Ka numrin e identifikimin
9 034162 deri në 034162-ET për anglishten dhe i njëjti numër
10 identifikimi pa ET në fund për versionin në shqip, konkretisht
11 dokumenti 034162 deri në 034162-AT.

12 Dokumenti tjetër që kërkoj që të pranohet si provë
13 materiale është dokument që aktualisht identifikohet me
14 SITF000055876 versioni në anglisht është në faqen 00055895
15 deri në 00055896. Faqet përkatëse në shqip janë SITF00055897.

16 Këto janë materialet. Numri 7 është në provë materiale i
17 regjistruar tashmë. Ndërkohë që numrat 8 dhe 9 nuk u
18 konfirmuan nga dëshmitari, kështu që nuk kërkoj pranimin e
19 tyre si prova materiale.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

21 Z. STRONG: [Përkthim] Po, ne kemi kundërshtim, i nderuar
22 Gjykatës. Bëhet fjalë për dokumentin XYZ-5, ERN 0034162.

23 Se ndryshe nga dokumentet e tjera bëhet fjalë për një
24 artikull në këtë rast që është shkruar jashtë periudhës së
25 aktakuzës. Nuk ka lidhje fare me ngjarjet e ndodhura ose që

1 pretendohet të ndodhura në shtator të 1999. Është një artikull
2 gazete pa autor që duket sikur është nxjerrë nga një tjetër
3 artikull gazete, nga gazeta Tema. Dhe dokumenti që shërben si
4 bazë për artikullin nuk i është ofruar Mbrojtjes, është
5 spekulues në natyrë dhe nuk i është dhënë Mbrojtjes.

6 Jo vetëm kaq po ka edhe gabime të shumta të shprehura,
7 përfshirë këtu, për shembull, përmendjen e Bislim Zyrapi si
8 shefin e shërbimit sekret. Ndërkohë që artikulli që është
9 komentuar paraqet përshkrimin e saktë të z. Zyrapi.

10 Neve parashtrojmë që vlera provuese e këtij dokumenti ose
11 artikulli është shumë e vogël. Dhe jo vetëm kaq por ky është
12 një dokument spekulues në natyrë dhe është cenues për
13 Mbrojtjen. Në këtë dokument spekulohet që dokumenti është një
14 skemë dhe një listë për ekzekutim. Dhe sikurse e thashë, ky
15 është një dokument i cili është shumë cenues dhe shumë
16 paragjykues.

17 Në përkthimin në anglisht, shtohet një kolonë shtesë, një
18 kolonë e tretë, ku bëhen përfundime ose konkluzione sa i takon
19 listës së shkurtimeve dhe inicialeve, por ndërkohë që nuk
20 jepet asnjë lloj shpjegimi sesi është mbërritur në këto
21 përfundime, sesi kanë arritur në këto shkurtime.

22 Kështu që për këto arsye, ne parashtrojmë që vlera
23 provuese e këtij dokumenti është shumë e vogël. Dhe spekulimi
24 cenues i këtij artikulli është shumë i lartë. Po ashtu
25 dëshirojmë që të themi që dokumenti bazë që shërben për

1 artikullin që i është dhënë Mbrojtjes nuk është i nënshkruar.

2 Dhe kështu që për këtë arsye, ne parashtrojmë që
3 dokumenti duhet që të mos pranohet si provë materiale.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne kemi të njëjtin kundërshtim.

6 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe neve kemi të njëjtin
7 kundërshtim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 Atëherë dokumentet 1, 3, 5 deri në 6 pranohen si prova
10 materiale. Dokumenti 1, 3, 4, 6 si dhe 5 do të shikohen më tej
11 nga Trupi Gjykses dhe do të marrim një vendim lidhur me këtë
12 nesër.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] A mund të përgjigjem shkurtimisht?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kuptojmë kundërshtimin. Por
16 dokumentet tregojnë më tepër sesa kaq. Sepse këto janë
17 dokumente të cilat dëshmitari ua ka dhënë EULEX-it për të
18 mbështetur rastin e tij, domethënë, këto janë materiale që ai
19 ka menduar që janë të rëndësishme për rastin e tij. Vlera
20 provuese në to është e lartë.

21 Sepse, pra, këto janë dokumente të cilat kanë të bëjnë me
22 këtë person konkretisht po gjithashtu edhe me persona të tjerë
23 të cilët kanë qenë pjesë e këtij delegacioni. Ne parashtrojmë
24 që vlera provuese është vërtetuar dhe kjo shkon përtej këtij
25 artikulli. Kështu që kjo në vetvete ka të bëjë me klimën që ka

1 ekzistuar pas asaj çfarë ndodhi dhe pas dhënies së
2 deklaratave.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
4 shikojmë dhe do vendosim më vonë.

5 Ndonjë gjë tjetër që keni për të shtuar? Znj. Sekretare,
6 kishit diçka për të thënë?

7 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
8 këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, caktojini
10 numrat e provave materiale për dokumentet.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

12 Dokument i parë, me numër identifikimi SITF00055877 për
13 versionin në anglisht dhe artikulli përkatës në shqip me numër
14 identifikimi SITF00055873, që do të merret nga dokumenti më i
15 gjatë që identifikohet si ERN SITF00055783 deri në 00055996,
16 do të marrë numrin e provës materiale P682.

17 Dokumenti i dytë me numër identifikimi 034155 deri në
18 034155 dhe në përkthimin në anglisht në faqen 034155 dhe
19 034155-ET në anglisht do të marrë numrin e provës materiale
20 P683.

21 SITF000055883 për versionin në anglisht dhe SITF00055884
22 për shqipen, që marrë si pjesë e një dokumenti më të gjatë që
23 u citua më herët, do të marrë numrin e provës materiale P684.

24 Dokumenti 034162 deri në 034162-AT dhe versioni në
25 anglisht 034162 deri në 034162-ET do shënohet si provë

1 materiale 686 për identifikim të mëtejshëm.

2 Dokumenti i fundit, SITF00055895 deri në SITF00055896 për
3 anglishten dhe SITF00055897 për shqipen, do të marrë numrin e
4 provës materiale P686.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto prova
6 materiale regjistrohen për procesverbal dhe kanë numrat e
7 provave materiale që u përmendën nga Sekretarja.

8 Faleminderit, Sekretare.

9 Z. Misetic, mund të vazhdoni.

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Luca Misetic. Jam Avokat i
13 z. Thaçi. Kam disa pyetje për juve, mbase gjatë gjithë ditës
14 sot dhe mbase edhe gjatë paradites së ditës së nesërme.

15 Përpara sesa të fillojmë me pyetjet, dëshiroj t'ju
16 udhëzoj ose t'ju informoj se unë do t'ju bëj pyetje konkrete
17 të cilat kanë nevojë për informacion faktik prej jush, kështu
18 që do ju kërkoja që ju thjesht t'i përgjigjeni pyetjeve që do
19 ju bëj unë, në mënyrë të tillë që të mund të ecim goxha më
20 shpejt, në qoftë se ju thjesht i përgjigjeni pyetjeve që do
21 bëj unë.

22 Dua t'ju tregoj gjithashtu se në qoftë se unë mendoj që
23 ju po jepni përgjigje përtej pyetjes që ju kam bërë, do të
24 ngre dorën. Nuk dua që të jem i pasjellshëm me ju. Po thjesht
25 dua që t'ju bëj me dije që përgjigja shkon përtej pyetjes time

1 dhe t'ju informoj lidhur me këtë.

2 A e kuptuat këtë udhëzim, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Shumë faleminderit. Së pari dëshiroj që të flas lidhur me
5 diçka ju thatë dje si historik.

6 Dje përpara Trupit Gjykues ju thatë që edhe brenda
7 strukturave zyrtare, pra, brenda strukturave të Presidentit
8 Rugova, juve thatë që edhe brenda këtyre strukturave kishte
9 persona që nuk i respektonin këto struktura. A ju kujtohet ta
10 keni thënë këtë gjë dje, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Si prehistorik prap, pas Marrëveshjes së Dejtonit, filloi
13 që të kishte përçarje brenda LDK-së, a është e saktë kjo?

14 PË. Ka pasë shkarje, ka pasë mospajtime, individuale.

15 PY. Në fund të 1997, a është e drejtë të thuhet që këto
16 përçarje shkuan deri në strukturat vendore të LDK-së, pra, tek
17 njerëzit të cilët drejtonin LDK-në në nivel vendor në vitin
18 1997, është e drejtë ta themi këtë gjë?

19 PË. Po, ka pasë individë, thashë që kanë mëndu ndryshe, kanë
20 vepru ndryshe.

21 PY. A e dini, për shembull, në qoftë se Mehmet Hajrizi është
22 larguar nga LDK-ja gjatë asaj periudhe?

23 PË. Po nuk e di datën, por e di se disa struktura, disa
24 individë janë largu nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

25 PY. Po Gani Krasniqi?

1 PË. Edhe ai më duket që është largu nga strukturat e LDK-së.

2 PY. Po Gani Koci?

3 PË. Edhe ai. E kam thënë dhe jem i bindun se është largu nga
4 strukturat e LDK-së dhe ka kalu, domethënë, është ka kalu në
5 UÇK.

6 PY. Po Veton Surroi edhe ai u largua po ashtu?

7 PË. Veton Suroi, nuk e di ka qenë kështu anëtar i LDK-së se
8 ai e ka pasë një lëvizje UJDI dhe ka qenë ma shumë shoqëri
9 civile.

10 PY. A është e drejtë të thuhet se këto përçarje ose
11 mospajtime ekzistonin edhe përpara sesa të dilte UÇK-ja, që të
12 dilte publikisht UÇK-ja në fund të 1997? E kam fjalën për
13 përçarjet ose mospajtimet brenda strukturave të LDK-së.

14 PË. Po ka pasë përçarje sepse një pjesë e individëve mendonin
15 se nuk mund të zgjidhet çështja e Kosovës vetëm me konferenca
16 shtypi, domethënë, vetëm me paraqitje politike publike, por
17 duhet me pasë edhe një organizim aktiv. Dhe me daljen në skenë
18 të UÇK-së në nëntor të vitit 1997, atëherë situata, domethënë,
19 ka ndryshu shumë në terren.

20 PY. A është e drejtë të thuhet se disa prej këtyre personave
21 brenda LDK-së që kërkonin, në qoftë se mund të shprehemi
22 kështu, një qasje më agresive dhe që kishin pasur këto
23 konflikte brenda për brenda LDK-së, a i morën me vete dhe i
24 çuan konfliktet e LDK-së në UÇK kur u kyçën në UÇK?

25 PË. Nuk di sha kanë çu në UÇK, por e di se, domethënë, ishte

1 nevojë imediate që t'i përgjigjemi invazionit serb në Kosovë,
2 i cili tashmë që nga viti 1989 që kishte suspendu autonominë e
3 atëhershme të Kosovës, bënte spastrimin etnik të Kosovës,
4 bante terrorizimin e popullatës së Kosovës, bante përjashtime
5 gjithë shqiptarëve nga puna dhe këto reaksione të qytetarëve
6 ishin ma shumë reaksione në vetëmbrojtje të ekzistencës tonë,
7 parandalimit të terrorit dhe të parandalimit të spastrimit
8 etnik. Kjo është, domethënë, ajo në vija të trasha.

9 PY. Në rregull. Le të shkojmë aty ku filluam dje, pra, le të
10 flasim për vizitat e organizuara humanitare që filluan në
11 gusht të 1998. Gjithsej u planifikuan katër vizita, kështu?
12 PË. Gjithsej i kemi bërë katër vizita.

13 PY. Përpara sesa të shkonit në vizitë në Qirez, a ishit hasur
14 ndonjëherë, a kishit takuar ndonjëherë UÇK-në në tri vizitat e
15 mëhershme, pra, para se të shkonit në Qirez?

16 PË. Unë jo, nuk kam taku. Ma së pari kam takue në vizitën që
17 e kam pasë atje te Pagarusha në zonën e Malishevës, domethënë,
18 që e kam thënë edhe dje, edhe isha shumë i lumtur kur i kam
19 taku. Edhe pse partia të cilën unë e kam drejtu, kongresin e
20 saj në 1997, që e kena mbajt në dhjetor, pas daljes në skenë
21 të UÇK-së në nëntor, ne në kongres si platformë e kena pasë
22 çdo popull duhet me pasë ushtrinë edhe forcat e veta të rendit
23 e të sigurisë për me mbrojtje popullatën e atij vendi. Këtu ka
24 pasë dhe plasaritje -- më fal.

25 Edhe ftofje të marrëdhënieve mes forcave që përfaqësonin

1 politikën paqësore dhe me Partinë Liberale të Kosovës. Arsyeja
2 ishte se unë kam pasë shumë takime ndërkombëtare dhe kam qenë
3 njëni prej nënkryetarëve, domethënë, ma vonë të
4 internacionales liberale kam qenë shumë aktiv në të gjitha
5 qendrat e vendosjes. Dhe shpesh herë kur kam kërku
6 intervenimin e NATO-s, ata më kanë thënë se NATO nuk mundet të
7 intervenon nëse ju e ftoni në konferenca shtypi.

8 PY. Dua t'ju pyes lidhur me vizitën në Pagarushë. Në 2014
9 keni deklaruar -- do jua lexoj. Ju thoni që:

10 "Jemi hasur me UÇK-në ose kemi takuar UÇK-në për herë të
11 parë në Pagarushë ose në Senek. Ata ishin shumë mirënjohës dhe
12 na bënë të mundur ne që të kontaktonim popullsinë".

13 A është e saktë kjo?

14 PË. Po.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj citim, referencë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, është në deklaratën e 2014
17 deklarata e EULEX-it faqja 4.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do ju kërkoja që të jepni numrin e
19 ERN sepse ka dy pjesë ky dokument dhe ka dy faqe 4 në PDF.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Është dokumenti 034236
21 deri në 034287, faqja 4. Numri ERN është 034239.

22 PY. Pra, është e saktë që gjatë vizitës në Pagarushë, UÇK-ja
23 tha që ishte mirënjohëse që kishte arritur delegacioni dhe që
24 ata ishin më se të lumtur që të mundësonin takimin me
25 popullatën? A është e saktë kjo?

1 PË. Po edhe kanë bashkëpunu me ne. Dhe na kanë ndihmue,
2 domethënë, me i takue popullatën për me u bind për situatën
3 alarmante të popullatës civile në këto zona.

4 PY. A ju kujtohet ndonjë kontakt tjetër me UÇK-në, në ndonjë
5 vizitë tjetër përveç vizitës në Pagarushë?

6 PË. Nuk më kujtohet që kam pasë naj kontakt tjetër.

7 PY. Në rregull. Tani le të flasim për vizitën në Qirez. Ju
8 informuat policinë serbe për vizitën që po planifikonit në
9 Qirez, a është e saktë kjo?

10 PË. Unë kam qenë si kryetar i delegacionit përgjegjës me
11 informu vetëm organizatat ndërkombëtare. Domethënë, i kam --
12 bile i kam informu institucionit në Bruksel edhe Aleancën
13 Liberal-Demokratike të Evropës në Bruksel ku unë kam qenë
14 anëtar edhe anëtar i komitetit ekzekutiv të kësaj Aleance. Ma
15 vonë mbas lufte edhe nënkryetar i Internacionales Liberale me
16 seli në Londër.

17 Dhe unë i kam informu edhe mekanizmat ndërkombëtarë në
18 Prishtinë, misionin vëzhgues amerikan, UNCHR-in. Edhe s'kam
19 pasë unë, domethënë, interesim me informue tjerët. Ndoshta
20 dikush nga anëtarët, është me rëndësi me u cekë, dikush nga
21 anëtarët e delegacionit ka mujt me informu edhe tjera
22 segmente, po unë po flasë kategorikisht të vërtetën unë çka
23 kam bë.

24 PY. A e dini se çfarë është shërbimi policor 92, çfarë është
25 ky? Çfarë ishte?

1 PË. E di që shërbimi i cili na ka nxi jetën, na i ka vra
2 familjet.

3 PY. Dua t'ju tregoj dokumentin me provën materiale P681.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Është faqja e parë e këtij
5 dokumenti dhe në anglisht dhe në shqip.

6 PY. Është një letër që keni shtypur në 2001 për UNMIK-un.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë diku nga mesi i faqes, në
8 paragrafin që fillon "Në gusht/shtator 1998...". Është i
9 njëjti dokument, nuk ka gjuhën shqipe. Apo ka? E ka.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Besoj se dokumenti që është
11 pranuar në anglisht në fakt është një provë tjetër, pra, numri
12 është dhënë gabim. Për anglishten mund ta kërkonim me 0138,
13 034138 deri në 034141. Ky është materiali që është pranuar si
14 provë në anglisht.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofon i
16 çaktivizuar]

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë tek paragrafi i tretë nga
18 fundi, thotë:

19 "Njoftuam paraprakisht zyrën amerikane (USIS) në
20 Prishtinë, zyrën e UNCHR-së, misionin vëzhgues, zyrën e BE-së,
21 shërbimin e policisë 92 qoftë për marshutën po dhe për
22 qëllimin e vizitës së popullatës civile në zonat e
23 konfliktit".

24 A e shihni këtë?

25 PË. Unë s'e kam njoftu. As nuk do ta njoftoja, as ndërmend

1 s'më ka ra me njoftu. Dhe nuk mundet kush me gjetë një fakt në
2 botë që unë e kam bë njoftim të tillë. Thashë nuk e përjashtoj
3 mundësinë që dikush tjetër e ka --

4 PY. Në rregull. Dëshmitar, nuk ka rëndësi për mua a e keni
5 njoftuar ju apo dikush tjetër, ama ju ishit kryetar i
6 delegacionit dhe ju e dini që dikush e ka bërë këtë njoftim se
7 e keni thënë në letrën që i keni dhënë UNMIK-ut. Atëherë kush
8 e njoftoi shërbimin e policisë 92?

9 PË. Nuk mujt me spekulu me emna se është e padrejtë. Sepse
10 nga këta anëtarë të delegacionit ka edhe të vdekur edhe të
11 vdekura dhe nuk kam dëshirë me i përmend. Por ka mundësi që
12 dikush i ka njoftu sepse kanë mëndu, domethënë, që --

13 PY. Po ju pyes kështu. Ku e keni bazën ju që i keni thënë,
14 pra, ku e keni bazuar ju informacionin që keni dhënë UNMIK-ut
15 kur i keni thënë që shërbimi i policisë 92 është njoftuar për
16 këtë vizitë --

17 PË. Ndoshta është --

18 PY. -- nga e dini ju që ishin njoftuar?

19 PË. Është fol ndoshta se për me mos na ndalë policia serbe,
20 ndoshta është njoftu sepse qëllimi jonë ka qenë gjithsesi me
21 mbërrit te popullata civile, te shqiptarët. Edhe serbët kanë
22 mujt me na ndalë sikur na kanë ndalë në Pejë, na kthy, na kanë
23 kërcnu, domethënë, kanë mujt me ndalë. Dhe për këtë arsy
24 domethënë, ne nuk e kemi bë, domethënë, kushdo që e ka bë.

25 Po unë flas në këtë rast për vete. Unë jam i tillë jam.

1 Me e pasë njoftu kisha thënë po, kisha arsyetu pse. Unë as e
2 kam njoftu edhe unë kam qenë gjithmonë person për raporte e
3 bashkëpunim ndërkombëtar. Unë Serbinë s'e kam njoft kurrë.
4 PY. Në rregull.

5 PË. As tash nuk e njoh.

6 PY. Thelbi është ky, është njoftuar policia serbe që të
7 kishit leje që të udhëtonit në këto zona, apo jo?

8 PË. Na, thashë edhe një herë. Ka mundësi. Por nuk kam fakt me
9 thënë kush ka delegacioni, ka mundësi se dikush e ka informu
10 qoftë me telefon, për mos me na pengu me shku. Por nuk muj me
11 thënë unë që e ka njoftu ky ose ajo sepse thashë nga ky
12 delegacion ka dhe të vdekun. Ama s'përjashtohet mundësia.

13 PY. Në deklaratën që i keni dhënë EULEX-it thoni.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Është 034236-034287, faqja 4.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është prova materiale P860
16 [Sipas përkthimit].

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Po përpiqem në fakt të kuptoj se
18 për cilën nga këto pjesë i përket kjo provë. Sidoqoftë, këtu
19 thuhet që:

20 "Ishin 10 deri në, domethënë, 10 deri në 15 delegatë
21 zakonisht, po gjithmonë unë isha kryetar i delegacionit. Sepse
22 unë isha kreu dhe unë flisja me forcat serbe sa herë që
23 ndaloheshim prej tyre. Unë mund të flisja për llogari të
24 delegacionit. Kisha një kravatë edhe kisha edhe dokumente që
25 tregonin apo vërtetonin misionin tonë humanitar".

1 Tani këto dokumentet apo letra që thoni ju, është një
2 faks në fakt që ju kishit dërguar dhe ju kishit një kopje të
3 faksimiles të faksit ku tregohej se ju kishit leje të kalonit
4 përmes punkteve serbe, a është kështu?

5 PË. Na, unë s'kam bisedu me forcat serbe. Ato kanë bisedu me
6 mu. Ato kanë ndalë. Na kanë kontrollu. Na e kanë hap kepekin,
7 na kanë kërcnu, na kanë fy që është normale ajo shka kena
8 pritë tjetër gjë prej tyne.

9 Edhe unë kam pasë një grumbull letrash në dorë që i kam
10 dërgu me faks institucioneve ndërkombëtare për marshutën tonë.
11 Edhe ia kam dëshmu atyne se mos për me i bindë ata, domethënë,
12 me mujt me na leju me vazhdu tutje.

13 Edhe gjithmonë me mu, është mirë ta dini, sa herë më kanë
14 nxjerrë nga vetura si udhëheqës i delegacionit, ka dalë edhe
15 znj. Nekibe Kelmendi që tash është e ndjerë. Një zonjë e
16 nderume të cilës forcat serbe ia kanë vra burrin edhe dy
17 djemtë. Ajo ka qenë me profesion avokate. Ajo i ka ditë këto
18 punët juridike pak më mirë se unë gjithsesi, se unë nuk jam me
19 profesion avokat fatkeqësisht, as jurist. Edhe ajo edhe ka
20 komunikuar edhe me serbët, domethënë, me ia spjegu qëllimin e
21 vizitës.

22 PY. Dje në dëshminë tuaj thatë që ju e dinit që Adem Demaçi
23 kishe postin e përfaqësuesit politik të UÇK-së në Prishtinë
24 aso kohe, kështu?

25 PË. Po ne e dinim edhe që ekzistonte një zyrë e UÇK-së në

1 Prishtinë edhe s'di çka me thanë më tepër për ta. Po s'kam

2 dëshirë me fol ma shumë për atë zyrë.

3 PY. Besoj se ju keni thënë që delegacioni juaj nuk njoftoi as

4 atë zyrë dhe as ndonjë zyrë tjetër të UÇK-së lidhur me synimin

5 tuaj për të shkuar në Qirez, kështu?

6 PË. Është e vërtetë që s'e kemi njoftu atë zyrë. Dhe është e

7 vërtetë që nuk i kemi njoftu askënd nga UÇK-ja sepse ne ishim,

8 nëse mund të quheshim, deputetë dhe deputetë e një vendi dhe

9 pse në atë zonën ku kemi shku që ishte zona më e atakume, më e

10 terrozume, siç është zona e Drenicës, domethënë, nuk ka pasë

11 mundësi me u mbajt zgjedhjet në 1998. Domethënë edhe nuk kemi

12 marrë leje, domethënë, s'kemi kërku leje se nuk e kam pa të

13 arsyeshme që duhet me kërku leje me shku me i vizitue zonat,

14 popullatën civile në territorin e Kosovës e cila është vendi i

15 joni. Është e vërtetë, domethënë, ajo dhe ndoshta është edhe

16 gabim, lëshim i joni. Por zyrën e UÇK-së në Prishtinë nuk

17 besoj që e kisha njoftu.

18 PY. Po. Por në takimin që keni pasur me Prokurorinë javën e

19 kaluar - që është në paragrafin 20 të shënimit përgatitor - ju

20 i keni thënë:

21 "Tani kur e rishikoni dhe një herë situatën pas 20

22 vjetësh, ishte krejt normale që UÇK-ja ju ndaloi dhe çdo

23 ushtri tjetër do të kishte bërë të njëjtën gjë sepse në fakt

24 delegacioni nuk e kishte njoftuar UÇK-në përpara se të bënte

25 vizitën".

1 A ja keni thënë këtë Prokurorisë javën e kaluar?

2 PË. Po, po. Po edhe tash po e ripërsëris. Është absolutisht e
3 vërtetë se sepse çdo ushtri në botë kish pasë me bë të njëjtën
4 gjë me ditë kush janë këta njerëz me vetura që aty kishte një
5 vit a dy vite s'kish shkelë veturë civile, përveç tankseve
6 edhe rrugët ishin me fishekë, gëzhoja, me plumba. Na kena ec
7 napër gëzhoja të plumbave. Domethënë, edhe llogjika na tregon
8 se kanë pasë arsy me na ndalë me ditë kush jemi na.

9 Se aty disa na thojshin ose të jemi të marrë krejt ose
10 jemi shumë trima. Na nuk ishim as trima, as të marrë. Po ishim
11 domethënë, kishim dëshirë me shku me pa popullatën civile. Dhe
12 UÇK-ja me plotësisht - se kur e kam mendu ma vonë me
13 plotësisht të drejtë edhe unë pa kanë pjesëtar i UÇK-së një
14 delegacion që kish ardhë me vetura, si në dasëm, e me kravate,
15 pa i ndal nuk kisha rend me e ditë kush jeni ju, çdo ushtri në
16 botë.

17 PY. Dhe në të vërtetë kur ju ndaluan, qartë u thanë që një
18 nga shqetësimet e tyre ishte se ju nuk kishit njoftuar
19 paraprakisht vizitën tuaj në atë zonë, kështu?

20 PË. Mendoj se ka qenë dashtë me i njoftu. Ka qenë korrekt nga
21 -- do të kishte qenë korrekt nga ne.

22 PY. Ju kërkoj ndjesë. Po ju bëj pyetje faktike. Fakt, a ju
23 thanë ata ju rreth periudhës së 20 shtatorit që një nga
24 shqetësimet e tyre ishte fakti që ju nuk kishit bërë njoftim
25 se do shkonit për vizitë në zonë?

1 PË. Po, ka mundësi, ka mundësi që të na kenë thënë. Dhe kanë
2 pasë të drejtë me na thanë.

3 PY. Në qoftë se ju kujtohet ju treguan një segment të
4 konferencës për shtyp që keni pasë më 23 shtator. Nuk po e
5 vendos videon për momentin, por ama në këtë konferencë për
6 shtyp --

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Që mban numrin e provës materiale
8 P0021-ET, faqja 8 e transkriptit.

9 PY. Ju keni thënë në konferencën për shtyp deri në orën 2.00
10 të pasdites dje, pra, pas 48 orësh na thanë që tani jeni të
11 lirë, ju kemi mbajtur të ndaluar për 48 orë. Shqetësimi i tyre
12 kryesisht ishte pse nuk kishim njoftuar në lidhje me vizitën
13 tonë".

14 PË. Kanë dashtë me ditë kush jemi ne. E përsëris disa herë.
15 Edhe kanë pasë me dashtë -- se kanë muj me dyshu me plot të
16 drejtë se dikush nga anëtarët e delegacionit ka mujt me pasë,
17 se ku di unë, se nuk muj me spekulu tash. Edhe ka dashtë me
18 ditë kush jemi ne dhe s'kanë bë asnjë gabim aty.

19 PY. Partia juaj politike ndryshe njihet si PLK-ja, apo jo?

20 PË. Partia Liberale e Kosovës. Partia e parë dhe e vetme nga
21 Kosova e anëtarësime në nivel evropian dhe botnor dhe në
22 nivelin më të lartë ë Ballkan.

23 PY. Në rregull. Thjesht doja të dija a ishte PLK-ja.

24 Javën e kaluar kur jeni takuar me Prokurorinë, i keni
25 treguar një pamflet që kishte botuar PLK-ja në 2005, kështu?

1 PË. Saktë. Në 2005 me rastin e 14 vjetorit të aktivitetit dhe
2 të themelimit të partisë Liberale të Kosovës.

3 PY. Do të doja që dokumentin që i keni treguar Prokurorisë ta
4 vendosim në ekran.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Është me numër DHT02734 deri në
6 DHT02735-ET, faqja 1. Ndërsa në shqip është 116704 deri në
7 116758, faqja 116822. Në anglisht është drejt fundit të faqes,
8 tek paragrafi që thotë: "Fatkeqësisht, gjatë këtij rasti..."

9 PY. Paragrafi 74 i shënimit përgatitor thotë që i keni
10 Prokurorisë që ky pamflet ka një përshkrim të incidentit të
11 Qirezit që pasqyron ato që keni menduar ju gjatë asaj kohe,
12 kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Në rregull. Këtu lexojmë, s'e di saktë se ku ndodhet tek
15 shqipja në fakt, por tek anglishtja thotë:

16 "Për fat të keq këtu, me rastin e kësaj vizite u përzi
17 politika dhe interesat klanor duke dëmtuar, keqkuptuar dhe
18 dezinformuar për misionin tonë thjesht humanitar dhe të
19 shenjtë.

20 "Me këtë rast u krijuan pa nevojë disa mosmarrëveshje
21 midis ca nga pjesëtarët e UÇK-së të cilat ishin më shumë
22 prodhim i intrigave me prapavijë politike dhe si pasojë e
23 moskoordinimit të mjaftueshëm të faktorit politik me UÇK-në,
24 gjë të cilën do ta paguajë delegacioni ynë për të qëndruar dy
25 net të tëra në shkollën fillore të fshatit Baicë në rrethana

1 të rënda për të gjitha palët dhe opinionin e gjerë”.

2 I keni thënë Prokurorisë se këtë pamflet e ka përgatitur
3 një grup ku përfshiheshe ti dhe Sokol Blakaj, kështu?

4 PË. Kemi qenë, redaksi kena pasë ne, se kena nxjerrë disa
5 numra të Liberalit, kena nxjerrë afër 20 numra të revistës
6 Liberali kohë pas kohe. Kena pasë redaksinë.

7 PY. Po, redaksinë. Po, në fakt, unë dua të kuptoj këtë a keni
8 qenë edhe ju personalisht dhe Sokal Blakaj në përgatitjen e
9 këtij pamfleti?

10 PË. Po, kemi qenë sepse na kemi qenë të dytë aktor në këtë
11 ngjarje dhe s’ka mujt diskut tjetër që s’ka qenë në këtë
12 ngjarje, domethënë, me e përshkru atë ngjarje.

13 PY. Çfarë do të thotë kjo “u përzi politika dhe interesat
14 klanor” --

15 PË. Po.

16 PY. -- si shpjegohet? Çfarë është kjo?

17 PË. Po politika edhe jashtë Kosove në mërgim dhe politika në
18 Prishtinë, individë të caktum gjithnjë kanë bërë propagandë
19 kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me etiketu me lloj-lloj
20 etiketimesh. Dhe kur përzihet politika në ushtri atëherë është
21 problem. Kështu që aty kam vërejt që ka pasë përzimje, ka pasë
22 intriga.

23 Individë të cilët tash kanë ndjetë shumë larg Kosovës,
24 shumë larg UÇK-së, në kushte të mira, napër hotele a ku di unë
25 ku kanë qëndru dhe kanë dashtë me skandalizu edhe me e dëmtu,

1 domethënë edhe qëllimin e vizitës tonë por edhe vetë UÇK-në.

2 Kjo është përzierja politike.

3 PY. Në rregull. Po ashtu thoni:

4 "Me këtë rast, u krijuan pa nevojë disa mosmarrëveshje me
5 disa nga pjesëtarët e UÇK-së të cilat ishin më shumë prodhim i
6 intrigave me prapavijë politike".

7 A mund të na shpjegoni cilat ishin këto intriga me
8 prapavijë politike që shkaktua --

9 PË. Po.

10 PY. -- këto keqkuptime me UÇK-në?

11 PË. Për shembull, edhe sot e kësaj dite ka individë që po
12 dojnë, kanë shkru e po shkruajnë libra se gjoja na kena shku me
13 u thanë me dorëzu armët, domethënë, absolutisht s'është e
14 vërtetë. Unë personalisht po ju them, kur kam pa shka ndodh me
15 popullin tim, popullin tonë, popullin shqiptar, UÇK-së me pasë
16 mujt ia kisha bë armë bërthamore edhe të gjitha llojet e
17 armatimit. Edhe pse thashë ju e dini se çfarë armatimi e çfarë
18 kushtesh ka vepru UÇK-ja, në kushte titanike, në kushtet më të
19 vështira të mundshme që mund të ushtrojë aktivitetet guerile
20 vetëmbrojtëse një ushtri.

21 Dhe për këtë arsye, domethënë, ata kanë pasë të drejtë se
22 dikush i ka telefonu, nuk muj spekulu tash, nuk muj me -- iu
23 ka thënë që "Shiqoni, se dikush ka ardhë me kërku me i dorëzu
24 armët", që me nujt me pasë një konflikt mes UÇK-së edhe nesh.
25 Një konflikt ndoshta me pasoja fatale, që kish pasë me qenë

1 komplet fatale për Kosovën dhe për UÇK-në edhe për ne. Këtu
2 është qëllimi i kësaj që kam thanë.

3 Po s'ka ra në grackë as UÇK-ja as na.

4 PY. Në rregull. Ju njoftuat paraprakisht ose më saktë e
5 koordinuat këtë udhëtim me Shaun Byrnes, kështu?

6 PË. Po e kam njoftu. Se ai nuk ka qenë koordinator.

7 Domethënë, ai s'na ka thënë -- s'më ka thënë me shku. Kur kam
8 taku Presidentin Rugova më ka thënë që është edhe sugjerim i
9 Shaun Byrnes se është mirë me u afru me pasë një koordinim mes
10 politikës dhe UÇK-së. Këtu është ajo sensi se nuk du, nuk kam
11 dëshirë me involvu, domethënë, unë Shaun Byrnes. Mirëpo Shaun
12 Byrnes e kam njoftu pas çdo vizite.

13 Jam ndal i baltosun kur jam kthy prej pyllit, se kena ec
14 napër mal, napër lloq, napër baltë, e kam njoftu për situatën
15 dramatike të popullatës civile në misionin vëzhgues amerikan
16 që ka pasë selinë në Fushë-Kosovë afër Prishtinës.

17 PY. Në rregull. Pasi përfundoi konflikti në Kosovë në 1999,
18 ju vijuat të kishit komunikim me Shaun Byrnes, a takoheshit
19 ndonjëherë për të pirë kafe, a bisedonit me të?

20 PË. Rrallë e kam taku. Po e kam taku, ai ka qenë edhe në
21 Paris, me sa më kujtohet, kur u nënshkru Marrëveshjen e
22 Rambujesë. Kam qenë edhe unë pjesë e delegacionit, në pjesën
23 finale të nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë, që kam
24 pasë nderin edhe privilegjin me qenë në atë pjesë historike.

25 Ku duhet ta them, ndoshta për herë të parë dhe pse të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 101

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 tjerët e mohojnë, tuj i falenderu Presidentit Hashim Thaçi ka
2 përfundu konflikti në Kosovë edhe është nënshkru marrëveshja e
3 Rambujesë.

4 PY. Në rregull. Do flasim edhe për këtë. Po pyesja për Shaun
5 Byrnes tani. Kur është hera e fundit që e keni parë Shaun
6 Byrnes?

7 PË. Mos me spekul, ndoshta në Paris. Ndoshta, ide nuk kam,
8 nuk kam dëshirë me spekul sepse kam shumë respekt për atë
9 autoritet. Edhe unë me thanë të drejtën kam respekt për çdo
10 amerikan dhe për çdo evropian dhe për çdo anëtar të NATO-s.

11 PY. Në rregull.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë
13 private. Shkurtimisht.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
15 çaktivizuar].

16 Për të mbrojtur dëshmitarin?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, do të përdor një dokument që
18 është i mbrojtur.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Të kalojmë në seancë private për shkak të klasifikimit që
21 ka dokumenti në fjalë.

22 ~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në
24 seancë private.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 102

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 Misetiç.

2 Z. MISETIÇ: [Përkthim]

3 PY. Një nga qëllimet e udhëtimit të delegacionit ishte që të
4 takonte, të bënte takime me popullatën në zonat e ndryshme në
5 mënyrë që të kundërekuilibronte influencën që kishte që kishte
6 UÇK-ja, a është kështu?

7 PË. Jo, të kundër --

8 PY. Ndërpeshonte.

9 PË. -- po, por qëllimi ishte përveç vizitës së popullatës
10 civile kishim dëshirë t'i vejmë edhe kontaktet me pjesëtarët e
11 UÇK-së sepse ishin, domethënë, të parinovueshme. Domethënë,
12 kishte akuza nga Prishtina zyrtare nga individë edhe qarqe të
13 tjera akuza shumë të rënda për UÇK-në, mu personalisht me
14 thënë të drejtën më ka interesu sepse edhe unë kam pasë
15 paragjykime se kemi qenë të bombardum prej lajmeve të rrejshme
16 kundër UÇK-së. Edhe kam pasë edhe unë dëshirë me i taku
17 pjesëtarët e UÇK-së.

18 Me i pa kush janë, shka po dojnë, me ia dëgju hallet e
19 tyne që me mujt me ia përcjellë miqve të mi, domethënë, në
20 takimet e mia ndërkombëtare, qoftë në kongresin amerikan, në
21 State Departament [në anglisht], në këshill të Evropës, në
22 parlament evropian dhe kudo që i kam pasë. Me qindra e qindra
23 mos të them edhe me mijëra takime.

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 103

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 104

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 105

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 [REDAKTUAR]

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe një minutë ju lutem, Kryetar i
3 Trupit Gjykses.

4 PY. Dhe dy pyetje shumë të shkurtra dhe të kalojmë nga seancë
5 private të bëjmë pushimin e drekës.

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 106

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të dalim nga seancë private.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Kalojmë në seancë publike.

21 ~~{Seancë e hapur}~~

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Është çasti për të bërë pushimin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Dëshmitar, tani kemi pushimin e drekës. Do riktheheni në
2 orën 14.30 në mënyrë që të vazhdojmë e të përfundojmë dëshminë
3 tuaj për ditën e sotme.

4 DËSHMITARI: Faleminderit shumë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ju
6 shoqërojë Asistentja e sallës së gjyqit.

7 DËSHMITARI: [Në anglisht] *Thank you very much.*

8 Faleminderit.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
11 rifillon në orën 14.30.

12 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.03

13 --- Seanca rifillon në orën 14.30

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon
15 MF1 685 ne do të mohojmë pranimin në provë materiale të kësaj
16 prove, të këtij materiali tani. Ka disa çështje që kanë të
17 bëjnë me relevancën dhe autencitetin dhe ka edhe një tjetër
18 dëshmitar që është planifikuar që të japë dëshmi dhe mbase
19 mund të trajtojë këtë dokument.

20 Znj. Sekretare, mund ta fusni dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
23 të vazhdojmë pyetjen, me pyetjet që ka Mbrojtja e z. Thaçi.

24 Z. Misetic, mund të vazhdoni.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

1 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Dëshiroj të shikoj një tjetër
2 dokument.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
4 paraqesë në ekran dokumentin DHT01420-ET, ky është versionin
5 në anglisht -- ju kërkoj ndjesë. Është DHT01418. Ta filloj
6 edhe një herë. Është 1D0038. Faqja 3 në anglisht edhe në shqip
7 faqja ka numrin DHT01419.

8 PY. Dëshmitar, është një buletin, buletini numër 23 i cili
9 është botuar nga LDK-ja me datë 24 shtator 1998. Domethënë,
10 një ditë pas lirimit tuaj. Dhe këtu citoheni ju. Në qoftë se
11 do shkojmë te faqja e fundit, paragrafi i dytë, besoj që
12 shikoni që thuhet që ju keni thënë:

13 "Mendoj që çdo vend ka të drejtën që të ketë forcat e
14 armatosura të cilat funksionojnë në kuadër të institucioneve
15 ligjore dhe legjitime".

16 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. A pasqyron saktësisht pozicionin tuaj ose qëndrimin tuaj
19 kjo --

20 PË. Po.

21 PY. -- më datë 24 shtator 1998 ose rreth kësaj date?

22 PË. Mendoj se çdo vend duhet me e pas. [e pakuptueshme] edhe
23 Kosova.

24 PY. Më 24 shtator 1998, a ishte UÇK-ja një forcë ushtarake që
25 funksiononte në kuadrin e institucioneve ligjore dhe

1 legjitimeve sipas mendimit tuaj në atë kohë?

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtojmë. Mendojmë që nuk
3 është e drejtë si pyetje.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të vazhdoj z. Gjykatës?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
6 kundërshtimi. Mund të vazhdoni.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Z. Dedaj, do ta përsëris edhe një herë. Ju keni bërë këtë
9 deklaratë dhe po ju bëj një pyetje sa i takon interpretimit të
10 kësaj deklaratë tuajës. Ta shpreh ndryshe.

11 Më 24 shtator 1998, a mendonit ju se UÇK-ja po
12 funksiononte brenda kuadrit të institucioneve ligjore dhe
13 legjitime?

14 PË. Mendoj se institucionet e Kosovës në Prishtinë ishin ato
15 të cilat ishin përcaktuar për zgjidhjen paqësore të çështjes së
16 Kosovës dhe nuk i kanë afër bashkëpunimin e duhur Ushtrisë
17 Çlirimtare të Kosovës që ajo të jetë në kuadër të
18 institucioneve të atëhershme të Republikës së atëhershme të
19 Kosovës.

20 PY. Në rregull. Mendoj se e kuptoj përgjigjen që dhatë. Dhe
21 nëse do të vazhdojmë më tej, në seancën përgatitore me
22 Prokurorinë javën që shkoi dhe kjo pasqyrohet në shënimin
23 përgatitor në paragrafin 29. Ju i keni thënë Prokurorisë:

24 "Ishte gjithashtu një gabim i zyrtarëve në Prishtinë,
25 sepse disa zyrtarë kanë bërë deklaratë të padrejta për UÇK-

1 në".

2 Kur i keni thënë Prokurorisë "zyrtarët në Prishtinë", e
3 kishin fjalën për politikanët në Prishtinë, për në Kosovë?

4 PË. Për politikanët në Prishtinë që shpeshherë kanë bërë
5 deklaratë tepër të dëmshme, etiketuese edhe fyese për Ushtrinë
6 Çlirimtare të Kosovës.

7 PY. Këta zyrtarë apo politikanë përfshinin edhe politikanë të
8 LDK-së?

9 PË. Politikanët e partive të ndryshme. Sepse sa për sqarimin
10 tuaj në UÇK ka pasë edhe anëtarë të gjitha partive. Ka pas
11 edhe të Partisë Liberale të Kosovës që kanë qenë edhe
12 komandantë edhe që janë vra në emër për UÇK-në. Mirëpo, jam ka
13 flasim tash për ka pas edhe individë edhe zyrtarë në parti të
14 ndryshme, më shumë ka pas në LDK, sepse është partia ka qenë
15 më e madhja, domethënë, që kanë bë propagandë anti-UÇK-së edhe
16 kanë etiketu edhe kanë tentu me denigru aktivitetin çlirimtar
17 e luftën heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

18 PY. Kur u ndaluar nga UÇK-ja dhe njëra prej gjërave që besoj
19 që e keni konfirmuar deri tani, por thjesht sa për të qenë të
20 sigurt, një prej gjërave që ata menduan ishte që dikush mund
21 të kishte shkuar në Qirez për të biseduar për çarmatimin, a
22 është e saktë kjo?

23 PË. Kjo është e saktë. Ka mundësi se dikush nga delegacioni
24 ka ndryshu me bazë e ka mundësi dikush nga delegacioni që edhe
25 ka folë për këtë çështje, domethënë. Ose si me porosi ose nga

1 bindje e vet. Nuk përjashtohet kjo mundësi.

2 PY. Situatë në Qirez në atë kohë ishte e mjerë, sepse kishte
3 një ofensivë serbe që po afrohej, të menjëhershme, është e
4 vërtetë kjo?

5 PË. Jo, ofensivat ishin të rregullta aty. Aty ishte bë
6 domethënë, në Drenicë sidomos, në Dukagjin dhe disa zona ku ka
7 pas terror permament. Ato kanë qenë ditore.

8 PY. Jo, por them vetë brenda Qirezit ju e dini që popullata,
9 pra, po ishte përballë një sulmi të menjëhershëm, vetë në
10 Qirez. Domethënë, e kam fjalën këtu për sulmin e serbëve.

11 PË. Qirezi ishte i rrethum; ishte në shtetrrrethim. Edhe
12 xhamia e fshatit ishte e bombardume.

13 PY. Dëshiroj të kthehem pas në deklaratën që i keni dhënë
14 EULEX-it në 2014. Përpara se sa të diskutojmë lidhur me këtë -
15 -

16 PË. A [e pakuptueshme] a bën se nuk i di këto procedurat?

17 PY. Po, patjetër.

18 PË. A mundesh me e nxjerr edhe një herë këtë çka pashë këtu?
19 Këtë fletën, buletinin?

20 PY. Ka ndonjë gjë veçanërisht që doni të diskutoni, që doni
21 të shihni aty? Çfarë doni të shihni?

22 PË. Një deklaratë aty është e imja kur thuhet që UÇK-ja
23 kishte ndaj nesh sjellje korrekte. Është në këtë buletin e nuk
24 e përmendët.

25 PY. Më besoni që do t'i kthehem kësaj. Pas ca kohe do t'i

1 kthehemi prapë këtij dokumenti, jo tani, por do e diskutojmë
2 më pas.

3 PË. Më fal [e pakuptueshme]

4 PY. Po. Të flasim pak për kontekstin në cilin ju keni dhënë
5 deklaratën në vitin 2014 për EULEX-in.

6 Ju ia keni dhënë këtë deklaratë, në mos gabohem, EULEX-it
7 në maj të 2014-s, më datë 21 maj 2014 në qoftë se nuk gabohem.
8 Është e saktë kjo?

9 PË. Për datë nuk jam shumë i sigurt, por mund të jetë,
10 domethënë. Nuk e di datën sigurt. Nuk mund me e mbajt mend.

11 PY. Në rregull. Ishte 21 maji 2014. A ju kujtohet që
12 intervista e EULEX-it ka ndodhur në mes të një fushate
13 zgjedhore në Kosovë për zgjedhje parlamentare, është e saktë
14 kjo?

15 PË. Po.

16 PY. Ju keni qenë kandidat në listën e z. Pacolli atëherë,
17 kështu?

18 PË. Po, kemi qenë koalicion; kam qenë në listën e Pacollit,
19 sepse edhe Pacolli më vonë, mbas nesh, disa vite mbas nesh ka
20 apliku dhe është anëtarësu në grupin e liberalëve të Evropës
21 dhe kam dashtë me forcu liberalizmin, liberal-demokracinë në
22 Kosovë.

23 PY. Zgjedhjet ishin planifikuar për në fillim të qershorit
24 2014, kështu?

25 PË. Me siguri, po tash datat, datat nuk i mbaj mend shumë,

1 sepse kanë kalu shumë [e pakuptueshme] nëpër shpirtin e nëpër
2 trupin tim.

3 PY. A ju kujtohet që këto ishin zgjedhje të menjëhershme,
4 sepse kryeministri Thaçi kishte thirrur këto zgjedhje më të
5 hershme si rezultat i shpërbërjes --

6 PË. Po ishin zgjedhje të parakohshme.

7 PY. -- së koalicionit ndërmjet partisë së vet dhe z. Pacolli.
8 A është kështu?

9 PË. Ishin të parakohshme.

10 PY. Dhe kishte ardhur si rezultat i shpërbërjes së
11 koalicionit --

12 PË. Po.

13 PY. -- ku përfshinte ndër të tjera dhe partinë e z. Thaçi dhe
14 partinë e z. Pacolli. Kështu?

15 Ju vetë personalisht ishit shkarkuar nga posti që mbanit
16 në atë qeveri në 2011, kështu?

17 PË. Po. Nëse më lejoni pak, dua me sqaru një shkarkim timin
18 spektakolar. A guxoj, a kam kohë?

19 PY. Ju premtoj që do kalojmë edhe te kjo pika.

20 PË. Mos ma harroni premtimin.

21 PY. Ju premtoj. Do ta cekim edhe këtë. Pot thjesht dua që së
22 pari të përcaktojmë kontekstin. Domethënë, dua të përcaktoj se
23 çfarë po ndodhte rreth e qark jush në momentin kur e dhatë
24 këtë deklaratë. Ju i keni thënë, dhe më korrigjoni në qoftë se
25 e kam gabim, i keni treguar Trupit Gjykses edhe Prokurorisë që

1 keni bërë ca pretendime të caktuara që kanë që lidhen me
2 motivimet ose motivet politike. A është e saktë kjo?
3 PË. Po. Shikoni të gjitha deklaratat e mia prej vitit 2001 e
4 deri kur e kam kuptuar saktë, m'u ka dash shumë kohë me e
5 kuptu saktë kush ka bashkëbisedu me mua në, posaçërisht grupi
6 kush ka qenë brenda që është përplas me ne. Sot e asaj dite
7 edhe nuk kam dëshirë me vdek pa i dit ata emra kush kanë qenë
8 ata njerëz. Domethënë, edhe m'u ka dasht shumë kohë. E kam
9 vizitu edhe Qirez, kam shku në Qirez me mbledh informacione,
10 në Drenicë e ku kam mujt me e dit saktë kush është fajtor. Dhe
11 nga fundi, domethënë, mbas një kohe shumë të gjatë, jo për me
12 dasht me justifiku diçka këtu unë; jam bindëse, Presidenti
13 Hashim Thaçi, a më bashkëlidhje asnjë fajin më të vogël nuk e
14 ka për gjendjen dhe për atë situatën në Qirez as në Baicë.

15 Atëherë edhe domethënë --

16 PY. Në rregull.

17 PË. Kjo është problemi; ky është problemi im që s'po mund me
18 u kuptu. Sikur të ishte e kundërta, këtu përballë i kisha
19 thënë, ju jeni fajtorë edhe nuk mërzitna, domethënë, mirëpo
20 është absolutisht i pafajshëm. Bile ju falënderoj mos të
21 kishte qenë ky në atë moment atje nuk di se si ishim, çfarë do
22 të kishte ndodh me ne. Kjo është e vërtetë.

23 PY. Në rregull. Ju dëgjuam lidhur me këtë pikë edhe këtë
24 argument e ngritët disa herë.

25 PË. Po.

1 PY. Mund t'ju siguroj që Trupi Gjykues edhe palët do ta
2 marrin parasysh këtë gjë. Kështu që nuk është e nevojshme që
3 ta përsërisim më se e keni ngrit --

4 PË. Jo, jo [e pakuptueshme]

5 PY. -- disa herë gjatë ndërhyrjes.

6 PË. Po më brengos shumë edhe po më lenë pa gjumë edhe fëmija
7 mi edhe më kanë shkru mbrëmë. Kanë marrë me qindra ofendime
8 prej hijenave të Facebook-ut, prej milingonave, mushkonjave të
9 Facebook-ut edhe nga zyrat, zyra e Presidentes të ashtuquajtur
10 është Osmani, e cila e dimë si ka ardhë presidente. Është konë
11 në LDK, e ka keqpërdorur LDK-në, por këto janë politike.

12 PY. Në rregull.

13 PË. Por unë jam ka pësoj. Unë jam ka pësoj. Edhe ka hakmarrje
14 edhe ndaj fëmijëve të mi që janë në punë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

17 PY. Dëshmitar, e kuptoj. Megjithatë, sikurse ju thashë edhe
18 kur fillova do mundohemi që të nxjerrim në pah sa më shumë
19 fakte që të jetë e mundur në mënyrë të tillë që të ecim pak më
20 shpejt. Kështu që më lejoni që të përqendrohëm këtu te pyetjet
21 e planifikuara.

22 A kam të drejtë që kur ju i thatë Gjykatës dhe
23 Prokurorisë që kishte motivime të caktuara politike, këtu
24 përfshihet edhe konteksti i zgjedhjeve të parakohshme të 2014-
25 s kur keni bërë deklaratën përpara EULEX-it?

1 PË. Po. Ato janë deklarata politike. Puro politike.

2 PY. Keni bërë deklarata të shumta në deklaratat që keni dhënë
3 për EULEX-in në 2014 kundër z. Thaçi ose ndaj z. Thaçi --

4 PË. Po.

5 PY. -- në kontekstin politik. A është e saktë kjo?

6 PË. Në kontekstin politik, në kontekstin sepse kemi qenë të
7 bombardum me gënjeshtër se gjoja Hashim Thaçi është fajtor e
8 gjoja në emër të tij kanë bërë të tjerët pa e ditur ky hiç
9 kurrgjë. Domethënë, unë kemi qenë të ngarkuar, kena mendu se
10 vërtetë është fajtor. Është e vërtetë kjo.

11 PY. E kuptoj, në rregull. Të shohim pak këtë deklaratën.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Për Sekretaren është prova
13 materiale 680, 034236. Më konkretisht faqja ka [sipas
14 përkthimit] që dua që të paraqitet është 034240 në anglisht
15 dhe në shqip faqja është 034249.

16 PY. Së pari, dua të flasim rreth forcave serbe këtu, por në
17 veçanti dua që t'ju pyes, domethënë, ju bënë pyetje që kanë të
18 bëjnë me mënyrën se si patët mundësi që të kalonit serbët. Ju
19 bënë disa pyetje lidhur me këtë. Në anglisht fillon me këtë
20 fjali:

21 "A arritët në fshatin Qirez?".

22 Përgjigja që ju jepni është:

23 "Po. Nuk mund t'ju them çdo gjë që kaluam në rrugës për
24 atje. U ndaluar shumë herë nga forcat serbe. Ne ishim të
25 përgatitur që të përjetonim çdo gjë".

1 Pastaj Prokurori vazhdon më tej:

2 "Çdo herë keni mbërritur që të shkoni më tutje?".

3 Ju thoni:

4 "Po. Argumentet tona ishin të forta. Unë e kisha të tërë
5 dokumentacionin; unë nuk kisha të bëja fare me luftën; unë
6 shkoja për t'i parë civilët; unë isha po ashtu një ndër ata
7 persona që përkrahnin përfundimin e luftës; unë nuk e kisha
8 shpirtin e militarëve".

9 PY. A është e saktë kjo, Dëshmitar, që në atë kohë që juve
10 përkrahnit përfundimin e luftës?

11 PË. Në çdo kohë unë jam kundër çdo lufte. Edhe kemi provuar
12 nja dhjetë vjet me arrit zgjidhje paqësore për Kosovën, por
13 ajo, jo që s'ka pas sukses, por e ka thellu terrorin dhe
14 gjenocidin serb në Kosovë.

15 PY. Në këtë deklaratë keni thënë po ashtu --

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe për palët është dokumenti
17 034241 dhe në shqip është 034250 deri në 251.

18 PY. Ju thoni, përpara sesa të futeshim në Qirez juve u
19 ndaluar nga një makinë me anëtarë të UÇK-së, me pjesëtarë të
20 UÇK-së, a ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po. Kanë hap dritaren, domethënë, nuk kanë zbrit, por
22 edhe na veç e kemi hap dritaren për me bisedu. Ata në anën
23 tjetër, domethënë.

24 PY. A ju ndaluan ata që të mos shkonit në Qirez?

25 PË. Jo. Jo.

1 PY. Pra, nuk kishte problem të paktën me aq sa dini ju nga
2 ana e UÇK-së që të lejonte delegacionin që të shkonte në
3 Qirez?

4 PË. Jo, jo.

5 PY. Kështu?

6 PË. S'ka pasë, ne kemi shku në Qirez. Me na pa dalë ata me na
7 kthy ne ishim kthy, domethënë. Sikurse na kanë kthy serbët në
8 Pejë, me zor, me dhunë.

9 PY. Kur mbërritët në Qirez shkuat në një xhami ku ishin të
10 grumbulluar mijëra njerëz, kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Pas kësaj vizite në xhami ju përfunduat në një zyrë
13 informacioni të bashkësisë, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Ju thoni që folët me personin që ishte përgjegjës për
16 fshatin. A është e saktë kjo?

17 PË. Po. Ishin me sa duket ishin njerëz të LDK-së, përgjegjës
18 për informimin e për fshatin, kryetar i LDK-së të fshatit. Nuk
19 e kam pyet, nuk më ka interesu shumë, por ishin njerëz që
20 ishin civilë, domethënë, ishin banorë të fshatit.

21 PY. UÇK-ja nuk të ndaloi që ti të shkoje dhe të takoheshe me

22 --

23 PË. Jo.

24 PY. -- udhëheqës vendorë të LDK-së, kështu?

25 PË. Jo.

1 PY. A keni ndonjë arsye për të besuar që njerëzit vendas të
2 LDK-së në Qirez janë keqtrajtuar përpara sesa të mbërrinte
3 delegacioni juaj atje?

4 PË. Jo, jo.

5 PY. Partia juaj, a kishte një degë aty në Qirez?

6 PË. Jo.

7 PY. Mbas lufte kemi pas degë në Skënderaj dhe në Drenas. Dy
8 komunat e Drenicës edhe shumë simpati.

9 PY. UÇK-ja, a ju ndaloi që të takoheshit me njerëzit në
10 Qirez?

11 PË. Jo, jo. Ne jemi konë, jena takue. UÇK-ja ka ardhë gati
12 nga fundi i bisedave tona.

13 PY. Arriti një kohë kur u bënë fjalime të caktuara nga
14 anëtarë të delegacionit, është e saktë kjo?

15 PË. Po. Edhe jam mundu me gjet audiokasetën çka kemi folë.
16 Domethënë, ma ka pas dhënë një gazetar. Edhe me pa që na kena
17 folë krejtësisht për gjëra humanitare, por edhe me e përkrah
18 me u solidarizu njerëzit me UÇK-në, se ishte një ushtri që
19 ishte na u kish imponu në mbrojtje të familjes, të jetës,
20 pragut të shtëpisë, nderit, sakrificave, domethënë për kundër
21 regjimit të Milosheviqit.

22 PY. Tani të flasim pak për fjalimet.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoja të paraqitet në ekran
24 dokumenti SITF00055783 deri në 00055996 në faqen SITF00055858.
25 Ky është versioni në anglisht, ndërkohë që në shqip është

1 SITF000652 [sipas përkthimit] deri në 00055863.

2 PY. Është një artikull gazete. Mban datën 22 shtator 2001.

3 Titulli është "Hashim Thaçi urdhëron dhe Sabit Geci ekzekuton

4 sa i takon arrestimit të delegacionit, në Qirez, në Kosovë", -

5 - më falni. Në versionin në anglisht te kolona e tretë. Në

6 artikull thuhet:

7 "Politikanët shqiptarë të Kosovës me fjalimet e tyre

8 dhanë shpresë që liria nuk ishte shumë larg".

9 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

10 Pyetja që kam për ty është kjo: Çfarë u tha në fjalimet e

11 atyre që mbajtën fjalime lidhur me mënyrën se si do të arrihej

12 liria?

13 PË. Ju kemi dhënë shpresë se bota demokratike, Shtetet e

14 Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, NATO janë në anën

15 tonë, sepse janë në anën e drejtësisë. Edhe kena folë,

16 domethënë, për zhvillimet politike në Prishtinë.

17 Tash nuk më kujtohet në detale, sepse shumë kam pas

18 dëshirë me e ridëgju atë kasetë se janë 25 vjet nga ai takim.

19 Por çka muj me ju thonë se në fjalën time për asnjë sekondë

20 dhe asnjëherë nuk është fol për kurrfarë dorëzimi, për

21 kurrfarë, domethënë, vetëm jemi shpreh kundër politikës

22 gjenocidale të Milosheviqit në Kosovë edhe terrori që

23 ushtronte posaçërisht në këto momente kur ishim në Drenicë

24 ndaj popullatës civile në Drenicë.

25 PY. Disa prej anëtarëve të delegacionit a thonin që liria do

1 të arrihej së shpejti, duke i dhënë fund luftimeve të
2 armatosura dhe duke arritur një lloj marrëveshje që mund të
3 ishte marrëveshje paqeje?

4 PË. Ne i kemi besu lirisë sepse ishte e drejtë, domethënë,
5 ishte e drejta në anën tonë dhe për atë edhe kemi sakrifiku
6 çdo gjë për liri edhe jetët tona. Edhe me shfaqjen e UÇK-së e
7 kemi kuptu, unë flas tash për vete, se liria do të shpejtohet
8 edhe [e pakuptueshme] do të ndodhë. Edhe ashtu siç e kam
9 parashiku edhe menu ka ndodhë, sepse ka ndodhë procesi i
10 Rambujesë edhe tuj falenderu delegacionit të UÇK-së është
11 arrit marrëveshja historike në Rambuje në bashkëpunim me
12 Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me NATO-n, me Bashkimin
13 Evropian, me UÇK-së që janë katër faktorët kyç të lirisë së
14 Kosovës.

15 PY. Do t'i kthehem përsëri pas ca kohe këtij artikulli, por
16 le të vazhdojmë më tej për momentin. Pra, jepen fjalimet në
17 xhami pastaj ju shkoni te zyra vendore e bashkësisë, kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Sa njerëz kishte aty në zyrë?

20 PË. Me numra nuk mund me spekulu sepse çfarëdo numri që të
21 them nuk e them të saktë. Por ka qenë, domethënë, përveç
22 anëtarëve të delegacionit tonë kanë qenë ndoshta, dëshira ime
23 është mos me përmend numra se sinqerisht nuk është se do të
24 them një numër të saktë se nuk i kam numrat. Por nuk kanë qenë
25 1 ose 2, por kanë qenë më shumë. Kanë qenë shumë njerëz.

1 Domethënë, 10, 20, 30 s'po e di tash.

2 PY. A kishte mobilie në atë dhomë?

3 PË. Po, po kishte mobilie ku jemi ul, karriga, tavolina.

4 Gazetarët ishin në këmbë rreth nesh.

5 PY. Sa të mëdhaja ishin tavolinat?

6 PË. Të vogla, por shiko. Ne po flasim për zyrat në një

7 vendbanim të vogël në kohë lufte. S'ka pas konfort, domethënë,

8 po ka qenë zyra, domethënë, të improvizume me karriga me

9 ndonjë tavolinë të vogël, me karriga siç kanë qenë ato. Tash

10 po unë nuk i kam shiku, nuk më kanë lënë përshtypje,

11 domethënë, karrigat edhe tavolinat. Më ka lënë përshtypje çka

12 duhet me folë ne aty, çka duhet me bisedu me ata njerëz.

13 PY. Gani Koci ishte personi i parë që u fut në atë dhomë nga

14 UÇK-ja?

15 PË. Gani Kocin e kena pa jashtë fillimisht. Domethënë, akoma

16 pa hy, e kena pa nga xhamia andej, nga se kena lëviz në këmbë

17 ne aty prej xhamisë e andej nëpër fshatin Qirez. Domethënë

18 Gani Kocin e kemi, e kam njoft prej Prishtine se ai ka qenë

19 zyrtar i LDK-së. Edhe disa anëtarë të delegacionit kanë pas

20 edhe polemika. Ndoshta këta të LDK-së që janë njoft kanë qenë

21 me një parti. Kanë pas edhe polemika, kanë bisedu edhe me ton

22 kështu me Gani Kocin, por unë s'jam marrë shumë me Gani Kocin

23 se unë kam pas, domethënë, tjetër mision, me i taku banorët me

24 pas çka kanë probleme, çka është problem, çka muj me iu

25 ndihmu. Kjo ka qenë interesimi im.

1 PY. Gani Koci ju tha që të prisnit që të vinte dikush tjetër?

2 PË. Po Gani Koci tash nuk e di a na ka thënë që të prisnim,
3 por e di që është personi i parë që e kemi taku në Qirez nga
4 UÇK-ja.

5 PY. Gjatë kohës që ishit në atë dhomë, a është e drejtë të
6 themi që nuk ju kërcënuan, s'morët asnjë kërcënim në atë
7 dhomë?

8 PË. Asnjë. Asnjë kërcënim.

9 PY. Të njëjtën gjë keni thënë edhe në konferencën për shtyp
10 më datë 23. Thatë që nuk jeni kërcënuar në kuptimin e
11 mirëfilltë të fjalës 'kërcënim'.

12 PË. [e pakuptueshme] Edhe janë sjellë shumë korrekt. E kam
13 thënë edhe në konferencë të shtypit. E kam thënë edhe në Zërin
14 e Amerikës të mbrëmjes. E nuk e di pse nuk e keni siguru
15 intervistën e Zërit të Amerikës.

16 PY. Fizikisht, a u keqtrajtua njeri në zyrën në Qirez?

17 PË. Askush. As nuk e ka ngrit zërin dikush ndaj nesh bile.

18 PY. Askush nuk u rrah?

19 PË. Askush, askush, as prek me gisht, kush askënd s'e ka.

20 PY. Askush nuk u qëllua me armë?

21 PË. Jo, jo, çfarë armësh. Asnjëherë.

22 PY. A i vendosi ndokush armën në gojë ndokujt?

23 PË. Jo. Domethënë, kjo është, okej për herë të parë po e
24 dëgjoj. Asnjë armë. Domethënë, as nuk e kanë ekspozu një armë
25 e jo më me ia afru te goja. Absolutisht. Nuk u bë fjalë aty

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 124

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 për armë as për dhunë.

2 PY. Kush jua mori letërnjoftimet?

3 PË. Ju e dini që kam fol kush edhe Prokuroria, znj. Prokurore
4 e di. Personi numër 1.

5 PY. Personi që ju tha, dhe do përdor fjalët tuaja, që ju tha
6 që do ndaloni. Jo në kuptimin e ndalimit, por thjesht ndaloni
7 në vend. Kush ishte ky person?

8 PË. Është mirë nëse ka mundësi me kalu në seancë private?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
10 çaktivizuar]

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe unë do preferoja në fakt, i
12 nderuar Kryegjykatës, që të kalonim në seancë private të
13 paktën për këtë pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Kalojmë në seancë private.

16 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Kush ishte ky person që ju tha të ndaloni?

20 PË. [REDAKTUAR]

21 PY. Mund të dalim nga seanca private; të kalojmë në seancë
22 publike.

23 ~~{Seancë e hapur}~~

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

1 PY. Në 2014 keni thënë që ka qenë dhe z. Thaçi në atë dhomë.
2 Ndërsa këtë javë thatë që s'e keni parë asnjëherë në Qirez dhe
3 unë dua të ma thoni edhe një herë që të marrin vesh të
4 vërtetën. A keni parë z. Thaçi në atë dhomë në Qirez?
5 PË. Unë e kam thënë edhe në media më vonë kur jam bind se
6 s'ka qenë, domethënë, kam studiu shumë se më ka interesu a ka
7 qenë. Edhe gjatë tri ditëve që kam ardhë në seancën
8 parapërgatitore edhe dje edhe sot edhe nesër, sepse kjo është
9 e vërtetë se z. Thaçi nuk e kam pa në Qirez; nuk ka qenë në
10 Qirez.

11 PY. Do ju pyes tani lidhur me mundësinë tuaj për të
12 identifikuar z. Thaçi në Qirez. Ju bënë disa pyetje në
13 intervistën e EULEX-it në 2014 lidhur me këtë që ka numrin e
14 provës materiale P680, faqja 034242 - 034243 edhe e njëjta gjë
15 në shqip.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
17 çaktivizuar]

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Fillon te pjesa, besoj në fund, drejt fundit. Në
20 anglisht: "Asnjëherë s'kam pas kontakt në jetën time. Unë deri
21 atë ditë nuk, kurrë nuk kam pas kontakt me ta në jetën time".

22 Ju përgjigjeni dhe thoni:

23 "Unë deri në atë ditë kurrë nuk kam pasur kontakt me ta
24 në jetën time. Por unë e njihja Hashim Thaçin, sepse disa muaj
25 më herët ai kishte dhënë një intervistë në një gazetë dhe aty

1 ishte fotografia, shumë fotografi të tija. Atë e quanin
2 "Gjarpri", "Snake" në anglisht. Kështu që e dija se ai ishte
3 personi. Sabit Geci ishte po ashtu aty."

4 Pra, baza juaj kur thoni që e njihnit Hashim Thaçin është
5 për faktin që keni parë intervista të tij, ku kishte fotografi
6 dhe që quhej, njihej si "Gjarpri". E quanin Gjarpri. Cila
7 gazetë ishte kjo? Do ju ndihmoj unë. Ju keni dhënë një
8 intervistë në televizion dhe keni thënë ose në gazetën Dielli
9 ose në Gazeta Shqiptare. Ju kujtohet që keni dhënë një
10 intervistë për këtë?

11 PË. Nuk më kujtohet në cilën gazetë, nuk më kujtohet kur e
12 kam dhënë këtë intervistë, sepse janë 25 vite në pyetje, por
13 më kujtohet saktë se Hashim Thaçi nuk ka qenë aty prezent.
14 Këtë e di.

15 PY. Thjesht ne duam të kuptojmë diçka. A ju ka treguar ju
16 ndonjëherë ndonjë provë që z. Thaçi ka dhënë ndonjë intervistë
17 apo është thënë publikisht që ishte Gjarpri para 20 shtatorit
18 të '98-s. Domethënë, a ka botuar njeri ndonjë artikull të
19 tillë, a është thënë në ndonjë gazetë kjo?

20 PË. Më vonë kësaj ngjarje ka ndodhë, domethënë, mbas kësaj
21 ngjarje ka ndodhë me dhënë intervista edhe këto nuk i di unë.
22 Nuk kam, nuk ka qenë temë që unë me është dashtë me përcjellë.
23 Domethënë, ajo çka më ka interesu mua dhe më intereson edhe
24 sot, më intereson kush ka qenë aty dhe kush nuk ka qenë aty.

25 PY. Në fakt këtu dua të fokusohem dhe unë. Ajo që po përpiqem

1 të kuptoj unë është kjo: Nëse ju thoni që mund ta kem parë
2 këtë intervistën e z. Thaçi pas 20 shtator, asokohe nga mund
3 ta dalloje ti kush ishte Hashim Thaçi; mbi ç' baza?
4 PË. Nëse e ka bërë ndonjë intervistë, nëse ka pas paraqitje
5 në televizion, nëse ka pas, e kam parë edhe domethënë, në
6 Baicë, atëherë unë e kam marrë vesh në Baicë kush është Hashim
7 Thaçi. Domethënë, sepse e kam taku në Baicë dhe kena
8 bashkëbisedu në Baicë. Por po flasim tash për Qirez. Pyetja
9 është për Qirez dhe përgjigja ime është e saktë. Në Qirez nuk
10 ka qenë Hashim Thaçi.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë tek anglishtja në faqen
12 034257 edhe shqipja është me numër 034273.

13 DËSHMITARI: Z. Avokat, a mund t'ju drejtohem diçka?

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Nëse ka lidhje me këtë që po flasim.

16 PË. Ka lidhje me mua. Ka lidhje me këtë proces.

17 PY. Patjetër.

18 PË. A mundesh me i tregue familjes time dhe publikut se këto
19 seancat e hapura për mua janë të dhunshme, kundër dëshirës
20 time.

21 PY. Dëshmitar, ankesa të tilla duhet t'ia drejtoni Kryetarit
22 të Trupit Gjykues që është këtu. Unë jam këtu për t'ju bërë
23 disa pyetje për të kuptuar çfarë dini e çfarë nuk dini dhe që
24 të mbledhim fakte. Nëse ju keni ankesa drejtohuni Trupit
25 Gjykues.

1 PË. Unë e kam kërkuar, Avokat, sa jam këtu, të takoj ndonjë
2 avokat, asnjëherë nuk më është afëruar një avokat. Kam kërkuar kur
3 jam thirrë nga zonja Prokurore në [REDAKTUAR], të kontaktoj
4 ndonjë avokat në [REDAKTUAR] se unë nuk i di proceset
5 gjyqësore. Kurrë s'kam marrë pjesë në ndonjë gjyq edhe katër
6 avokatë që kam thirrë në [REDAKTUAR] kurrë s'ka pranuar me
7 dashtë me folë me mua me më sqaruar për këto procedura.

8 Edhe prej [REDAKTUAR] kam kërkuar seancat të jetë të
9 mbyllura, private edhe këtu sa jam ka kërkuar edhe disa njerëz
10 atje të familjes sime janë ka mendojnë që unë kam kërkuar seancë
11 të hapur edhe ata ndihen shumë të rrezikuar. Edhe në fakt janë
12 të rrezikuar edhe kanë me qenë të rrezikuar padrejtësisht.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
14 çaktivizuar]

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

16 PY. Dëshmitar, kam edhe disa pyetje lidhur me këtë temë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më lart te faqja në
18 anglisht. Jo, desha të thoja poshtë. Shkojmë në faqen
19 pararendëse.

20 PY. "Unë e pyeta Hashim Thaçin, 'A jeni gjarpri?', sepse
21 nofka e tij gjatë luftës, nofka e tij gjatë luftës ka qenë
22 'Gjarpri'. Unë e kisha dëgjuar këtë emër që i ishte dhënë atij
23 përmes medias. Ai kishte dhënë një deklaratë medias disa ditë
24 më herët apo ndoshta një muaj më herët dhe fotografia e tij
25 ishte gjithashtu në gazetë. Kjo ishte arsyeja pse ia bëra unë

1 këtë pyetje. Ai më pyet mua 'Nga e dini ju këtë?'. Unë i
2 thashë se ai kishte dhënë një intervistë. Unë e pyeta nëse
3 ndodhej aty ndonjë person më i mençur".

4 Dhe vazhdon paragrafi. Kjo bisedë nuk ka ndodhur kurrë
5 apo jo?

6 PË. S'ka ndodhur kurrë. Nuk më kujtohet, domethënë që ka
7 ndodh kjo biseda.

8 PY. Nëse do të kishte ndodhur një bisedë e tillë atëherë do
9 kishte pasur edhe persona të tjerë ta kishin dëgjuar si z.
10 Bardhi mbase do ta kishte dëgjuar.

11 PË. Kanë qenë të gjithë aty.

12 PY. Agron Krasniqi --

13 PË. Agim.

14 PY. Agimi, Agimi na falni. Agim Krasniqi, doktor Jusuf
15 Telaku?

16 PË. Kanë qenë 13 deputetë, delegatë, deputetë.

17 PY. Pra, do ta kishin dëgjuar edhe personat e tjerë z. Thaçi
18 që ka qenë atje dhe paska konfirmuar që ishte Gjarpri, nëse do
19 të ishte e vërtetë.

20 PË. Me siguri do ta kishim dëgjuar, po të kishte qenë aty, po
21 të ishte e vërtetë.

22 PY. Pra, ju konfirmuat që nuk është e vërtetë. Prandaj nuk
23 është habi për ju tani që z. Telaku t'i ketë thënë EULEX-it që
24 nuk mban mend të ketë qenë i pranishëm z. Thaçi. Pra, nuk
25 është kjo befasia për ju?

1 PË. Jo, jo për mua nuk është befasi hiç. Për të tjerët mundet
2 me qenë befasi, për mua hiç, sepse nuk ka qenë aty.

3 PY. Do ju tregoj një artikull të gazetës Koha Ditore e 20
4 shtatorit 1998. Ku thuhet: Znj. Sanije Aliu dhe znj. Sanije po
5 ashtu ka qenë pjesë e delegacionit apo jo?

6 PË. Po, kanë qenë ato zonjat, por ato janë liruar menjëherë
7 ato, domethënë, ato asgjë nuk dinë çka prej lirimit ato kanë
8 shku për Prishtinë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim dokumentin. Ka numrin e
10 provës materiale P319, faqja 1 në shqip, faqja 2 në anglisht.
11 Faqja 1 në anglisht, faqja 2 në shqip -- më falni.

12 PY. Te ky artikull --

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë. Ose më
14 saktë duhet të shkojmë në faqen tjetër.

15 PY. Citon znj. Aliu te paragrafi i tretë:

16 "Papritmas një grup ushtarësh të UÇK-së, papritmas në
17 zyrë hynë një grup i ushtarëve të UÇK-së. Rreth dhjetë veta të
18 armatosur rëndë dhe kërkuan nga të gjithë të pranishmit
19 letërnjoftimet për t'i dërguar për verifikim. Pas një kohe
20 kërkuan nga shoferët e automjeteve tona që të dalin jashtë,
21 kurse një prej tyre që u prezantua si udhëheqës i shërbimit
22 sekret të UÇK-së me ton kërcënues na pyeti: 'Pse keni ardhur
23 këtu të mbani mbledhje', shpjegoi znj. Aliu dhe shtoi se 'ata
24 u interesuan të dinë dhe për qëllimin dhe organizatorin e
25 kësaj vizite'. 'Pasi na i kthyen letërnjoftimet -- më falni,

1 lejet e njoftimit -- ata na thanë se përveç femrave dhe
2 gazetarëve të gjithë përfaqësuesit politikë që janë të
3 arrestuar nga policia sekrete e UÇK-së' pohoi ajo duke thënë
4 atyre udhëheqësi i grupit të policisë sekrete të UÇK-së i cili
5 më tej kishte theksuar se ata do të arrestohen dhe do të
6 arrestohen të gjithë ata që flasin dhe shkruajnë kundër UÇK-
7 së'".

8 A pajtoheni ju me ato që i ka treguar znj. Aliu Kohës
9 Ditore më 22 shtator të 1998? A ka ndodhur kështu?

10 PË. Absolutisht jo. Nuk pajtohem.

11 PY. Me cilën nga këto pjesë nuk pajtohesh?

12 PË. [e pakuptueshme] vetash të armatosun të UÇK-së. Ajo ka
13 mund ndoshta me pa ëndërr ose me pas ndonjë halucinacion, por
14 nuk ka qenë e vërtetë. Plus grupi që është kthi për Prishtinë,
15 për Prishtinë menjëherë nuk është korrekt. Ata mund të
16 spekulojnë me u marrë shumë me këtë temë, sepse ata janë shku
17 menjëherë për Prishtinë. Ata që kemi mbet aty 13 prej nesh,
18 ata mund të flasin, domethënë, përshtypjet e tyre edhe është e
19 drejtë e tyre. Por ata që s'kanë qenë aty e tash të flasin,
20 domethënë, unë s'mund me ia mohu kurrkujt, secili ia ka fut
21 kot sipas dëshirës së vet.

22 PY. Ajo ka qenë e pranishme ama.

23 PË. Po.

24 PY. Kur mbërriti përsëri --

25 PË. Po, a mund një sekondë veç me dalë në seancë të mbyllur?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 132

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 PY. Ka lidhje me diskutimin e ndonjë personi konkret? Duhet
2 të flitet për një person konkret?

3 PË. Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
5 çaktivizuar]

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. A mund të thoni thjesht Personi 1? Këtij personi
8 drejtohuni si Personi 1.

9 PË. Unë dashta seancë private, nëse bën.

10 PY. E ka në dorë Kryegjykatësi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
12 çaktivizuar]

13 Duhet të na e thoni tamam arsyen pse doni që të kalojmë
14 në seancë private.

15 DËSHMITARI: Nëse mund ta them arsyen publikisht atëherë
16 s'kam nevojë me pas seancë private.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Kalojmë në seancë private për një pyetje.

19 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F2133RED

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z.
22 Misetic. Përsëriteni pyetjen. Më duket se kishit një pyetje.

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Znj. Aliu ka qenë e pranishme kur erdhi u shfaq

25 [REDAKTUAR] dhe kërkoi letërnjoftimet apo jo?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03825 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F2133RED

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 133

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 PË. [REDAKTUAR] ka hy në dhomë me dy shoqëruesit e vet, tre a
2 dy a një ka hy me dikën edhe ia kanë afru menjëherë një
3 karrige. Njoni prej tyre ja ka qit një cigare, tjetri ia ka
4 ndezë, si me qenë sherif. Edhe ai është marrë me ne. Ai është
5 marrë me ne dhe ka pyet "Kush është organizatori?", i kam
6 thënë unë, "Gjergj Dedaj, nënkryetar i parlamentit të
7 Kosovës". Edhe më ka shajt menjëherë. Ku ka Kosova parlament
8 edhe fyerje të tjera edhe atëherë situata i ka mbledh
9 letërnjoftimet, grave zonjave edhe shoferëve edhe gazetarëve
10 jeni të lirë të shkoni në shtëpi. Atëherë është marrë me ne.
11 Domethënë, kjo është edhe mos më shtini shpesh me përmend se
12 nuk kam dëshirë me e përmend këtë person. [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të kalojmë
18 sërish në seancë publike tani.

19 ~~{Seancë e hapur}~~

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Ju e shihni që znj. Aliu përmend këtu dikë që u prezantua
23 si udhëheqës i shërbimit sekret të UÇK-së. Dua të theksoj që
24 te transkripti i konferencës suaj për shtyp që ka numrin e
25 provës materiale P321 faqja 7 në anglisht, ju thoni si në

1 vijim:

2 "Disa anëtarë, sikurse thanë, ishin të policisë sekrete
3 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbërritën dhe pyetën, kush
4 ishte organizatori, kush e udhëheq këtë grup personash".

5 Pra, a pajtoheni ju me znj. Aliu që --

6 PË. Pajtohena me znj. Aliu, por unë pajtohena me atë çka
7 thashë unë.

8 PY. Pra, personi u prezantua si person që ishte anëtar i
9 policisë sekrete?

10 PË. Nuk u prezantua. Ai ka pyet "Kush jeni ju?".

11 PY. Në rregull. Po pse thatë ju në konferencën për shtyp të
12 datës 23, ditën, pra, që u liruat se thanë se ishin nga
13 policia sekrete e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

14 PË. Ashtu m'u krijua përshtypja se përjashta ishin njerëz që
15 na kanë marrë me makinë, aty ishin të UÇK-së, domethënë. Edhe
16 ashtu flitej nëpër mendja, shkruhej quheshin, por unë s'kam
17 pas njohuri, domethënë, për askënd veç e veç. As ku punon, as
18 çfarë shërbimi është. Unë i kam shikuar, ata që kanë pas
19 emblema të UÇK-së i kam shiku si UÇK; i kam vlerësu si UÇK që
20 bënin një luftë titanike për lirinë e Kosovës.

21 PY. Pas kësaj, pasi ndodhi kjo, pra, juve ju vendosën në
22 vetura të ndryshme, kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe ju çuan në Baicë, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe ju çuan në shkollën fillore të fshatit, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Në momentin që mbërritët në Baicë, z. Thaçi nuk ishte i
4 pranishëm?

5 PË. Jo, s'e kam parë fare.

6 PY. A kishte njeri, a mbante njeri maska në shkollën fillore
7 në Baicë?

8 PË. Më vonë kanë ardhë njerëzit e maskum. Aty jemi ul në
9 hollin e shkollës që ka qenë një korridor më i zgjenum, në
10 karrige edhe aty na kanë kthy letërnjoftimet nga Rexhep Selimi
11 me një fjalor korrekt, mirësjellës, pa kurrfarë ngritje të
12 zërit, pa kurrfarë shqetësimi, na i ka kthy letërnjoftimet.

13 Për një çast ai është shku, s'ka, na kemi mbet q'aty ul,
14 derisa ka hy një grup i, për mendimin tim huligan. Nuk e di
15 kush kanë qenë aty. Kam shumë dëshirë me e dit edhe s'kam
16 dëshirë me vdek pa dit kush kanë qenë pjesëtarët e atij grupi.
17 Me maska, pa emblema të UÇK-së, pa armë edhe kanë bërë atë
18 farë paniku, shqetësimet tona, përplasjet, shamjet, domethënë,
19 të cilat i kam përshkru dje e shpeshherë. Edhe me atë,
20 domethënë, brenda një minutë një kohë shumë të shkurtër ajo ka
21 përfunduar, janë zhduk sikur si hiqe. Nuk di, domethënë, nga
22 kanë shku se ka qenë, ka fillu me u bë terr, domethënë, nuk
23 kemi qenë --

24 PY. Pra, kur ndodhi ky incident [e pakuptueshme] me këta
25 huliganët për më pak se një minutë, a është e vërtetë që z.

- 1 Thaçi hapte rregullisht derën për të parë çfarë ndodhte
2 brenda?
- 3 PË. Jo, s'ka pas. Jo, jo s'ka pas atë derë, nuk ka,
4 domethënë, as nuk ka hap kurrkush derë, jo z. Thaçi. Askush
5 s'ka hap derë. Personin e fundit në atë moment e kena pa
6 Rexhep Selimin që na i ka dhënë letërnjoftimet. Pastaj kena pa
7 njerëzit e maskuar. Kryesisht dukeshin të vegjël, të rinj,
8 kështu, domethënë të paarmatosur, pa emblema të UÇK-së, por
9 kjo ka ndodhë. Domethënë, kjo është ngjarje që e din krejt
10 bota.
- 11 PY. Ky incidenti me huliganët a ndodhi në të njëjtën dhomë ku
12 po ju mbanin --
- 13 PË. Jo.
- 14 PY. -- apo në një dhomë tjetër?
- 15 PË. Jo, jo pastaj na kanë dërgu në dhomë në klasë ku ka qenë
16 shtretërit. Aty kemi qenë në holl, në korridor, në holl të
17 shkollës. Pas kësaj atëherë jemi shku në klasë. Atëherë ka
18 ardhë edhe njëfarë Sahit Jashari. Më vonë e kam taku, e kam
19 përmend Tahir Deskun. Tahir Deskun e kam njoft edhe nga
20 Prishtina, domethënë, edhe kanë ardhë, domethënë, mbas një
21 kohe, mbas një ore ose dy, atëherë është shfaq Presidenti
22 Hashim Thaçi.
- 23 PY. Ju bëri pyetje Prokurorja lidhur me dëshmitë që keni
24 dhënë më herët kur keni thënë që gjashtë persona u rrahën. Ju
25 kujtohet pyetja që ju bënë në lidhje me këtë?

1 PË. Shiko --

2 PY. Pyetja është që a ju kujtohet që Prokurori ju bëri pyetje
3 lidhur me këta gjashtë vetët.

4 PË. Po, po, po. Pyetje më është bërë.

5 PY. Këta gjashtë vetët që i keni identifikuar ju në 2001 dhe
6 2014 ishin ti vetë, Agim Krasniqi, Mehdi Bardhi, Dr. Jusuf
7 Telaku, Sokol Blakaj dhe Kurtesh Devaja, këto ishin? A ju
8 kujtohet që ju bëri Prokurorja pyetje lidhur me këta gjashtë
9 vetë, duke përfshirë dhe veten tënde?

10 PË. Po.

11 PY. Prokurorja ju pyeti lidhur me dëshminë që keni dhënë ku
12 keni përshkruar lëndimet tuaja si lëndime shumë të rënda ku i
13 gjithë krahu deri te thonjtë ju ishin nxirë. A ju kujtohet që
14 Prokurorja ju bëri pyetje lidhur me këtë pikë?

15 PË. Po më ka bë pyetje.

16 PY. Kërkoj nga Sekretarja që të paraqesë në ekran këtë pjesë
17 të deklaratës së EULEX-it.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Përsëri është prova materiale 680
19 dhe faqet janë 034260 në anglisht dhe 034276 në shqip. Në
20 qoftë se shkojmë më poshtë në versionin anglisht juve ju
21 bëhet, ju bëri Prokurorja pak më përpara, paradite këto
22 pyetje.

23 PY. Juve ju bë pyetje nga Prokurori i EULEX-it, në qoftë se
24 je trajtuar në spital ose në qoftë se ju është ofruar trajtim
25 mjekësor. Dhe ju thoni, "Jo, edhe në qoftë se do kishte qenë

1 gjëja e fundit në jetën time nuk do kisha kërkuar që të shkoja
2 te mjeku".

3 Ju pyeteni:

4 "Pse?".

5 Dhe përgjigja që jepni ishte që, "Spitalet
6 kontrolloheshin nga serbët dhe nuk kishte mjek shqiptar të
7 disponueshëm. Edhe në qoftë se do të kishte do ndihesha i
8 turpëruar".

9 Ju keni thënë në mënyrë të vazhdueshme që nuk kishit
10 nevojë për mjek se nuk kishit lëndime.

11 PË. Kjo është më e rëndësishmja.

12 PY. Megjithatë --

13 PË. -- tani nënvizojeni, s'kisha nevojë.

14 PY. Ju premtoj se do ta theksoj shpesh këtë fakt. Megjithatë,
15 dua që të theksoj diçka. Nga gjashtë vetët, nga këta gjashtë
16 personat që ti ke përmendur, z. Telaku ishte mjek vetë apo jo?

17 PË. Ishte mjek vetë, madje një njeri, një person shumë i
18 respektuar që edhe e kishte ndihmu, kishte dërgu, sipas tij,
19 edhe medikamente shëndetësore, barna UÇK-së.

20 PY. Ai ishte bashkë me ju --

21 PË. Po.

22 PY. -- gjatë gjithë kohës. Kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe ai e di të vërtetën, çfarëdolloj gjëje që të ketë
25 ndodhur apo jo?

1 PË. Mendoj se e din.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kundërshtoj. Do e dinte të
3 vërtetën çfarë ka ndodhur?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është pak
5 spekuluese si pyetje.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Ai ishte i pranishëm aty dhe e di ekzaktësisht se çfarë
8 ka ndodhur apo jo?

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është e vagullt përsëri.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

11 DËSHMITARI: Kushdo që ka qenë i pranishëm, përveç
12 harresës që është normal, është njerëzore mund ta din të
13 vërtetën.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Pyetja ime është kjo: Në qoftë se do të kishit nevojë për
16 ndihmë mjekësore, ju kishit një mjek aty brenda përbrenda
17 grupit që mund të kishte ofruar ndihmë pa asnjë lloj problemi
18 dhe pa ju duke u ndierë i turpëruar, kështu?

19 PË. As që kena fol me z. Telaku se s'kena pas nevojë.

20 Domethënë, për kurrfarë ndihme mjekësore, asnjoni prej nesh
21 s'kena pas nevojë.

22 PY. Po. Pra, nuk është se ju kishit frikë nga serbët ose ju
23 vinte turp, ishit në siklet. Ju e kishit mjekun aty të
24 pranishëm në qoftë se kishit nevojë për ndihmë mjekësore, por
25 ju nuk kishit nevojë për ndihmë mjekësore. Kjo është e vërteta

1 apo jo?

2 PË. S'kishim nevojë për ndihmë mjekësore.

3 PY. Kështu që nuk do ju befasonte në qoftë se z. Telaku,

4 doktor Telaku i ka thënë EULEX-it që asnjë prej jush që ishit

5 aty nuk kishte lëndim, nuk është befasuese, nuk ju çudit kjo

6 apo jo?

7 PË. Jo, është e vërtetë kjo nëse e ka thënë ashtu.

8 PY. Dhe nuk ju befason, prapë, në qoftë se do të dëgjonit se

9 doktor Telaku i tha EULEX-it që nuk i kujtohej që ndonjëri

10 prej jush kishte kërkuar ndihmë mjekësore. E saktë kjo?

11 PË. Edhe kjo është e saktë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është

13 deklarata e doktor Telakut; është dokumenti 03463 [sipas

14 përkthimit] deri në 03465 [sipas përkthimit].

15 PY. Gjatë dëshmisë që i keni dhënë EULEX-it, që jua lexoi

16 Prokurorja sot, ju patë një fotografi që pretendohet që juve

17 ta keni bërë menjëherë pasi jeni kthyer nga Baica.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe mund ta paraqesim në ekran

19 këtë për ta parë edhe një herë. Për procesverbal është

20 dokumenti, është faqja 034259 në anglisht dhe 034246 në shqip

21 -- 276 në shqip -- më falni.

22 PY. Është pjesa ku thotë:

23 "Dëshmitari prezanton një fotografi të tijën".

24 Ju thoni:

25 "Kjo fotografi është bërë pas kthimit tim në Prishtinë.

1 Unë mund t'ju sjell kopje me ngjyrë të kësaj. Po ashtu mund
2 t'ju dorëzoj edhe origjinalin e kësaj. Është dëshirë e imja që
3 EULEX-i të mbajë dikë përgjegjës lidhur me atë që më ka
4 ndodhur. Gjatë 16 viteve të fundit jam duke marrë dhe mbajtur
5 pjesë të kësaj fotografie në trupin tim, sepse unë nuk e kam
6 merituar këtë".

7 Në faqen 034260, pyetja që ju bëhet është kjo:

8 "Pas sa kohe, pas rrahjes, e keni bërë fotografinë?".

9 Dhe përgjigja që ju jepni është:

10 "3 ose 4 ditë më pas kësaj".

11 PË. Nëse ka mundësi z. Avokat ta korrigjoni këtë fjalë

12 "rrahje", sepse kjo është problematike për mua dhe me bë me e
13 dit kjo dhomë, çfarë --

14 PY. Po.

15 PË. -- po më sjellë kjo fjali kurrë s'e kisha përmend. Mua
16 dhe familjes time.

17 PY. Ju siguroj që të gjithë ata që janë në sallën e gjyqit e
18 kuptojnë që ju nuk doni që të përdoret kjo fjalë. Çështja
19 është që unë duhet të jem i detyruar që të lexoj fjalën ashtu
20 siç është e shkruar në dokument. Kur mundem do përdor një
21 fjalë tjetër, por kur është e shkruar më duhet ta përmend atë
22 ashtu siç është e shkruar.

23 Tani kërkoj që të shohim një tjetër dokument që nuk e
24 keni parë më herët, por le ta shohim këtë dokument dhe do ju
25 kërkoj që ta komentoni atë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Bëhet fjalë për një shënim. Për
2 Sekretaren është dokumenti 100816. Nuk ka tekst në shqip për
3 këtë dokument.

4 PY. Është një shënim i një bisede që ka ndodhur nga një,
5 ndërmjet një Prokurori të kësaj Gjykate dhe dikush që quhet
6 Claire Morris që ka qenë i pranishëm në intervistën që i keni
7 dhënë EULEX-it në 2014.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të shkojmë te paragrafi i dytë,
9 ju lutem.

10 PY. Përderisa nuk e kemi fotografinë që i keni dhënë EULEX-it
11 --

12 PË. Unë s'i kam dhënë kurrfarë fotografi EULEX-it.

13 PY. -- Zyra e Prokurorit.

14 Në rregull. Atëherë do ju them se çfarë ka thënë EULEX-i
15 dhe pastaj do ju jap mundësinë që të komentoni lidhur me të.
16 Znj. Morris ka thënë si më poshtë:

17 "Në një pikë Dedaj na dha një fotografi ku përshkruheshin
18 lëndimet e tij dhe ia tregoi Hackett. Morris pa fotografinë
19 dhe mban mend që kishte parë Dedajn me këmishë të hequr dhe ku
20 i gjithë krahu i tij dukej sikur ishte i mavijosur te pjesa e
21 sipërme e krahut dhe në parakrah".

22 E di që ju tha që nuk i keni dhënë një fotografi të tillë
23 EULEX-it, por pyetja që kam për juve është, a keni në shtëpi
24 diku ndonjë fotografi që tregon krahun tuaj të nxirë dhe të
25 lënduar?

1 PË. Asnjë fotografi, asnjë fotografi s'ua kam dhënë. Me ua
2 pas tregu unë, me pas fotografi me ua tregu ata janë konë
3 policia çka janë konë ata, kanë mujt me marrë. Domethënë edhe
4 s'kam asnjë fotografi. Çështjen e asaj mavijosjes që po flitni
5 ju unë e kam sqaru disa herë dje dhe sot.

6 PY. A pajtoheni me mua dhe sigurisht, domethënë, ju premtoj
7 që do shikojmë edhe videon, por a pajtoheni me mua që tani që
8 e keni parë shumë herë videon, si mendoni, e keni pasur të
9 ënjtur fytyrën në atë video?

10 PË. Asnjëherë. Nuk e di për cilën video po folni, por fytyra,
11 fytyrën time kush kurrë -- jo, jo du me e sqaru, është me
12 rëndësi shumë për mua.

13 PY. Ndjesë. Është faji im, është gabimi im.

14 PË. Jo, s'po më lini me folë. M'ka lejoni me folë mua?

15 PY. Do t'ju lë që do ju lejoj që të flisni --

16 PË. [e pakuptueshme] të akuzumit dhe s'më leni as me folë.
17 Duhet me thënë të vërtetën.

18 PY. Jo, absolutisht fare. Pa diskutim që dua që të dëgjoj të
19 vërtetën dhe prandaj po them që e kam gabim unë; ishte faji im
20 që nuk ju shpjegova --

21 PË. -- me e dit të vërtetën [e pakuptueshme]

22 PY. -- se për këtë video bëhet fjalë. Ishte video e konferencës
23 për shtyp.

24 PË. [e pakuptueshme] në jetë. Ju keni thirrë personin që
25 është më i sakrifikumi që ka që është më i martirizumi në

1 Evropë e keni thirrë në Gjykatë.

2 PY. Në rregull. Mirë, do ta bëj edhe një herë pyetjen.

3 Videoja nga konferenca për shtyp e datës 23 shtator që e patë
4 sot paradite, që jua tregoi Prokurorja, a besoni se fytyra
5 juaj është e ënjtur në atë video?

6 PË. Fytyra ime është e paprekun. Kurrëkush në aspektin
7 negativ fytyrën time s'e ka prek. Kurrë në jetën time, kurrë,
8 kurrë, kurrë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Do doja që të shkonim përsëri, të
10 shihnim dokumentin e EULEX-it. Prova materiale 680 për
11 Sekretaren. Ndjesë, 034260 në atë dokument dhe 034276 në
12 versionin në shqip.

13 PY. Pyetja që ju bën Prokurori është kjo. Një çast sa të
14 paraqitet edhe dokumenti në shqip në ekran.

15 Prokurori ju pyet:

16 "A mund t'i përshkruani lëndimet tuaja?"

17 Dhe ajo çfarë thoni ju është kjo:

18 "Së pari, lëndimi më i madh është integriteti im moral.
19 Ata ma kanë shkatërruar identitetin tim moral, identitetin e
20 familjes time, karrierën time politike, vullnetin tim për të
21 jetuar. Me fjalë të tjera ata më kanë shkatërruar çdo gjë që
22 kisha pasur. Këto lëndime fizike kanë qenë ato më të fundit."

23 A është e saktë kjo?

24 PË. Për kë e keni fjalë "ata"?

25 PY. Këto janë fjalët tuaja, kështu që na thoni ju, na e

1 shpjegoni ju. E para, domethënë, a e keni thënë dhe pastaj

2 çfarë keni dash me thënë?

3 PË. Nuk e di, nuk e di unë kush janë "ata".

4 PY. Në rregull. A po ankoheshit, mbase, në Baicë për lëndimin

5 e integritetit tuaj moral? A mund të ketë ndodhur që të jeni

6 ankuar për lëndimin e integritetit tuaj moral?

7 PË. Po, ata huliganët, normalisht që ma kanë lëndue dhe

8 identitetin tim, kodin tim familjar, identitetin tim,

9 domethënë, fjala është për ata huliganë. Edhe ata unë gjithë

10 jetën kam me i qujt huliganë. Kush do të jetë [e pakuptueshme]

11 PY. Kur keni fol me z. Thaçi në Baicë, a i jeni ankuar atij

12 për cenimin e integritetit tuaj moral dhe të familjes tuaj?

13 PË. Po, po.

14 PY. Dhe në qoftë se z. Thaçi do i ketë thënë Prokurorisë që

15 është cenuar --

16 PË. Po.

17 PY. -- integriteti juaj etik dhe moral, a do ishte e saktë

18 kjo?

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtojmë. Komenti është

20 lidhur me një deklaratë që i ka dhënë dëshmitari ZPS-së. Dhe

21 vazhdohet pastaj me perceptimin që mund të ketë pasur z.

22 Thaçi.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

24 Rrëzohet kundërshtimi.

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. Në qoftë se z. Thaçi i ka thënë ZPS-së që lëndimet që
2 janë pësuar mbi ju ato morale dhe etike a do ishte e saktë
3 kjo?

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtim, kundërshtim tjetër.
5 Dua themelin, themelsinë e kësaj pyetje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
7 kundërshtimi. Mund t'i përgjigjeni.

8 PË. Thaçi e ka thënë atë, e ka thënë të saktë. Z. Thaçi kur
9 është ardhë mbas dy orëve me rroba civile, me një transitor në
10 dorë duke i dëgju lajmet. Ka qenë shumë i shqetësuar kur ka
11 dëgju, nuk e di kur ka dëgju, se çfarë ka ndodhë, edhe atëherë
12 më ka thirrë në një dhomë dhe kena bisedu edhe ka shpreh
13 zhgënjim, shqetësim dhe nuk është, jo që s'është pajtu, ka
14 kundërshtu shumë atë veprim. Por aty si duket tjetërkush ka --
15 PY. Ajo çfarë dua të them është, ajo çfarë dua të them është
16 që besoj që tani ju dëshmuat që ju iu ankuat atij lidhur me
17 lëndimet morale dhe etike, a është e drejtë kjo?

18 PË. E drejtë kjo. Edhe sot ankohena, edhe krejt jetën
19 ankohena, edhe kam dëshirë me dit kush janë ata katër-pesë
20 veta. Por një gjë du me e thënë korrekt. Aty nuk ka qenë as
21 [REDAKTUAR], as Rexhep Selimi, as Hashim Thaçi në atë grup. Të
22 tjerët mund me konë, nuk i di të tjerët. Këta të tre është e
23 pandershme nga ana ime me keqpërdor situatën e me keqpërdor
24 Gjykatën që unë shumë e respektoj, nuk e kuptoni e as nuk e
25 besoni sa e respektoj drejtësinë. Se unë jam i rritur e i

1 edukum në frymën evropiane. Domethënë, këta të tre nuk kanë
2 qenë aty prezent.

3 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Vazhdojmë më tej me deklaratën e
4 EULEX-it.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të shohim faqen 034261 në
6 anglisht dhe 034278 në shqip.

7 PY. Mendoj që është në fund të faqes në anglisht. Ju bëhet
8 një pyetje me fund të hapur:

9 "Ju apo dikush tjetër a ka pasur lëndime të dukshme, për
10 shembull, gjak?".

11 Pyetje [sipas përkthimit] që ju jepni është:

12 "Po. Sokol Blakaj, sekretari i përgjithshëm i Partisë
13 Liberale kishte lëndime në fytyrë. Edhe të tjerë kishin
14 lëndime."

15 A e shikoni këtë pjesë të deklaratës?

16 PË. Asnjoni nuk më kujtohet që ka pasë lëndime në fytyrë dhe
17 s'kam pa asnjë pikë gjak. S'paku kish mbet ndonjë pikë gjaku
18 në këmishat tona të bardha, në krevatat tona, asnjoni.

19 Dhe nëse ka mundësi zonin pak me ja rrit se shumë pak jam
20 nga dëgjoj, përkthimit, shumë pak.

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, sot paradite ju treguan disa video të dorës
23 tënde në konferencën për shtyp, në konferencën për gazetarë.

24 Dhe një pamje të ballit të z. Blakaj. A ju kujtohen këto
25 pyetje?

1 PË. Po më kujtohen këto pyetje.

2 PY. Atëherë, së pari, le t'i vëmë në ekran dhe të shohim
3 dorën.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
5 paraqesë në ekran dokumentin 11318902 dhe të kalojmë te koha
6 20:05.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal është
8 prova materiale P321.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, Prokurorja ju bëri disa pyetje lidhur me dorën
12 dhe ngjyrën e dorës. A e shikoni fotografinë? Së pari, dua
13 t'ju pyes, a shikon një si hije në të majtë të dorës suaj të
14 djathtë në ekran?

15 PË. Këtu shoh, po shikoj hije dhe në mur.

16 PY. Në rregull. Domethënë është një si hije në mur që vazhdon
17 më tej tek dora në të djathtë dhe vazhdon sikur është e
18 reflektuar dhe në tryezë, kështu?

19 PË. Nuk e di unë çka është kjo, mund të jetë e rregullume
20 masandej, unë nuk di. Por unë s'kam pas, unë me pat pas diçka
21 në duar s'kisha dalë në konferencë shtypi. Edhe nuk e keni
22 lëshu krejt konferencën e shtypit sot. Është ka qenë dashtë me
23 e lëshu prej fillimit deri në fund.

24 PY. Do ta transmetojmë të gjithë konferencën për shtyp; mos u
25 shqetësoni lidhur me këtë. Por për momentin, për arsye të

1 pyetjeve dhe kemi pak minuta që na kanë ngelur për ditën e
2 sotme, do i kërkoja Sekretares që të transmetojë nja 10
3 sekonda të videos. Kështu që, ju lutem, shikojeni videon dhe
4 të shohim në qoftë se mund të dalloni një hiqe që zhvendoset
5 përgjatë dorës tuaj. Do kërkoja që të transmetohet pjesa nga
6 minuta 18:56 deri në 19:07.

7 [Luhet videoincizimi]

8 "Interesimi i tyre ishte domethënë, në radhë të parë, pse
9 nuk kemi paralajmëru vizitën."

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. A shikoni një hiqe që lëviz?

12 PË. [e pakuptueshme] S'po shoh. Edhe nëse është unë e kam
13 shpjegu pse kam qenë. Nuk di sa herë duhet me e shpjegu. Po
14 unë këtu kurr gjë s'po shoh, kurr gjë s'po dalloj. Është e saktë
15 kjo. Hiqe ka gjithandej, në mur ka, në tavolinë ka këtej,
16 domethënë, se ka qenë --

17 PY. Të shohim një tjetër fotografi të dorës tuaj të djathtë
18 që nuk jua tregoi Prokurorja.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
20 kalojmë në minutën e 17, sekonda e 5-të.

21 PY. I shikoni duart këtu, Dëshmitar?

22 PË. Të bardhë si bora.

23 PY. Ka ndonjë dallim këtu ndërmjet dorës së djathtë dhe të
24 majtë?

25 PË. Asnjë dallim. Vetëm dallimi është se njona është e

1 djathtë, tjetra e majtë.

2 PY. Në rregull. Të shkojmë në minutën e 18, sekonda 14. Në të
3 njëjtën video. Nuk mendoj se është pjesa e duhur kjo.

4 DËSHMITARI: Këta janë gazetarët. Ka pasë shumë gazetarë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe një sekondë më pas. Se kam
6 përshtypjen që jemi, ja këtu.

7 [Luhet videoincizimi]

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Shikon ndonjë dallim në ngjyrën e duarve tuaj?

10 PË. Unë, jo.

11 PY. Janë e njëjta ngjyrë, dora e majtë dhe e djathtë?

12 PË. Për mua, po.

13 PY. Tani t'ju tregoj z. Blakaj.

14 PË. Ndalni pak këtu, mundësisht. Të lutna. Shikoni edhe disa
15 shenja këtu në fytyrën e Veli Bytyqit. A mundeni me i vërejt?
16 Këtu.

17 PY. Po.

18 PË. Edhe këtu. Veli Bytyqi s'ka bisedu kurrkush me të. Këto
19 njerëzit mund me pas shenja të linduna. Mundeni me i pa
20 shenjat. Veli Bytyqin askush s'ka bisedu në këtë aspektin,
21 domethënë, ai veç ka nejt ul në karrige.

22 PY. A konfirmoni dot, ju lutem, që në qoftë se do shihni
23 veten tuaj në këtë video, domethënë, në këtë fotografi, si
24 mendoni, ju duket e ënjtur fytyra këtu?

25 PË. Unë kam qenë i shëndoshë dhe bile më i shëndoshë se tash

1 dhe q'aq është kjo pyetje fyese për mua, ju keni të drejtë me
2 bë edhe kushdo që të ma bën, kurrë në jetën time, nuk di çka
3 kam me ju thonë tjetër, kurrë në jetën time kush me dorë
4 fytyrën time s'e ka prek, përveç familja ime, fëmijët e mi,
5 miqtë e mi, domethënë, kur jena përqaftu. Kurrë në jetën time.

6 Edhe sa herë e bën i këtë pyetje është më mirë [e
7 pakuptueshme], a keni burg këtu? Shkoj në burg unë, 100 vjet.
8 Unë jam njeri që kam sakrifiku gjithçka.

9 PY. Nuk është synimi im ky.

10 PË. Të lutna, të lutna.

11 PY. Le të vazhdojmë më tej.

12 PË. Fytyra, fytyra, mua kurrkush se ka prek fytyrën time
13 kurrë, kurrë, kurrë dhe kurrë.

14 PY. Të shohim z. Blakaj në video që është një pjesë tjetër e
15 videos.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të shkojë
17 në minutën 20, sekonda e 9-të.

18 PY. Kjo është një sekuençë që ju tregoi Prokurorja.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj. U shfaqën pesë
20 sekonda në fakt për sa i takon z. Blakaj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
22 çaktivizuar]

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që këtu përfundoi
24 transmetimi i videos edhe këtu filloi që t'u bëjë pyetje
25 Prokurorja.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar] Kështu mendoj edhe unë.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj me përshkrimin, sepse
4 Avokati tha që më përpara Prokurorja nuk jua tha, nuk e tregoi
5 këtë, por e vërteta është që ia tregova.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk po them këtë.

7 PY. Thashë të kundërtën. Po thoja që kjo sekuencë iu tregua
8 nga Prokuroria sot paradite. A ju kujtohet që e keni parë këtë
9 sekuencë të videos?

10 PË. Po.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim minutën e 17-të,
12 sekondën e 35-të, 17:35.

13 PY. A shihni shenja të ngjashme në fytyrën e z. Blakaj këtu?
14 E di që është nga një tjetër kënd, por dua t'ju pyes a i
15 shikoni këto shenjat te fytyra e z. Blakaj?

16 PË. Më shumë po shikoj te z. Bytyqi, dy shenja. Edhe pse veç
17 ka qenë ul në karrige. Edhe a ka mundësi veç një sekondë
18 mbyllur, veç një sekondë ta jap një sqarim. Është shumë i
19 rëndësishëm.

20 PY. Shpjegim të çfarë, sqarim me çfarë?

21 PË. Lidhur me z. Blakaj.

22 PY. Nëse lidhet me fytyrën e tij në këtë video, po vazhdoni.

23 PË. Nuk e them publikisht. Sepse ai ka vdek edhe e kam pas
24 mik shumë të mirë dhe krahu i djathtë i Partisë Liberale të
25 Kosovës. E respektoj shumë atë dhe familjen e tij.

Dëshmitari: W03825 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 153

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F2133RED.

1 PY. Fatkeqësisht po na mbaron koha për sot.

2 PË. Ani nesër.

3 PY. Edhe Kryegjykatësi më tha që duhet ta mbyll këtu sot.

4 PË. Faleminderit shumë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

6 shumë, Dëshmitar. Do t'ju shoqërojë Sekretarja jashtë sallës

7 së gjyqit.

8 DËSHMITARI: Faleminderit shumë.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbyllim

11 këtu seancën për sot. Do të fillojmë prapë nesër në orën

12 09.00.

13 --- Seanca mbyllet në orën 15.58

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25